Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 9 (161) / 2019. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË.

Bigmarket
DI ÇFARË ZGJEDH!
NË PESHKOPI
Çdo muaj me
SUPER OFERTA
Faqe 24

Mbi autorësinë e këngës "BULQIZAKJA"

Munir Shehu, ky humbës i madh

Nga **MIRDASH SHEHU** 14

Profil

Edmond Zhulali, karriera artistike nisi me një kitarë

Nga **AGRON SEJAMINI** 17



25 vjet "Oda Dibrane"

Faqe 7

VËZHGIM

Vjeshtë në Dibër



Vjeshta ka ardhur në Dibër. Ne duam që ajo të mos jetë thjeshtë e bukur, por dhe me sa më shumë para në xhepat e fermerëve. Secili le të bëjë aq sa mundet në mënyrën e vet, në pozicionin e vet, që gjërat në bujqësi e kudo të jenë ndryshe e këtu të sigurohet punë për të gjithë njerëzit.

Nga **OSMAN XHILI** FAQE 2

REPORTAZH

Lura, vatra e vëllazërimit



Nga **MEVLUD BUCI** - Faqe 7

KONFERENCA SHKENCORE / STUDIMI

Rrugët lidhëse me Rrugën e Arbrit në Katër Grykët, Muhur e Luzni për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë dhe turizmit historik e malor të kësaj zone

Autorë: OSMAN MIHA, AGIM TOTRAKU, ELMAS LALA

Në perëndim të trevës së Dibrës e në lindje të Matit, në zemër të masivit malor që i bashkon këto dy treva me tradita e me histori, që shkojnë deri thellë në histori, brenda një kështjelle madhështore natyrore e legjendare, shtrihen Katër Grykët. Malet që e rrethojnë me bukuri të rralla përrallore, qafat që i sigurojnë komunikimin më të përshtatshëm e të domosdoshëm në të katër anët e horizontit, madje duke e pagëzar dhe me emrin që mban, liqenet e pakonkurueshme akullnajore që i sigurojnë ujë gjatë gjithë vitit, burimet e panumërta me ujë të pijshëm kristal, flora dhe fauna tejet e pasur dhe e larmishme, i bëjnë Katërgrykët një trevë ku mund të përjetohet në të gjitha dimensionet gjiçka natyra ofron.



FAQE 4-5

NË BRENDËSI:

- **Strehë** të ngrohta për njerëz
- Udhëtim drejt **Lurës** së shkretuar
- Me Dr. **Selim Horeshkën** në mallin për vendlindjen
- **Turi i kanionit** të Drinit të Zi
- **Naim Plaku**, bashkëpunëtor i urtë e krijues i spikatur
- **Nderimi** për ata që pamundësuan devijimin e Radikës
- **Kulla Hakik Hysës** në Qà të Zalldardhës, baza e parë e Luftës Nacionalçlirimtare në Dibër
- **Fjalë** e frazeologjizma të rralla
- Në **kërkim** të fatit
- Prof. dr. **Molnar Kolaneci** - Akademiku që ndërroi jetë në Akademinë e Shkencave
- **Sheh Mehmeti** i Limjanit
- Faleminderit **Zaide Çela**

Gazeta “Rruga e Arbërit” është një media e lirë dhe e hapur.
Çdo kontribut me shkrime, abonime ose donacione është i mirëpritur!
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

aktualitet

Vjeshtë në Dibër



Fotot marrë nga ©Facebook/Dibra Traditë dhe Turizëm



Vjeshta ka ardhur në Dibër. Ne duam që ajo të mos jetë thjeshtë e bukur, por dhe me sa më shumë para në xhepat e fermerëve. Secili le të bëjë aq sa mundet në mënyrën e vet, në pozicionin e vet, që gjërat në bujqësi e kudo të jenë ndryshe e këtu të sigurohet punë për të gjithë njerëzit.

Molla në Dibër ze një vend të rëndësishëm në kulturat drufrutore. Bashkë me qershinë ata kryesojnë listën me nga 450 hektarë gati secila. Në renditjen varietore të mollës, vendin e parë e zë Starkingu me gati 40 përqind të sipërfaqes. Pastaj vjen Goldeni me gati 30 përqind e më pas Green Smithi me 15 përqind të totalit. Diferencën e bëjnë varitetet e tjera. Por koha tregon se kjo listë, kjo strukturë e kjo përqindje, po përmbyset. Lloje të tjera si Pink Ledi, Fuxhi pak ngapak po përpiqen të dominojnë, duke qenë të preferuarit në tryezën e konsumatorit.

Nga **OSMAN XHILI**

Vjeshta tashmë është ulur këmbëkryq, si në gjithë Shqipërinë, ashtu dhe në Dibër. Kur përmend vjeshtën, menjëherë të bie ndërmend molla, arrat, gështenjat, apo fasulja e njomë. Është bukur dhe romantike, kur i përmend, kur i shikon, kur i shijon, por sa punë, lodhje, mundim e shpesh zhgënjim, kur synon rezultatin final.

Molla në Dibër ze një vend të rëndësishëm në kulturat drufrutore. Bashkë me qershinë ata kryesojnë listën me nga 450 hektarë gati secila. Në renditjen varietore të mollës, vendin e parë e zë Starkingu me gati 40 përqind të sipërfaqes. Pastaj vjen Goldeni me gati 30 përqind e më pas Green Smithi me 15 përqind të totalit. Diferencën e bëjnë varitetet e tjera. Por koha tregon se kjo listë, kjo strukturë e kjo përqindje, po përmbyset. Lloje të tjera si Pink Ledi, Fuxhi pak ngapak po përpiqen të dominojnë, duke qenë të preferuarit në tryezën e konsumatorit.

Viti i kaluar pati risi për sa i përket kësaj kulture. Tejet i bollshëm në prodhim, shumë i dobët në shitje dhe në treg. Të paktën 100 ton mollë u kalbën, ku vetëm dy fermerë, Adriatik Kaja në Gjoricë dhe Premtim Agolli në Maqëllarë patën nga 20 ton të dëmtuar për mungesë të tregut. Shumë humbje patën dhe fermerë të tjerë si Ramazan Xholi, Gëzim Ademi, Hamit Abazi, Jashar Kurti e shumë të tjerë. Shumë fermerë morën dhe dhoma frigoriferike me qira, por këto jo vetëm që nuk e zgjidhën problemin, por shtuan dhe qiranë në koston e mollës, duke bërë që humbja të ishte akoma më e madhe

Këto probleme sollën pasoja për të djeshmen dhe për të sotmen. Shumë fermerë të zhgënjyer nuk patën më zemër, dëshirë, por dhe para për të bërë shërbimet e mollës ashtu siç duhej. Si rezultat prodhimi i tyre për këtë vit, ose është i pakët në sasi, ose i dobët në cilësi, ose të dyja së bashku. Këtë vit punët duken pak më ndryshe me tregun. Në këtë fillim sezoni çmimi i mollës sillet nga 350 lekë, 400, apo 450 lekë për një kilogram mollë. Ka fermerë që i kanë kryer gjithë shërbimet si duhet dhe prodhimin e kanë shumë cilësor. Mund të përmendim si të tillë Medin Kryemadhin, Vëllezërit Tifeku, apo Mehmetajt e Treçës, Qatip Dodën dhe Dan Seitin në Maqëllarë e shumë të tjerënë Tomin e në Kastriot.

Nga një pësim duhet nxjerrë mësim thotë populli. Në këtë betejë për mbijetesë duhet punuar fort e me mençuri si nga fermeri, ashtu dhe nga shteti. Fermeri duhet të informohet e të orientohet nga kërkesat e konsumatorit, kurse shteti duhet të mbështesë fuqishëm, fermerët në çdo fushë e në çdo hallkë të prodhimit. Skemat e subvencionit kanë ardhur duke u zbehur dhe këtë vit nuk është mbështetur, thuajse asnjë masë në mbjellje drufrutoresh, përveç bletës, të imtave, apo diçka tjetër në blegtori. Maqedonia e Kosova i japin më shumë prioritet bujqësisë, duke qenë se aty angazhohet akoma një pjesë e mirë popullate, apo se është një shoqëruese e përhershme e turizmit.

Mungesa e fondeve e tregut, trillet e motit dhe plot rreziqe të tjerë po bëjnë që njerëzit të humbin shpresën se mund të fitohet në bujqësi dhe po marrin udhën për në shtete të tjerë.

Një grup tjetër drufrutorësh, ku po drejtohet vëmendja e fermerit të sotëm, janë dhe arrorët. Shërbimet e pakta, jetë gjatësia e tyre në vite, lehtësia për ambalazhim e transport, po i bëjnë ata gjithnjë e më interesantë për fermerin e sotëm. Deri më sot ky grup është karakterizuar nga një rritje spontane, pemë të mbira vetiu, diku në mezhda arash . Sot po shihen gjithnjë e më tepër blloqe të rinj, të bukur e të sistemuar me arra, lajthi e gështenjë. Deri tani janë mbjellë rreth 200 hektarë dhe rritja vazhdon akoma.

Nuk mund të lëmë këtu pa përmendur ndihmesën e paçmuar që po bën fondacioni “World Vision”, me shefe Majlinda Hoxhën. Para dy vitesh ata stimuluan mbi 70 fermerë të Maqellarës dhe Kastriotit me mbelljen e tre dynymëve me lajthi për secilin prej tyre, pra mbi 20 hektarë sipërfaqe të mbjellë në total Lajthia ishte e llojeve Tondo romano dhe Visoka dhe që tani ata i kanë dhënë frutet e para. Jo vetëm kaq. Në bashkëpunim me sektorin e ekstensionit në Dibër, ata kanë trajnuar fermerët për shërbimet kryesore në këtë kulturë, madje duke bërë dhe vizita në Fier, Gjirokastër e Librazhd, për të shtuar njohuritë e për të krijuar kontakte.

Qatip Doda, përgjegjës i shërbimit të Ekstensionit në Dibër, na tregon se një praktikë e tillë është ndjekur sërish nga fondacioni, në po ato zona. Këtë radhë janë mbjellë nga tre dynymë me gështenjë, për çdo fermer, duke e shtuar me dhjetë hektarë sipërfaqen në total. Dhe këtë vit “World Vision” u mundësoi mbi 20 fermerëve të Dibrës një vizitë në Lezhë e në Shkodër për të marrë eksperiencë e për të parë pikat e grumbullimit, që ndodhen këtu.

Falë një pune plot pasion sot sheh blloqe të mbjellë me arrorë, në sipërfaqe të mëdha, të sistemuar bukur, të rrethuar e me vaditje në formë pikash. Rezultatet janë premtuese e fermerët ndihen optimistë.

Vjeshta ka ardhur në Dibër. Ne duam që ajo të mos jetë thjeshtë e bukur, por dhe me sa më shumë para në xhepat e fermerëve. Secili le të bëjë aq sa mundet në mënyrën e vet, në pozicionin e vet, që gjërat në bujqësi e kudo të jenë ndryshe e këtu të sigurohet punë për të gjithë njerëzit.

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 9 (161). Shtator 2019
Gjendet në treg gjatë gjithë muajit tetor 2019.

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN “ë”.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Editor i faqes online: Agim Deva

Kontribuan për këtë numër:
Abdurahim ASHIKU
Osman XHILI
Agron SEJAMINI
Esat RUKA
Mirdash SHEHU
Osman MIHA
Agim TOTRAKU
Elmas LALA
Mevlud BUCI
Selman MËZIU
Halil RAMA
Nazmi KOÇI
Ilmi DERVISHI

KËRKOHEN KORRESPONDENTË NË PESHKOPI DHE DIBËR TË MADHE

Të interesuarit për korrespondentë/menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën.
Të interesuarit të shkruajnë email
në adresën <rrugaearberit@gmail.com>
ose të telefonojnë në numrin
069 20 68 603.

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t’i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit
<rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t’i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. llog. në lekë: 0010036640
IBAN: AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640

Adresa e gazetës:
Rr. “Zenel Baboçi”,
Pall. “Ferar”, Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë
Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

ODA DIBRANE NË GJUHEN POPULLORE SIMBOLIZON DHOMËN E PRITJES SË MIKUT. AJO ËSHTË SIMBOL I VATRËS SË BESËS E BUJARISË, QËNDRESËS E TRIMËRISË SË SHQIPTARËVE, KU BËHESHIN DASMA E KUVENDE, KU SHPALOSEJ URTËSIA E MENÇURIA E KËTIJ POPULLI.

25 vjet "Oda Dibrane"



Në këto 25 vite jetë kanë marre pjesë mbi 130 grupe e shoqata artistike Kanë interpretuar mbi 8 000 artistë. Të gjithë emrat e shquar të artistëve popullorë të trevave shqiptare kanë marrë pjesë në këtë festival. Që nga i mirënjohuri, artisti dibran Hazis Ndreu e me radhe Ndue Shyti, Frok Haxhia, Bujar Qamili, Ilir Shaqiri, grupi çam, Arif Vladi, Liri Rasha, Vera Laçi; grupet polifonike shoqëritë artistike e kulturore nga Vlora, Saranda, Gjirokastra, Berati, Fieri; Korça, Kukësi, Puka, Lushnja, Elbasani, Shkodra, Kolonja, Prishtina, Gjakova, Prizreni, Shkupi, Kumanova, Tetova dhe e gjithe Maqedonia, Ulqini, Presheva, Medvegja e Bujanovci etj.

Oda Dibrane e ka zhvilluar edicionin e parë të saj në vitin 1994.

Ishte një iniciativë e përbashkët e artistëve dibranë dhe e Shoqatave Kulturore artistike të shqiptarëve të Maqedonisë që kishin nevoje për më shumë hapësira për jetën e tyre artistike. Ky festival, që nga ajo kohë, vazhdon pa ndërprerje. Edhe në vitin 1997, ky festival dha shprese në atë kohe se jeta vazhdonte.

Këtë vit, festivali Oda Dibrane zhvillon edicionin e 25-të. Kjo jetëgjatësi e vazhdueshmëri ka ardhur për shkak të vlerave që sjell.

Oda Dibrane në gjuhen popullore simbolizon dhomën e pritjes së mikut. Ajo është simbol i vatrës së besës e bujarisë, qëndresës e trimërisë së shqiptarëve, ku bëheshin dasma e kuvende, ku shpalosej urtësia e mençuria e këtij populli.

Oda ka shërbyer ndërkohe dhe si vendi ku thureshin e merrnin udhë këngët e bukura epike e lirike, ku pritej e përcillej miku i shtëpisë, ku përdorej fjala e urte e dialogu alegorik.

Në këtë "Odë", fjala kishte peshë shumë të rëndë. Jo më kot thuhej se: "kur të shkosh në odën e Dibrës duhet të marrësh me vete një metër, një kandar dhe një gjilpërë".

"Unë kam mbaruar Universitetin e Oksfordit, por mbarova dhe një Universitet të dytë, atë të Dibrës", ka shkruar studiuesi anglez Riginald Hibbert në gazetën "Albania Life".

Festivali "Oda Dibrane" ka si qëllim të parë të bashkojë artistët shqiptarë, pavarësisht kufijve, me idenë që Oda Dibrane të jetë mikpritëse e Odës Shqiptare.

Është një takim specifik, origjinal në llojin e vet, jo vetëm në Shqipëri, por dhe me gjerë. Është takim i këngës e valles humoristike, riteve e lojërave popullore. Qëllimi është ti rizgjojë këto vlera të papërsëritshme të kulturës tonë, t'i sjellë në kohë e ti bëjë të të asimilueshme për publikun e kohës.

Specialistët më të mirë në këtë fushë e kanë quajtur këtë festival një zbulim dhe kontribut të çmuar në traditën e kulturën shqiptare, si festivali me i rëndësishëm në Shqipëri në fushën e traditës, pas atij të Gjirokastrës.

-Në shkallë kombëtare pasuron me origjinalitet larminë e evenimenteve artistike që zhvillohen në vendin tonë

-Bashkon në një festë të vërtetë artistike popullore, artistë e studiues nga të gjitha trevat shqiptare për të promovuar një mozaik të pasur të trashëgimisë kulturore, artistike, folklorike.

-Pasuron jetën kulturore artistike të qytetit të Peshkopisë, duke edukuar në brezat e rinj thellësinë e mendimit të "shkollës së Dibrës" mikpritjen, bujarinë, artin fin të fjalës, të këngës e valles dibrane.

Festivali "Oda Dibrane" për seriozitetin e organizimit dhe të zhvillimit gëzon statusin e respektuar të 25 viteve.

Në këto 25 vite jetë kanë marre pjesë mbi 130 grupe e shoqata artistike

Kanë interpretuar mbi 8 000 artistë.

Të gjithë emrat e shquar të artistëve popullorë të trevave shqiptare kanë marrë pjesë në këtë festival. Që nga i mirënjohuri, artisti dibran Hazis Ndreu e me radhe Ndue Shyti, Frok Haxhia, Bujar Qamili, Ilir Shaqiri, grupi çam, Arif Vladi, Liri Rasha, Vera Laçi; grupet polifonike shoqëritë artistike e kulturore nga Vlora, Saranda, Gjirokastra, Berati, Fieri; Korça, Kukësi, Puka, Lushnja, Elbasani, Shkodra, Kolonja, Prishtina, Gjakova, Prizreni, Shkupi, Kumanova,Tetova dhe e gjithe Maqedonia, Ulqini, Presheva, Medvegja e Bujanovci etj.

Nuk ka trevë nga Shqipëria apo trojet shqiptare përtej kufirit që nuk ka marrë pjesë të paktën një herë në "Odën Dibrane".

Oda Dibrane ka qenë porta e parë hyrëse e shqiptarëve nga matanë kufijve për në Shqipëri.

Në festivalin "Oda Dibrane" drejtues të institucioneve të larta shtetërore, që nga Presidenti i Republikës e deri të ministra të kabinetit qeveritar. Në vitin 2017, në Peshkopi, me ditët e Odës Dibrane, qeveria shqiptare zhvilloi edhe një mbledhje të saj.

Në vitin 2014, në 20 vjetorin e saj, drejtuesi i këtij festivali, Veli Vraniçi, u dekorua nga Presidenti i Republikës me titullin e lartë "Mjeshtër i Madh".



GRUPET PJESËMARRËSE NË VITE

- ANSAMBLI "FLUTURAT", GJILAN
- ANSAMBLI "JOSIP RELA", PODUJEVË
- ANSAMBLI "MATI", BURREL
- SH.K.A. "HIBE PALIKUQI", SHKUP
- ANSAMBLI " SHOTE GALICA", DRENAS, KOSOVË
- QENDRA KULTURORE BULQIZË
- ANSAMBLI "ZËRI I BILBILIT", SARANDË
- QENDRA KULTURORE "VËLLEZËRIT ÇETIRI", GRAMSH
- ANSAMBLI "GORA", KORÇË
- SH.K.A. "JEHONA E MALËSISË SË SHARRIT", TETOVË
- "LIDHJA E PRIZRENIT", PRIZREN
- SH.K.A. "AZEM BEJTA", PRISHTINË
- QENDRA KULTURORE LUSHNJE
- SH.K.A. "DRITA E DERVENIT", DERVEN, SHKUP
- ANSAMBLI ARTISTIK "LUNXHERIA"
- ANSAMBLI I KËNGËVE E VALLEVE "REXHEP MITROVICA", MITROVICË
- QENDRA KULTURORE PESHKOPI
- SH.K.A. "JEHONA E MALËSISË", TETOVË
- SH.K.A. "VALËT E LIQENIT", LADORISHT, STRUGË
- ANSAMBLI "DERVISH SHAQJA", DEÇAN
- ANSAMBLI SHTETËROR I KËNGËVE E VALLEVE, TIRANË
- ANSAMBLI "SHOTA", PRISHTINË
- ANSAMBLI "KURBINI", LAÇ
- ANSAMBLI I KËNGËVE E VALLEVE "VAÇE ZELA", LUSHNJE
- ANSAMBLIT "MUHARREM E XHEVAT QENA", ROMAJE,HAS,KOSOVE
- GRUPI I KËNGËS QYTETARE FIERAKE
- ANSAMBLI "JETA E RE", SLLUPÇAN, KUMANOVË, MAQEDONI
- SH.K.A. "JAHI HASANI", ÇEGRAN, GOSTIVAR
- ANSAMBLI I VALLEVE "GERNEC", VLORË
- SH.K.A. "JEHONA E MALËSISË SË SHARRIT", TETOVË
- ANSAMBLI "SHQIPONJAT", SARAJ, SHKUP
- ANSAMBLI "GIURGIU", RUMANI

Rruga e Arbërit nr. 161

speciale

Me përmirësimin dhe ndërtimin e rrugëve të reja lidhëse me aksin kryesor të Rrugës së Arbërit do t'i jepet një hop zhvillimit të mëtejshëm jo vetëm ekonomisë, por dhe zhvillimit tëturizmit historik e malor të kësaj treve.

Rrugët lidhëse me Rrugën e Arbrit në Katër Grykët, Muhur e Luzni për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë dhe turizmit historik e malor të kësaj zone

AUTORË: OSMAN MIHA, AGIM TOTRAKU, ELMAS LALA




Në foto: Agim Totraku duke mbajtur referimin.

SHTRIRJA GJEOGRAFIKE

Në perëndim të trevës së Dibrës e në lindje të Matit, në zemër të masivit malor që i bashkon këto dy treva me tradita e me histori, që shkojnë deri thellë në histori, brenda një kështjelle madhështore natyrore e legjendare, shtrihen **Katër Grykët.** Malet që e rrethojnë me bukuri të rralla përrallore, qafat që i sigurojnë komunikimin më të përshtatshëm e të domosdoshëm në të katër anët e horizontit, madje duke e pagëzar dhe me emrin që mban, liqenet e pakonkurueshme akullnajore që i sigurojnë ujë gjatë gjithë vitit, burimet e panumërta me ujë të pijshëm kristal, flora dhe fauna tejet e pasur dhe e larmishme, i bëjnë Katërgrykët një trevë ku mund të përjetohet në të gjitha dimensionet gjiçka natyra ofron.

Që t'i biesh rreth kësaj treve do kalosh shumë maja malesh të larta dhe shumë qafa komunikimi, duke ndjekur akrepat e orës, duke filluar nga veriu me Fushën e Kshajzës (1600m), maja e Gurit të Vashës (1734m), maja e Vanasit (1653m), maja e Gjelase (1779m), maja e Shullanit (1532m), Kepi i Kalasë së Skënderbeut (1523), qafa e Limoqes (923m), maja e Lepthit (1510m), maja e Shkëmbit të Farkës (1773), maja e Mcekut (2102m), maja e Kotecit të Ramës (1941m), maja në Bataqe (1943m), qafa e Helmës (1613m), maja e Arithit (1987m), maja e Tollës (1967m), maja e Shullanit (1604m), maja e Qafës së Epërme (1278m), maja e Arapes (1137m), rrjedha e lumit Murra (547m), Maja e Madhe (1077m), Maja e Kumbullës (1588m) dhe dhe me plot hijeshi e madhështi, në krye të vendit qëndron hijerëndë maja e Runjës (2049m). Në brendësi të territorit mund të përmendim majën e Kollumit (1462m), majën e Shënepremtes (Bungës) (1219m), majën e Mllezës së Murrës (1124m), majën e Kalasë së Qytezës në Selishtë (1348m), Kepin e Bletës në Val (842m) dhe majën e Shën Gjonthit mbi Lunarë (1237m). Sipërfaqja e Katër Grykëve është 14506 ha, e klasifikuar si më poshtë: 1264 ha tokë bujqësore, 44 ha livadhe, 2348 ha kullota, 8793 ha pyje, 1356 ha inproduktive, 462 ha shkëmbore, 162 ha siperfaqe e eroduar, 26 ha siperfaqe ujore, 6



ha pemëtore, 45 ha troje. Dy dekadat e fundit ka patur ndryshime në klasifikimin e mësipërm, pasi ka lëvizje, sidomos lidhur me sipërfaqen pyjore, pemëtore, livadhe dhe të eroduar. Shtrirë në një hapësirë që mbizotërohet nga male të larta e lugina të thella, ndërprerë nga lumi i furishëm Murra, pjesa fushore e Katërgrykëve është e kufizuar. Konfiguracioni gjeografik i vendit ku shtrihet kjo trevë dhe organizimi lokal në katër fshatra, e kanë pagëzuar me këtë emër: KATËRGRYKËT. Në këtë trevë bëjnë pjesë fshatrat: 1-Selishtë, me lartësi 650 - 820m mbi nivelin e detit, 2-Selishtë e Epër me lartësi 820-1200m mbi nivelin e detit, 3-Lukan me një lartësi 700 - 1200m mbi nivelin e detit, 4-Kacni me lartesi 820 - 1050m mbi nivelin e detit, 5-Murrë 750 – 1050m mbi nivelin e detit dhe 6-Qafë-Murrë me lartesi 770 – 1000 m mbi nivelin e detit. Selishta me Selishtën e Epër dhe Murra me Qafë Murrën janë ndarë për arsye të shtetsës së popullsisë në fillim të viteve '80.

Natyrisht që majat e larta, që i ngjasojnë një kurore mbretërore mbi natyrën e Katër-Grykëve, ndahen nga grykat, qafat, përrenjtë a lumenjtë, të cilët bëjnë të mundur komunikimin nga të gjitha anët me trevat e tjera dibrane e matjane. Përmendim këtu Qafën e Murrës, Qafën e Lulaçit, Qafën e Benës, Grykën e Murrës, Qafën e Helmës, Qafën e Pratit, Qafën e Lleshit etj.. Janë pikërisht këto konfiguracione natyrore që kanë shërbyer si ura komunikimi mes Dibrës e Matjes e shumë më gjerë.

Objekti ynë nuk është një studim i detajuar i historikut të komunikimit mes trevave ku ne kemi jetuar që në ag të historisë, por paraqitja e mundësive të shfrytëzimit të suksesshëm të këtij relievi të larmishëm në funksion të zhvillimit e prosperitetit të popullatës që jeton në të, sidomos duke marrë në konsideratë afrimin e përfundimit të ndërtimit të Rrugës së Arbrit.

POPULLSIA

Nga studime që janë bërë në trevën tonë është vërtetuar se ajo ka qenë e banuar që në lashtësi. Hulumtimet në Manasdre, dokumentacioni rreth Qytezës së Selishtës apo gjurmët në Shpellën e Lukanjakëve e vërtetojnë këtë. Popullsia e Katër Grykëve ka ardhur në rënie gjatë rreth tri dekadave të fundit, si pasojë e zhvillimeve politiko-ekonomiko-shoqërore. Katër Grykët, ky vend me plot pasuri mbi e nëntokësore, me një popullsi të re e vitale, të përkushtuar ndaj punës e profesionit, duhet të rezultojnë si të tilla edhe lidhur me gjendjen ekonomike. Vështirësitë që kjo trevë pati paraqitur rreth kushteve të jetesës, bënë që shumë banorë ta braktisin, duke lëvizur kryesisht drejt Tiranës, Durrësit e Krujës, por dhe në vende tjera përreth. Nga hulumtime që kemi bërë, rezulton që popullsia të ketë pësuar tre emigrime që nga koha e Skënderbeut. Në shekullin që kaloi, pati një rritje progresive deri në fund të tij, por duke u rikthyer pothuajse në të njëjtën gjendje pas një shekulli. Në vitin 1923 popullsia numëronte 1900 banorë, në vitin 1945 numëronte 2200 banorë, në vitin 1990 numëronte 6250 banorë, ndërsa aktualisht në prill të vitit 2019 numëron 1743 banorë. Diferenca nga viti 1923 me vitin 2019 është -157 banorë. Po të ndiqet një politikë më e studiuar ekonomiko-demografike, duke krijuar kushte punësimi dhe jetese, do të bëhet i mundur ndalimi i braktisjes, madje rikthimi i të larguarve. Pika e kthesës do ishte lidhja e zonës me sistemin rrugor kombëtar me asfalt, sigurimi i kushteve për punësimin e shtresës së aftë për punë dhe sigurimi i kushteve social-kulturore.

PUNËSIMI

Për vetë kushtet gjeografike e klimaterike, zona e Katër Grykëve cilësohet si një vend blegtoralo-bujqësor. Sipërfaqja e madhe pyjore dhe



livadhet e shumta që kjo trevë zotëron, kanë krijuar kushte shumë optimale për mbarështimin e blegtorisë. Sa i përket tokës bujqësore, ajo ka qenë e kufizuar. Gjatë viteve të komunizmit, si kudo nëpër Shqipëri, u punua fort në shpyllëzimin e sipërfaqeve të ndryshme pyjore, me qëllim që të përdoreshin për qëllime bujqësore. Kjo bëri që sipërfaqja e tokës bujqësore të rritej disi, por nuk e zgjidhi problemin. Aq më tepër që shpyllëzime të tilla si në Val të Lukanit, në Limoqe të Qafë Murrës apo në Prat të Selishtës, rezultuan një dështimjo vetëm në aspektin agro-bujqësor, por edhe në atë ekologjik. Këto sipërfaqe tashmë janë eroduar aq shumë sa vështirë të rikthehen në gjendjen e tyre të natyrshme. Nëntoka jonë është e pasur sidomos me mineral kromi, gjë që pati bërë të mundur ngritjen e minierës së Balgjajt e Manasdrenit.



Sipërfaqja e madhe me pyje e livadhe ka krijuar mundësinë që të rriten shumë lloje bimësh medicinale. Përmendëm këta katër aspekte si favorizuesit kryesorë të punësimit të popullatës. Moskoordinimi i mirë i tyre bëri që pjesa kryesore që u largua, pati si motiv bazë reduktimin e punësimit. Sot një pjesë e vogël është punësuar në biznes privat, një pjesë tjetër në sektorët shtetërorë, ndërsa shumica e banorëve punojnë si të vetëpunësuar në blegtori e bujqësi. Në biznese private punojnë 29 persona, nga të cilët 8 në miniera, 2 në sharra, 3 në dyqane shitjeje, 4 në bar-kafe, dhe 12 në dy hidrocentralet e ndërtuar kohëve të fundit. Arsimi ka të punësuar 33 kuadro, të cilët shërbejnë në 6 lokale shkollore, me 21 klasa e 306 nxënës gjithsej. Shëndetësia ka të punësuar 7 kuadro, 1 mjek e 6 ndihmësmjekë, të cilët shërbejnë në një qendër shëndetësore dhe tri ambulanca. Administrata lokale ka të punësuar 7 nëpunës, ndërmarrja pyjore 2 kuadro, ndërmarrja e rrugëve 4 punëtorë dhe shërbimi postar 1 punonjës. Njëkohësisht nga shërbimet sociale mbulohen pagesat e 250 pensionistëve dhe 210 familjeve me ndihmë ekonomike. Kjo pasqyrë mund të shërbejë si pikë orientimi për politikat e punësimit në të ardhmen.

FLORA E FAUNA.

Mund të themi pa frikë se Katër Grykët janë ndër vendet më të pasura sa i përket diversitetit të florës e faunës. Këtë e favorizon dukshëm pozita gjeografike, kushtet zonale klimaterike dhe sipërfaqja e madhe e pyjeve dhe livadheve. Nga flora mund të përmendim bredhin e bardhë, ahun, plepin e eger, pishën e zezë, arrnenin, dëllinjën e kuqe e të zezë, shkozën, lajthinë, dushkun, thanën, mollën e dardhën e egër, shkelgun, mëllezën, verrinin, qershinë e egër (boronicën), lulen e pishës, lulen e zonjës, luledelen, mjedrën, luleshtrydhen e egër, lulen e balsamit, lulen agulice, manushaqen blu dhe të verdhë, shtarën, drunakuqin, zambakun, etj. Kurse nga fauna përmendim derrin e egër, dhinë e egër, kaprollin, lepurin e egër, gjelin e egër, thëllënzën, ariun e murrmë, ujkun, dhelprën, zardafin, shqarthin, rriqebullin, macen e egër, gushëkuqin, trumcakun, gjelin e egër, bilbilin, pëllumbin e egër, thëllëzën, laraskën, korbin, sorrën, skifterin, hutinin, shqiponjën, etj.

Zona jonë veçanërisht ka sipërfaqe të madhe të mbuluar me pyje dushku e livadhe. Nuk mund të lëmë pa përmendur këtu, me gjithë papërgjegjshmërinë e pak njerëzve, të cilët në disa raste kanë vënë dhe dorë mbi ta, Lisat e Mëdhenj në livadhe të Lame në Lukan, disa lisa të tillë në vende të shenjta, si te teqja e Sheh Nezirit, te teqja e madhe në Katund të Vjetër, te teqja në Lunarë etj. Krahas kësaj mund të përmendim pishat e mbjella në zabelet e Buce në fillim të viteve '80 dhe që janë ruajtur në gjendje shumë të mirë, duke të rikthyer nostalgjinë e pyjeve të pishës në Balgjaj e Vanas.

GJENDJA HIDRIKE.

Siç dhe kemi përmendur më parë, zona jonë është e rrethuar nga shumë maja malesh, të cilat shkojnë në lartësinë rreth 2000m mbi nivelin e detit. Me sasi mesatare reshjesh, por me një klimë që gjatë dimrit favorizon krijimin e rezervave ujore në formë bore, lumi Murra, që i përshkon mes për mes Katër Grykët, nuk pushon së derdhuri ujë në Dri të Zi, me të cilin bashkohet në Muhurr. Lumi Murra, që sezonalisht merr jetë shtruar nga qafa e Murrës, por gjatë githë vitit vitalizohet vrullshëm nga përroi i Kacnisë, gjarpëron përmes kësaj treve, duke e furnizuar Drinin e Zi me ujin e qelibartë të burimeve të shumta. Trofta, ky peshk i pakonkurueshëm në lundrimet në lumenj të furishëm e në temperatura të ulëta, me një shije që asnjë peshk tjetër nuk e ka, është banori i përhershëm i këtij lumi. Uji i tij vadit jo vetëm tokat e zonës sonë, por dhe të Muhurrit e më tej. Një rrjet i tërë kanalesh vaditëse marrin jetë nga uji i burimeve dhe i lumit. Gjejmë vend këtu të përmenndim furnizuesit kryesorë, që i japin jetë të pandërprerë lumin Murra: gjurra e Kalisë, gjurra e Hyse, gjurra e Hane, gjurra e Shqezve, gjurra në krye të Kacnisë, gjurra te Prrioi i Xhipit, burimet që vijnë nga liqenet e Bataqeve e Shtruksës, Gjurrë Duka, kroi i Arushe, gjurra e Ndreut, burimet e Lulaçit, kanali që vjen nga rezervuari i lukanjakve, gjurra e Katundit të Vjetër, burimi i Gjurrës, gjurra e Zezë, gjurra e Vorbës, burimet e Balgjajt, rezervuari i Qafë Murrës etj. Vështirësi më të shumta ka Lukani, i cili, me një menaxhim shumë të kujdesshëm, arrin të plotësojë nevojat për vaditje



nga Rezervuari i Lukanjakve. Rezervuarë të tjerë për vaditje ka dhe në Qafë Murrë dhe në Zmaç të Selishtës. Në rrjedhën Murrës sot vijojnë të prodhojnë energji elektrike dy hidrocentrale: hidrocentrali i Kacnisë dhe i Selishtës. Janë në proces studimi e miratimi dhe hidorcentrale të tjerë, të cilët do të shfrytëzonin përfundimisht të gjithë prurjet e saj, që nga origjina e deri në Muhurr. Sa i përket ujit të pijshëm, me investimet e realizuara në fillim të dekadës së fundit, të gjithë fshatrat e zonës kanë rrjet furnizimi për çdo familje, duke e bërë disi më të lehtë jetesën e banorëve.

studimi

Sido që të vendoset zgjidhja për integrimin e zonës sonë me rrjetin e përmirësuar rrugor kombëtar, me Rrugën e Arbrit dhe të Kombit, një gjë është e qartë: dikush, dikur dhe diku do të ulemi e të diskutojmë se ç'do bëhet me ne. Le të fillojmë që sot, që, të paktën, e ardhmja të mos na mallkojë.



NËNTOKA

Treva jonë është e vendosur mbi masivin e kromit që vjen nga Pogradeci e që mbaron në Kamë të Tropojës. Shfrytëzimi i kësaj pasurie të paçmuar qe bërë rregullisht tri dekada më parë, ndërsa tani bëhet një shfrytëzim sezonal. Gjenden mjaft rezerva kromi në Bataqe, Shtrunksë, Liqeni i Dervishit, Livadhe të Laskut, Maja e Lepthit, Kepat e Dik Nelit, Manasdrenit etj. Në lindje të Selishtës, poshtë Arës së Shënkollit, është zbuluar edhe mineral radioaktiv. Dëshmi e kësaj janë tunelet, që akoma janë funksionale. E veçantë në rrethin e Dibrës për nga cilësia, veçoritë dhe përdorimi është dhe argjila e thinjur që gjendet në Lukan dhe që dikur është tregtuar deri në Dibër të Madhe. Ajo përdorej per ene dhe për larjen e rrobave e trupit. Guri cilësor gëlqeror është me shumicë në zonën tonë, ku vite më parë është shfrytëzuar për prodhimin e gëlqeres dhe zhavorit tepër cilësor, materiale të cilat u përdorën nga ndërmarrja e ndërtimit Peshkopi në ndërtimin e shumë pallateve e objekteve të tjera ndërtimi. Ka gur mermeri në vendin e quajtur Mbas Gjuri në Selishtë dhe në fund të Katundit të Vjetër. Po ashtu, në përroin e Shalcës në Mbas Deje është zbuluar dhe shfrytëzuar mineral bakri.



KATËR GRYKËT PËRBALLË TURIZMI MALOR E HISTORIK.

Natyra e Katër Grykëve është treguar bujare me burimet për jetesë, por njëkohësisht dhe me bukuritë që ka ofruar për banorët e saj. Për nga bukuria, vlera dhe rëndësia, nuk mundesh dot të lësh në vend të dytë Livadhine Madh në Zmaç, fushat e pafundme gjithë gjelbërim të Pratit në Selishtë, livadhete qëndisura me lloj-lloj lulesh të Lulaçit e Kshizës në Lukan, Fusha e Vanasit dhe e Pelave, Zhuri i Pllajut, që u qëndron mbi krye me plot hijeshi Guri i Vashës e rezervuari ujor i Lukanit; e mbi të gjitha, të papërsëritshmit e të pakonkurueshmit, liqenet e kurorës së Balgjajt. Në jehonë të këtyre bukurive, të bie ndër mend itinerari që dikur ndiqnin shkollat e zonës gjatë ekskursioneve e marshimeve. Përmendim këtu: Livadhet e Gjurrës, Prat, Shtruksën, Sheshin e Madh të Kacnisë, Bataqet, Fushën e Lathit, kalanë e Skënderbeut, Livadhet e Gjurrës, Fushën e Vanasit, Gurin e Vashës, Liqenin e Lukanjakve, Fushën e Pelave, Sheshin e Pule etj. Janë pikërisht këto vende dhe të tjera, që zona jonë i ka me shumicë, që të grishin t'ua shijosh bukuritë.

Me gjashtë liqene përrallore në Shtrunksë, me katër liqene të mëdhenj e disa liqene më të vegjël në Bataqe, me liqenin e mbuluar me zambakë të Kolemadhit, të gjitha këto në anën e Kacnisë; si dhe me liqenet e Allamanit në krahun e Matit e liqenin e Bulqizës, kurora liqenore e Balgjajt është një perlë e vërtetë, që natyra ua ka dhuruar me dashamirësi Katër Grykëve. Çuditem se cili sy nuk e pa, që nuk e shpalli park kombëtar, por vetëm monument natyror. Unë të paktën e kam parë. E kam parë, pasi kam shkelur me këmbë terrenin që nga Krej-Lura e deri në Bulqizë. Nëse dhe ju do ta shikonit si dhe unë, do të ndanit pa dyshim të njëjtat mendime. (A.T.)

Kanionet në përrua të Lukanit, mes Lukanit e Selishtës, si dhe ai që fillon në fund të Selishtës e mbaron në Muhurr, ia shtojnë më tej bukuritë natyrës së zonës. I njëjti konfiguracion paraqitet dhe midis Kepit të Çetës dhe Kepit të Skënderbeut. Ata ofrojnë gjithashtu mundësi të shumta si për të apasionuarit e lartësive shkëmbore, ashtu edhe për të apasionuarit e raftingut në lumenj të rrëmbyer malorë.Po ashtu, në jehonë të gojëdhanave e historisë tregimtare të trevës, qëndrojnë ballë për ballë njëri-tjetrit dy Gurët e Vashës, njëri në jug të Selishtës e tjetri në Vanas, në veriperëndim të Lukanit, të cilët, me hijeshinë impozante që prezantojnë, të ftojnë t'i vizitosh e t'i shijosh bashkë me bukuritë që i rrethojnë.

Nga maja e Tollës në Zmaç e deri në Selishtë, nga maja e Runjës, e mbuluar me kullota alpine, që shkojnë deri në 1200 gjatësi deri në lagjen e sipërme të Lukanit, gjatë muajve me borë të dimrit mund të provohet kënaqësia e zbritjes me ski nga lartësitë malore. Edhe pse sporadik, turizmi malor në Katër Grykë në funksion të të ardhurve ka ardhur në rritjë. Bukuritë tona kanë qenë objekt vëzhgimi nga shumë turistë vendas, por dhe të huaj, si: çekë, nordikë, zvicreanë, gjermanë, anglezë etj.

Në konkludim të evidentimit të vlerave turistike që burojnë nga zona jonë, do të sugjeronim pika të tilla me vlerë për t'u vizituar si: liqenet e Shtrunksës, liqenet e Bataqeve, liqenin e Kolemadhit, maja e Runjës, Vanasi, Guri i Vashës, fusha e Pelave, rezervuari i Lukanit, kalaja e Varoshit, livadhe në Prat, maja e Qytezës, livadhet e Gjurrës në Prat e Katund të Vjetër, maja e Shën Gjonthit, maja e Tollës, Livadhi i Madh në Zmaç.

Treva e Katër-Grykëve, edhe pse në dukje e veçuar si nga Dibra, ashtu edhe nga Matja, të mahnit me thesaret që fsheh nën pluhurin e shekujve. Rrethohet nga katër kala: Stelushi, Shënepremtja, kalaja në Kep të Hane dhe në Majë të Qytezës së Selishtës. Besimi katolik, si mbizotërues deri dy shekuj e gjysmë më parë, ka lënë pas mjaft objekte kulti, rrënojat e të cilave ekzistojnë edhe sot: kisha e Qafë-Murrës, e Katundit të Vjetër (mbi rrënojat e së cilës qe ndërtuar xhamia, edhe kjo e rrënuar), kisha e Lunarës, kisha e Shën Gjonthit, kisha e Hyse, kisha e Livadhit, kisha e Qytezës, kisha e shën Lukës e kisha e Shënepremtes. Është pikërisht kjo larmi e madhe objektesh arkeologjike, shtuar këtu vendbanimin e Manasdrenit, që daton para erës sonë, aktivitetin e gjerë lidhur me përpunimin e metaleve në Balgjaj, dëshmi e të cilit janë mbeturinat e shkrirjeve, të cilat nga banorët etiketohen me emrin "bram xhipi" e që mund të gjesh me shumicë, si dhe shumë objekte që mund të nxjerrë e ardhmja në dritë, që u jep Katër-Grykëve një vend të veçantë në këndvështrimin historik dhe të turizmit përkatës. Njëkohësisht këtu shtojmë dhe Shpellën e Lukanjakëve, e cila ka gjurmë banimi shumë të hershme dhe që duhen studiuar në detaje. Shpella me Shtij në Zmaç po ashtu përbën një objekt të veçantë e që duhet studiuar, duke mos ua lënë në dorë abuzuesve që në këtë rast kanë vënë dorë mbi të. Jo vetëm ky objekt, por dhe shumë objekte të tjera arkeologjike janë të pastudiuara, apo janë studiuar pjesërisht. Ndihmesë në këtë drejtim kanë dhënë studiuesit prof.S. Anamali lidhur me banimin e hershëm në Varosh dhe prof.Adem Bunguri lidhur me vendbanimin e lashtë të Manasdrenit.

SISTEMI RRUGOR I ZONËS

Siç dhe kemi përshkruar më sipër, Katër Grykët gjenden në një pozicion shumë të favorshëm, midis Dibrës e Matit, Bulqizës e Lurës. Kjo ka bërë që zona jonë të jetë e mbuluar nga një rrjet shumë i madh rrugor automobilistik e këmbësor. Aksi kryesor që përshkon Katër Grykët ka shërbyer si nyje lidhëse rezervë, në rastet kur bllokohej rruga nga që kalonta nga Bulqiza. Shumë degëzime të arterit kryesor janë ndërtuar me qëllim të shfrytëzimit të pasurive mbi e nëntokësore. Rrugët kryesore që e përshkojnë dhe që shërbejnë si ura lidhëse me trevat që e rrethojnë po i paraqesim si më poshtë:

Rruga e grykës së Murrës, e përshkruar në drejtimin lindje-përëndim: në Arë të Shënkollit, ku bashkohen rrugët që vijnë nga Arapi i Epërm, si nyje lidhëse me Dibrën e Epër dhe nga Muhurri,



si nyje lidhëse me Dibrën e Poshtme, vijohej dikur poshtë Kepit të Rrehnave, Bufull, Udha e Poshtme del te Teqja e Manukës, lagjia e Hane, Mbas Gjurit, përgjatë rrjedhës së Murrës, duke kaluar poshtë Lunarës, te Ura e Grupit, gjithë gjatësia e Murrë-Qafëmurrës, Limoqe. Tashmë rruga automobilistike ka bërë që nga Ara e Shënkollit të ngjitesh në Kep të Rrehnave, Bufull, Selishtë, Lunarë, Murrë, Limoqe e Qafëmurrës. Në Limoqe rruga merr disa drejtime, të cilat vijojnë nëpër territorin e Matit e Lurës.

Drejtimi i parë: Rruga automobilistike që kalon nga kisha e Limoqes, Stelush. Nga Stelushi



në anën jugperëndimore e jugore rruga të çon nëpërmjet Fushës së Bunarit në Vig, Lis e më tej. Rruga automobilistike që vijon në anën veriore drejt Vanasit të shpie, si dikur, në udhën e vjetër drejt Çidhnës, ndërsa ajo drejt Gurit të Vashës të shpie drejt Fushë-Lurës e Gur-Lurës. Kjo rrugë është e kalueshme vetëm me mjete të larta, pasi nuk është mirëmbajtur.

Drejtimi i dytë: Rruga këmbësore që kalon në Limoqe, Mbas Qafe, Vinjoll, Lis e më tej.

Drejtimi i tretë: Është dhe një rrugë malore këmbësore, që kalonte dikur nga Kepi i Rojsve, Qafa e Shtajllit, Manasdre, Qafë-Mesë për në Klos. Për të shkuar në Manasdre sot shkohet nëpërmjet rrugës automobilistike anës perëndimore të Mllezës, Tehu i Kryqit, Manasdre e deri në Fushë të Lathit. Më tutje vijohej me destinacion Kurdarinë ose Qafën e Buallit me rrugë këmbësore.

Rruga e Dibrës së Epër. Kjo rrugë frekuentohet gjatë periudhës që nuk ka dëborë, pasi në Qafën e



Pratit bëhet e pakalueshme për automjetet. Banorët e zonës sonë dikur, por dhe sot e kanë shfrytëzuar këtë drejtim për të shkuar përmes Gjurasit në Shupenzë e Dibër të Madhe. Gjatë periudhave me dëborë ndiqej drejtimi nga Ara e Shënkollit, Arapi i Epër e Lishani i Epër, Gjuras e më tej.

Rruga këmbësore e Dibrës së poshtme. Kjo rrugë shfrytëzohet për lidhjet me Shqathin, Hurdhë-Muhurrin e më tej. Dikur në këtë dretjim vinte kryeheroi Skënderbe nga kalaja e Çidhnës për në Stelush, përmes Benës, lagjes së epërme të Lukanit, Qafa e Lukanjakëve, Katundi i Vjetër, Qafë Murrë, Stelush.

Rruga e Bulqizës. Zona jonë ka marrëdhënie të shumta dhe me Bulqizën. Për të vajtur në Bulqizë shfrytëzohej rruga këmbësore Selishtë, Zmaç ose Kacni, Kepi i Selizës, për të dalë në Qafë të Helmës e për të vijuar drejt Bulqizës.

Rruga e Lurës. Kjo rrugë ka qenë këmbësore, por, me qëllim shfrytëzimin e lëndëve drusore dhe të nëntokës, është ndërtuar rruga automobilistike. Zona jonë shfrytëzon dy rrugë për të shkuar në Lurë, të cilat është e mundshme të përshkohen nga automjete të larta:

Lukani, Selishta e Kacnia shfrytëzojnë rrugën tradicionale Lukan, Lulaç, Kshizë për të dalë në Vanas ose te Guri i Vashës, në varësi të destinacionit, vijimin e të cilit e përshkruam dhe më sipër.

Qafa e Murrës shfrytëzon rrugën Kisha e Limoqes, Stelush, Vanas ose Guri i Vashës më tej drejt Gur-Lurës e Fushë-Lurës.

Ky është rrjeti i komunikimit rrugor të Katër Grykëve me trevat që e rrethojnë. Vetë pozicioni gjeografik ku ndodhen, u ka krijuar mundësinë e komunikimit të vazhdueshëm me shumë treva: në anën lindore ka pellgun e Dibrës, në jug Bulqizën, në perëndim Matin e në veri Lurën. E mbuluar nga një gërshetim aq i madh udhësh komunikimi, të bën përshtypje mungesa e një rruge të asfaltuar që do të lehtësonte aq shumë komunikimin me Dibrën e Matin, jo vetëm të banorëve të kësaj zone, por dhe të vetë Dibrës e Matit. Duke qenë se rruga automobilistike ekzistuese, me pak devijime, është ndërtuar para vitit 1940, ajo nuk kërkon shumë shpenzime, pasi tabani i saj është i ngjeshur dhe stabël. Një përshkrim të detajuar lidhur me çështjen që trajtuam, ka bërë I.Kaca me studimin "Rrugët e vjetra të Dibrës".

IMPAKTI I LIDHJES ME RRUGËN E ARBRIT

Gjatë dekadës së fundit është punuar për rivitalizimin e Rrugës së Arbrit, rrugë që ka funksionuar që kur nuk mbahet mend, për lidhjen e trevës dibrane me Tiranën, Durrësin e Krujën. Përfundimi i saj do ishte një frymëmarrje lehtësuese në shumë e shumë drejtime, jo vetëm për Dibrën, por edhe më gjerë, për vëllezërit tanë në Maqedoni. Natyrisht që ndërtimi i saj do sjellë efekte pozitive dhe për Katër Grykët. Nga rrugët që përshkruam më sipër, më të mundshmet për t'u lidhur me Rrugën e Arbrit me mjete të motorizuara janë:

Rruga ekzistuese që vjen nga Muhurri. Kjo rrugë është e paasfaltuar nga Muhurri në Lis në gjatësinë 47 km. Me gjithë ndërhyrjet që janë bërë, ka nevojë për përmirësime të tilla si: rindërtim urash, vendosje tubinash dhe zgjerim të saj. Kjo rrugë do ishte mirë të pësonte një devijim, duke lënë në krah të djathtë Stelushin, duke u kthyer majtas në drejtim të Vinjollit e duke vijuar rrugën automobilistike të këtij fshati për në Lis, Burrel e më tej. Nëse ana e Matit do zhvillonte një rrjet rrugor të përshtatur për t'u lidhur me Rrugën e Arbrit në drejtim të Klosit, kjo gjë do t'i shërbente shumë dhe zonës sonë, duke e bërë të domosdoshëm ndërtimin e një segmenti të ri rrugor bashkues nga Limoqja deri një Vinjoll. Kjo rrugë ka dhe një avantazh tjetër: nuk bllokohet rëndë nga reshjet e borës. Me anë të kësaj rruge realizohet komunikimi jo vetëm me Rrugën e Arbrit nga lindja, por dhe me Rrugën e Kombit nëpërmjet itinerarit Lis- Shoshaj – Perlat –Rreshen e më tej.

Rruga që lidh Selishtën me Gjurasin, me qëllim komunikimin me Shupenzën e më tej, do të ishte drejtimi më i favorshëm dhe më i shkurtër për t'u lidhur me Rrugën e Arbërit. Në këtë rast, gjatë muajve me dëborë, do të lypsej një përkujdesje e vazdueshme, sidomos nga Shkalla e Pratit deri në atë të Gjurasit me mjete borëpastruese. Lidhja e zonës sonë me rrugë automobilistike të qëndrueshme, cilësore, të asfaltuar dhe të përshkueshme gjatë katër stinëve të vitit është një sfidë, por njëkohësisht dhe një domosdoshmëri. Ajo do të rilindte dhe krijonte aktivitete të shumta, që do të ringjallnin ekonominë dhe mirëqenien e popullatës që jeton në të. Gjithashtu do t'i bënte më serioze investimet në blegtori e bujqësi. Do të krijonte lehtësira të shumta lidhur me hapjen e aktiviteteve për nxjerrjen e minerialit të kromit. Me male shumë të pasura në pyje e bimë medicinale, kurora e saj malore do ishte një ftesë për ushtrimin e turizmit malor.

Këtë e përforcojnë për më tepër bukuritë përrallore të liqeneve të Balgjajt e Bataqeve, si dhe



Maja e Gjelave ne livadhet e Gjurres

ato të Pllajut, Vanasit, Rezervuarit të Lukanjakve, Fushës së Pelave e Kshizës etj.. Një vend me shumë kisha e kala, të cilat paraqesin inforamcion shtesë për kureshtarët, ka shumë për të thënë në drejtim të turizmit. Gjallërimi i veprimtarive turistike do të bënte të mundur krijimin e infrastrukturës mbështetëse dhe kjo do ishte një burim shtesë i të ardhurave si për banorët, ashtu edhe për shtetin. Duke mos patur synimin të ngjall xhelozinë e trevave tjera dibrane, të cilat dhe ato kanë veçoritë e veta në shumë aspekte, nuk do të bëja gabim të thoja se Katër Grykët janë një vend i bekuar nga zoti. Ata presin dhe bekimin e dorës njerëzore, një detyrim e përgjegjësi shumë e madhe për të gjithë ne.

Sido që të vendoset zgjidhja për integrimin e zonës sonë me rrjetin e përmirësuar rrugor kombëtar, me Rrugën e Arbrit dhe të Kombit, një gjë është e qartë: dikush, dikur dhe diku do të ulemi e të diskutojmë se ç'do bëhet me ne. Le të fillojmë që sot, që, të paktën, e ardhmja të mos na mallkojë.

**Projekti “Shtëpi për të pastrehët” zgjerohet e zgjerohet çdo ditë e më tepër.
Nuk është thjeshtë dibranët për dibranët, por shumë më tepër se kaq...**

Strehë të ngrohta për njerëz

Nga **OSMAN XHILI**

Pesë vite më parë në kanalin e televizionit “Zhupa”, në Dibër të Madhe u transmetua një intervistë për një familje në nevojë. Bëhej fjalë për familjen e Gëzim Karametit me nëntë anëtarë. Shumë qytetarë u shprehën të gatshëm për ta ndihmuar, duke dërguar ushqime, veshmbathje e sende të tjera konsumi. Skënder Kërçishta, një komshi i familjes i kësaj familje, duke shprehur mirënjohje për gjithë qytetarët që ndihmuan me këtë rast, tha se përsëri kjo nuk mjaftonte. Duhej bërë një punë më serioze, më solide, më afatgjatë. Familjes Karameti i duhej së pari një banesë, ashtu siç e kishin gjithë njerëzit e tjerë

Skënder Kërçishta tregon se njerëzit më erdhën në shtëpi e më takonin në rrugë, duke konfirmuar gatishmërinë për ndihmë e duke më pyetur se ku mund të depozitonin ndihmat e tyre. Ai nuk e dinte se ashtu, spontanisht ishte krijuar një si shoqatë ndihmëtare për njerëzit në nevojë dhe ai, bashkë me shumë të tjerë do të ishin drejtuesit e kësaj shoqate. Ashtu si në përralla do tu dhuronin të pastrehëve shtëpi të bukura, që si kishin parë dhe në ëndrra.

Shumë shpejt, shoqata i shtriu degët, në Europë, në Amerikë e kudo ku gjenden dibranët. Skënderi nuk gjen dot fjalët për të falënderuar bashkëpunëtorët, anëtarë drejtues të shoqatës, ata që kurrë nuk u lodhën nga kjo punë fisnike, ata që ndanë një pjesë të pasurisë së tyre, për këto familje të varfëra me plot halle.

Bekim Paçuku është njeri prej tyre. Nuk ishte më shumë se 14 vjeç, kur la Dibrën, që e deshi aq shumë dhe mori rrugët e kurbetit. E bëri një betim, se kurrë nuk do ta harronte vendlindjen e tij. Punoi shtatë vite në Itali e më tej e ndaloi hapin në Amerikë, shteti i disiplinës së hekurt, por dhe i shanseve të mëdha. Falë një pune titanike, që vetëm dibranët dinë ta bëjnë, Bekimi hapi firmën e tij të ndërtimtarisë dhe çdo ditë e më tepër i shton parametrat e firmës, por dhe të dinjitetit e personalitetit të vet. Ai nuk harron atë ditë kur u largua nga vendlindja the bëri premtimin e madh se nuk do ta harronte. Ndihmat e tij, të Mondi Imerit dhe shumë biznesmenëve të suksesshëm dibranë, vërshojnë nga

Skënder Kërçishta tregon se njerëzit më erdhën në shtëpi e më takonin në rrugë, duke konfirmuar gatishmërinë për ndihmë e duke më pyetur se ku mund të depozitonin ndihmat e tyre. Ai nuk e dinte se ashtu, spontanisht ishte krijuar një si shoqatë ndihmëtare për njerëzit në nevojë dhe ai, bashkë me shumë të tjerë do të ishin drejtuesit e kësaj shoqate. Ashtu si në përralla do tu dhuronin të pastrehëve shtëpi të bukura, që si kishin parë dhe në ëndrra.



Skënder Kërçishta, anëtar i bordit drejtues të projektit “Shtëpi për të pastrehët”

Amerika në drejtim të njerëzve në nevojë. Bekimi sot është anëtar i shoqatës atdhetare “Dibra”, në Neë York dhe drejtor i degës së bamirësisë për shoqatën në fjalë. Në një komunikim të shkurtër me Bekimin, ai thotë se që nga dita që jam larguar nga Dibra, kurrë nuk i’a kam kthyer shpinën asaj. Bujaria, ndihmat dhe kontributet e dhëna janë dëshmi e gjallë dhe provë e pakundërshtueshme për këtë.

Të tjerë e të tjerë ndihmëtarë e veprimtarë punojnë për projektin “Shtëpi për të pastrehët”. Leonard Kosovrasti sjell vazhdimisht ndihma nga Gjermania e po kështu bëjnë Ramazan Opre nga Italia dhe Artan Damani nga Zvicra. Ata sensibilizojnë dibranët e më shumë akoma, në vendet ku jetojnë e punojnë për të kontribuar për vendlindjen, për ti kthyer buzëqeshjen asaj familje dibrane, që ndoshta e ka humbur atë nga trillet e fatit.

Një tjetër veprimtar shumë i nderuar i këtij grupi fisnik është Artan Duka, një bisnesmen i ri, por shumë i suksesshëm, që nuk është larguar nga Dibra. Ai ka një firmë të përpunimit të rërës, zhavorit e granulateve të tjera dhe nuk len rast pa

Projekti “Shtëpi për të pastrehët” zgjerohet e zgjerohet çdo ditë e më tepër. Nuk është thjeshtë dibranët për dibranët, por shumë më tepër se kaq, duke shtuar dhe elementë të tjerë përveç shtëpive, siç është komplekse vetë jeta njerëzore. Skënder Kërçishta, njeriu që kam pranë, që flet pak e punon shumë, ka marrë shumë goditje në jetë. Fillimisht ndërroi jetë djali i tij, student për teologji në Kajro e më pas bashkëshortja e tij e nderuar.

shtuar ndihmesën e tij, sa herë që ajo është e nevojshme. Në të gjitha xhamitë, apo shtëpitë e hallexhinjve, që ndërtohen, rëra e zhavori do të jenë dhuruar bujarisht nga Artan Duka. Ai është krahu i djathtë i Skënderit për Dibrën. Beson fort se rruga e Arbrit, jo vetëm do të shtojë lidhjet e komunikimin fizik, por dhe atë shpirtëror mes dibranëve, në të dy anët e kufirit.

Ja, kështu të bashkuar, si një dorë e vetme, biznesmenët dibranë, në Dibër, Europë, apo në Amerikë, koordinohen, bashkëveprojnë e projektojnë një të ardhme më të mirë për veten e tyre, por dhe për njerëzit e tjerë. Projekti “Shtëpi për të pastrehët” vazhdonte të zgjerohej dhe pas familjes së Gëzim Karametit që u bë me shtëpi të re dhe shumë projekte të tjerë u vunë në udhën e realizimit. Skënder Kërçishta kujton disa prej tyre.

Bedri Upaleni ishte një nga familjet e pamundura nga ana ekonomike. Familja e tij ishte e vetme në fshatin Shullan, pranë kufirit. Për të dhe familjen e tij u ble një shtëpi me 23 mijë dollarë, si dhe plotësimi i saj brenda me orenditë e nevojshme.

Një tjetër familje në gjendje të rëndë ekonomike ishte ajo e Besnik Karametit. Ata kishin një shtëpi të shkatërruar pranë vendgrumbullumit të mbeturinave. Një



Gjatë ndërtimit të shtëpisë për familjen Kodra.

ditë prej ditësh dhe ajo u dogj, bashkë me njërin nga fëmijët dhe familja mbeti në qiell të hapur. Projekti “Shtëpi për të pastrehët” shtriu sërish dorën bujare, duke i ndërtuar një shtëpi të re, me mbi 23 mijë dollarë.

Sabaudin Lela, me gruan dhe katër fëmijët, jetonte me qira prej shumë vitesh. Kryefamiljari ishte i sëmurë dhe i pamundur për të punuar. Për të dhe familjen e tij u ble një shtëpi prej 27 mijë dollarësh dhe ajo u kompletua më së miri për një jetesë sa më normale. Ai falënderoi Zotin së pari, por dhe këta njerëz të mirë, që hoqën një pjesë të pasurisë së tyre, për ta futur familjen e tij në rrugën e normalitetit.

Ja kështu shtohet numri i familjeve që kanë përfituar nga këta njerëz fisnikë e shpirtmëdhenj. Nuk po i përmendim të gjitha, duke e mbyllur me rastin e fundit, historinë e familjes Kodra, me shumë pjesëtarë. Ata prej vitesh jetonin me qira dhe në vështirësi të madhe ekonomike. U hap dhe për ta një dritë, një shpresë, falë këtij grupi njerëzish bujarë. Atë që nuk e bën shteti, që e ka për detyrë, e bëjnë bashkime të tilla njerëzish, të cilët e kanë kuptuar sekretin e kësaj jete e të kësaj bote. Asgjë nuk merr njeriu, kur ndërron jetë, as mall, as pasuri. Vetëm veprat e mira, si këto që përmendëm, do ta shoqërojnë atë deri në ditën e gjykimit para të madhit Zot. Ka muaj që punohet për shtëpinë e familjes Kodra. Ajo është dy katëshe dhe ka katër hyrje. Vetëm një muaj kohë ka deri në përmbyllje dhe familja e lumtur do të shijojë kënaqësinë e pamatë që të jep një shtëpi e bukur.

Të gjithë e dimë që orteku nis i vogël dhe bëhet gjigant për nga përmasat. Projekti i këtyre njerëzve të mirë sa vjen e zgjerohet. Të gjithë duan të solidarizohen, të japin sado pak. Skënder Kërçishta na tregon se Altin Paçuku ka bërë falas instalimin e rrymës, Abdul Bajra ka ndihmuar me punimet hidraulike dhe ka paguar dy dyer, Qamil Kërkuti ka sjellë falas 1300 tulla dhe ka sistemuar vendin me fadromë. Ndihmesë ka dhënë fabrika “Kanuf”, që ka sjellë pllakat e gipsit për katin e dytë. Dy kontribues të tjerë janë Selaudin Kosovrasti për suvatimet e shtëpisë dhe Majlind Haxhirexha për pllakat e banjove.

Projekti “Shtëpi për të pastrehët” zgjerohet e zgjerohet çdo ditë e më tepër. Nuk është thjeshtë dibranët për dibranët, por shumë më tepër se kaq, duke shtuar dhe elementë të tjerë përveç shtëpive, siç është komplekse vetë jeta njerëzore. Skënder Kërçishta, njeriu që kam pranë, që flet pak e punon shumë, ka marrë shumë goditje në jetë. Fillimisht ndërroi jetë djali i tij, student për teologji në Kajro e më pas bashkëshortja e tij e nderuar. Ata i lanë amanet veprat e mira dhe bujarinë, ndaj Skënderi përpiqet për ta çuar në vend amanetin e tyre dhe bashkë me shokët e projektit të bëjnë sa më shumë njerëz të lumtur e familje të lumtura.

reportazh



Facebook/Grupi Artistik Lura

Lura, vatra e vëllazërimit

Nga MEVLUD BUCI

Kur më ftuan lurianët me 25 gusht të këtij viti, ndjeva një emocion të veçantë, se do të udhëtoja drejt kësaj treve magjepsëse për herë të pestë pas më shumë se dyzet viteve. Lura, përveç bukurive natyrore që ende mbahen pas stuhive të shkatërrimit prej motosharrave zhurmuese, është mbi të gjitha vend i njerëzve të mirë, bujarë, të mençur dhe të zgjuar e krenarë. Këtë radhë, nuk shkova më këmbë si atëherë para katër dekadave: Katër Grykët - Muhur - Zall-Dardhë - Lanë –Lurë e Lurë, por te Rruga e Kombit u nisa drejt Rrëshenit. E për të arritur deri atje, përmes një agimi që lindte prej majë malesh kisha ardhur me një mikrobuz të Lurës. Sapo kaluam Perlatin, te vendi i quajtur Livadh i Turkut filloi rruga e "ferrit", gropa- gropa, për gati 70 km, dëshmi e indiferencës makabre të të gjitha qeverive, të cilat sa herë kanë gënjyer për rregullimin e kësaj rruge aq të rëndësishme. Ish-deputetë të listuar e të votëbesuar, politikanë papagallë që i shqyejnë paratë me dhëmbë e dhëmballë, sa herë kanë gënjyer.

Pasi kalojmë Perlatin e Epërm ndodhemi në të djathtë të Selitës, së bashku me Ndrec Dedë Rajtën, shofer, nga Krej Lura dhe Enver Dedën nga Gur Lura dhe e shohim të arsyeshme të pushojmë pak në Kurbnesh. Duke parë me përmallim nga Zajsi e Valmari, shoferi më thotë me shaka: - Përse çuditesh or mik, këtej i thonë tokë e shenjtë, toka e këngëve; ndërkohë më erdhi ndërmend Gjok Beci, bir i Zajsit, korife i teksteve të bukura të këngëve popullore. Ai, si Naim Plaku i Dibrës dhe Lefter Çipa i Labërisë, bëri epokë me tekstet e tij aq të qëlluara. Në shembëlltyrën e tij më kujtohen edhe krijues të tjerë si Ilmi Kolgjeca e Arif Buci, Ali e Sherif Peka. Shkëputem një çast nga ky shirit i shkurtër i kujtesës dhe më duhet të shoh Enver Dedën, i cili vjen çdo vit për festë në Lurë, edhe pse është 58 vjeç dhe ka 42 vite që jeton në Kodër Balldre të Lezhës. Ai se ç'do të më thotë, sikur unë i kërkoj një kujtim, një mendim dhe sikur ta ketë kuptuar këtë shprehet: "E kam amanet nga babai të mos i harroj kullat. Prandaj edhe e rregullova shtëpinë në Gur Lurë. Një përrua që harron burimin, thonë çidhnakët, shteron".

Enver Deda është i 12-ti vëlla e me dy motra. Të 14 fëmijtë e Bajram Dedës çanë me djersë udhët e jetës, ngritën vila e pemëtore në Balldre, por kurrë nuk harruan kullën malësore. Në bisedë flasim për Gafur Dedën, intelektualin Abaz Deda, për heroin e punës Sali Deda që ra në krye të detyrës më 1985, i përfshirë nga orteku i borës… Jeta ka gjurmët dhe rrjedhat e veta…

* * *

Jemi në Mërkurth. Në të djathtë të rrugës automobilistike, rrugë e rrënuar, ndodhen kullat e shembura të Lleshajve, ja, ajo e rregulluara është e Luan Lleshit, ndërsa ajo e shembura e Sandër Lleshit , e gjeneralit ministër…

Pas qafës së Mërkurthit na u shfaq pllaja e bukur mes malesh, Kodra e Halleve, Kodra e Kaçorrit, Krej Lura me kullat e malit. Bakullemes, Kësula e Lurës më pas, Lura e Vjetër. Dielli po perëndonte në Fushë Lurë, vend me bukuri të rrallë. Në të djathtë vjen Nezhda e Lurës, Kurora me liqenet e kaltër, përballë, Runja e Lurës e në të majtë Lanë Lura.

Të parin takuam Faik Bucin, këngëtar i Lurës. Ai na drejtoi te lokali i tij, aty ku ishin artistë që kishin kurdisur tingujt e çiftelisë me gjëmimin e lodrave kushtrim.

Zef Doçi me shokë, Mendi Buci prisnin


Mevlud Buci dhe Ludovik Rajta

Gjurmët e mbresave në Lurë rrezatojnë përmes zemrës dhe fjalës së njerëzve të mirë, përmes artit e këngëve, janë shenja të forta vëllazërimi. Ndaj nga shpirti burojnë vargjet:

Lum çka le toka lurajne
Lum ç`petrita përkundi djepi,
Dritë lirie dhe tramundane,
Bij të besës, sokola shkrepi.
Nëpër mote në fole t`barotit,
Për atdhe e dritë të betimit,
Lurë moj bijë e Kastriotit,
Lurë moj vatër e vllaznimit…

njerëzit sipas Karareve të Lurës. Me ne ishte edhe krijuesi mirditor Fran Laskaj. Nezir Çupi, biri i Çup Alisë citon me dashamirësi Demir Lushën e Çidhnës përpara vezirit të Shkodrës: "I nderuar Fran, të mendoja një burrë të madh dhe jo kaq të shkurtër, prandaj po u përmend Lushën e Çidhnës që rrëzoi Vezirin e Shkodrës…"

Por Fran Laska ka shkruar mjaft tekste për grupin artistik "Lura", këngë për Ilmi Kolgjegjën (Thimi Mitkon e Dibrës) dhe për këngëtarin Arif Buci, të cilët nuk jetojnë më. Ai ka krijuar këngën "Tri mijë vjet jam Oroshian", lirika, këngë epike, është pedagog dhe redaktor në një shtëpi botuese në Lezhë. Janë mjaft këngëtarë si Mendi e Trëndëlina Buci, Ludovik Rajta e Hamit Batalli, Ibrahim Haldedja e Zaim e Arif Tollja, Skënder Mena e plot të tjerë që i japin tonin artistik grupit "Lura".

* * *

Pyeta për kullën e të paharruarit Halil Peka, i cili, para 40 viteve, ishte 104 vjeç dhe më ndihmoi për një studim timin lidhur me qëndresën e Lurianëve e Katër Grykëve kudër Malit të Zi në betejën e Kakarriqit në nëntor 1912. Dy djem, Hazis e Indrit Peka ishin kushërinjtë e tij; më prinë përpara... Te kulla e tyre, gjetëm kushërirën Xheladinin, 75 vjeç, ardhur nga Tirana që uronte kushërinjtë për festën e Shënmërisë. Aty u bisedua edhe për tri të papriturat e Lurës, për të cilat shkruan poeti e studiuesi Gëzim Loka në librin "Lura perla e Europës". "E papritura e parë- "Toka takohet me qiellin", e dyta - mikpritja, e treta - dendësia e ngjarjeve."

* * *

Pasi bëmë foto para bustit të heroit Gjok Doçi dhe i Nikollë Kaçorrit, në podium u ngritën këngëtarë e valltarë.

Janë 45 artistë. Përmes flladit të Kurorës jehonë vargjet dhe melodité përcjellë nga artistët Ludovik Rajta, Mendi Buci, Trëndëlina Buci, Hamit Batalli, nip i Gjok Becit, Ibrahim Haldeda, Zaim e Arif Tollja, Skënder Mena, Sherif Dervishi e të tjerë, si dhe vallet e bukura e burrërore të koreografit Bujar Goranxa, vallja e "treqind nuseve me duvak" që korrin një stuhi duartrokitjesh…

* * *

Pas programit artistik bëjmë foto me artistët, me Katriot Rajtën e Ri, nipin e Kastriot Rajtës që ra për humanizëm më 1985. Pastaj nisemi te kullat e gurta të fisit Rajta, aty ku shkëlqen uniteti i fisit dhe drita e bujarisë. Në sofrën e madhe me dhjetëra kushërinj, është Viktor Rajta, ish-ushtaraku e komandanti i kufirit detar e komandant në Kurbin, tani me banim në Florida të SHBA, kushërinjtë Iliri, Genti e kryemiku i kullës, Fran Gjoni (Margjini) i Mirditës. Nga Florida telefonon vëllai i madh i Viktorit, Pjetër Rajta. Artisti dhe organizatori Ludovik Rajta e ka mbushur oborrin e kullës trekatëshe me kushërinj e miq.

Të fundit nga Krej Lura u përfalëm me Sokol Rajtën e ri, birin e të paharruarit Nin Rajta, tregimtar e publicist, me intelektualin Bardhok Rajta.

Kurora e bjeshkëve, malet e blerta po shkriheshin, bëheshin një me perëndimin e diellit. Gjurmët e mbresave në Lurë janë të pashlyeshme, ato rrezatojnë përmes zemrës dhe fjalës së njerëzve të mirë, përmes artit e këngëve, janë shenja të forta vëllazërimi. Ndaj nga shpirti burojnë vargjet:

Lum çka le toka lurajne / Lum ç`petrita përkundi djepi, / Dritë lirie dhe tramundane, Bij të besës, sokola shkrepi. / Nëpër mote në fole t`barotit, /Për atdhe e dritë të betimit, / Lurë moj bijë e Kastriotit, / Lurë moj vatër e vllaznimit…

Lurë, Gusht 2019

Rruga e Arbërit nr. 161

Ndërsa shikojm lart kreshtave hije randa, duke u argëtuar e ndjerë kënaqësi me pamjet e majë maleve të Mullit, Didhjes, majës së Zezë, Kujgjatës shkambore me njollat margaritar të gjelbërta të disa shkurreve, barishteve etj.

Udhëtim drejt Lurës së shkretuar

Nga **SELMAN MËZIU**

Me dy koleg dhe dashamirës të natyrës ndërmorëm këtë udhëtim me dëshirën e mirë të shikonim nga afër ndryshimet dhe gjendjen reale të fosileve të pyjeve lurjane. Para se ti takoja përgjatë udhëtimit nga Miloti në drejtim të Rubikut vrejta me kureshtje pishnajat të mbjellura, tridhjetë vjet më parë që jeshilonin, vegjetonin në shpate të pjerrëta, biles edhe të grryera. E sot jetonin për bukuri me bisqet e simjetme, me të gjelbertën e çelur dhe rrënjët të futura në tokë e kurorat degë hapura e të harlisura. Edhe dushkajat tanima me shtatin mesatar por me një shpërndarje uniforme kishin zbukuruar peisazhet me relieve të valëzuara.

Ne ketë udhëtim kisha përkrah dy mirditor, inxhinierin Mark Zefi dhe teknikun e pyjeve Gjergj Dedaj. Në udhëtim e sipër, pimë kafen e mëngjezit në Perlat Qendër, të lokali Ermal Dukes i rrethuar me pisha deti dhe dushqe me nje krua dekorativ ujë ftohtë. Në udhëtimin në rrugën e asfaltuar, na u shpalos një kullë modern në një kodër bri rrugës. Ishte e çuditshme se kulla cilindrike, kishte një arkitektur jo të kullave tradicionale mirditore, me qoshe të gdhendura prej gjuri etj. Arkitektura e saj e veçantë, punimet prej druri, lartësia e saj formë cilindrike, shprehnin dukshëm milionat lek të shpenzuar nga juristi Alfred Duka. Kuptohet nga Perlati, ku origjina e hershme ishte nga dukagjini me të njëjtin fis me komandantin e betejës së Sfetigradit Pjetër Perlatin.

Kemi lanun rrugën me asfaltin e lëmuar, ku makina e Markut u fut pas një devijimi befasues, përmes ferrave në drejtimin Kurbnesh - Lurë. Ndërsa pyjet e dushqeve faqeve të kodrave, kodrinave, luginave të përrenjëve, na shoqërojn vazhdimisht duke na ndjellur kënaqësi. Nuk vonon dhe na shpaloset fshati Perlat i Epër, pothuajse i braktisur. Dukeshin shtëpitë e pakta të sistemuara, por edhe gërmadha të të tjerave që të indinjonin, të shkaktonin një keqardhje të thellë. Kolegu ynë Gjergji na shpjegoi se jo shumë larg nga këtu, ndodhet mes shkembenjeve gëlqerore Shpella e Valit e propozuar për Monoment Natyre nga Bashkia Mirdite. Kthinat e saja, struktura e gurëve gëlqeror e bëjnë këtë një monument të skalitur nga natyra me një mjeshtri mahnitëse.

Makina zbret në Zallin e Ndrejave. Një përrua ku nuk i shihesh shtrati nga mbulesa e dushqeve, shkozave frashërave etj. të harlisura. Sapo fillojm ngjitjen në një udhë tërë gropa, vështrimin ndalet në lagjen Hasanaj. E cila ndodhet në një shpatinë të jeshiluar ku duken ngjyrimet e gjelbërta, me ndryshime nivelesh arkitekturale, me dushkajat që janë misrat, jonxhat, pemët drufrutore etj. Në pjesën e epërme ngrihet hijerand, plotë hijeshi kulla e Pjeter Nikoll Sulejmanit si një shqiponjë që ndrit nga bardhësia e mureve. Por, ja që ngazëllimi, bukuritë peisazhistike që u shpalosën deri këtu duke na dhanun krah e frymëzim u coptuan sapo dolëm në livadhet e Tharrit. Germimet dhe rrugët përshkonin dhunshëm shpatet e kodrinat, duke shëmtuar ndjeshem pamjet kënaqësi ndjellëse. Morëm vesh se dhëmbët e shkatrimeve të politikës së hidrocentraleve do të nguleshin, thellë në zhbërjen e natyrës.

Hidrocentrali Bushi 1 do t'a merrte ujin nga një burim e përrua duke përshkuar dhunshëm me tubacion majën e Ngallit, faqen e saj. Ndërtesa e tijë, do të vendosesh në Zallin e Ndrejave. Ndërsa Bushi 2 do të burgoste me tubacionet e çelikta përrojin e Tharrit e do të përfundonte, pranë lagjes Ndreaj. Ku turbinat e sjellura prej forcës së ujit do të prodhonin energji elektrike. Kuptohet që gjallesat e shumta, bashkë me freskinë e ajrit, bimësinë, lagështi dashëse do të zhduken. Këto do të shëmtojn vlerat peisazhistike, natyrale e turistike të këtyre trevave. Por ja projekti për shkretim është gati.



Edhe peizazhi rrethues i Lan Lurës të linte shijen e hidhur të katastrofës ma të pamëshirshme mbi pyjet me bredh, ah, rrobull, etj. që në vitet 1980 rrethonte shpatet e kësaj rrafshnalte prej rreth 100 hektar e lartësi mbi nivelin e detit 1363 metra. Sigurisht mund të shkruajmë se për nga pozicioni gjeografik, për nga forma e relievit e botanikën e llojeve do ta kishin zili zvicranët, austriakët apo Italianët e krahinave veriore. Tanimë, ne inxhinierëve të pyjeve, nuk na ka mbetur gjë tjetër veçse t'u gëzohemi e ndjemë kënaqësi shpirtërore e profesionale me shkurrëzat e barërat një dhe shumëvjeçare që kanë mbuluar sipërfaqet e sheshta shpatet, luginat, rrëpirat përqark saj.

Kështu të ngarkuar me diskutime, debate për këto prodhues energjie që tanima janë bamun si shushunjat e kënetave që thithin limfën e natyrës, vazhduam rrugën ne drejtim të lakut Kryes i mbjellur para vitit 1990 me pisha të zeza, të rralla, përzier intimisht me dushqe, shkoza, frashër etj, me një shprehje panoramike tërheqëse. Arkitektura e gjelbërt e llojeve me një mbivendosje e gërshetim të tyre me thyerjet e relievit. Dikur e xhveshur dhe me rrëke të shumta, tanima bimësia shkurrore e drunore janë zgjuar, duke shoqëruar pishat të mbjellura nga dora e njeriut. Tregues i një bashkjetese, mirëkuptimi, ndërmjet njeriut e natyrës.

Ngjitemi përsëri duke përshkuar shpate, kurrize, vështrojm poshtë si në një humner natyrale gjigande, fshatin Kthellë e Eper. Vazhdojm udhëtimin përgjatë një shpatine me plote kthesa ku pishnajat, po merrnin formën e një pylli. Në faqen lindore njëpamje e dhimbshëme e një sipërfaqeje prej rreth një dylim, kishte skelete drurësh pishash, ngjyrë kafe ose të zeza, sepse në Janar 2019, kishte ramun zjarr, por, fatmirësisht i fikur shpejt. Këto pishnaja kishin futur në gjirin e tyre, me të gjelbërtën e thellë, mbeturinat e kafejta e betonime të fabrikes së pasurimit të Bakrit tanima të padukshme. Ku dikur punonin dhjetra punëtor e kalonin qindra tonelata bakërr.

Zbritëm në kuotën më të ulët, ku na u shfaq papritmas një ndërtes një katshe prej betoni, me dy dritare. Njerëz me mosha të ndryshme, që kishin gotat e rakisë përpara, bisedonin qetësisht. Përball, matan një përroi të thellë mbuluar me shelgje, verrij etj. ngrihesh gjigand një peisazh gri i nje masivi shkambor gëlqeor, Guri Gjon, Monument Natyre. Duke ulur vështrimin në të gjelbërtën qetësuese e mrekulluese shtrihet qyteti i vdekur, gërmadhor i Kurbneshit në një rryp toke gjatsore prej, afërsisht tre kilometra. Ngërdheshje ndërtesash të madhësive e formave të ndryshme që të futnin tmerrin. Krejtësisht i ndryshëm plote gjallëri e bukuri, qyteti i minatorëve i vizituar nga unë, për herë të fundit në tetor të vitit 1994.

Posht rrugës, shtëpia e teknikut të pyjeve, Pjeter Gjikola e mbuluar nga deget e drufrutorëve plotë gjelbrim. Me dhimbje e përshtjellime zemrimi shquam derën prej dërrase siguruar me drinin e ndryshkur. Na u duk sikur muret e bardha me njolla të nxira, të zymtuara sikur lotonin për njerëzit që e kishin braktisur. Ndërsa gropat e shumta, kanalet përgjatë udhetimit na spostonin zemërimet, revoltën, plagosjen shpirterore nga peisazhet e dhimbshme në mallkimet ndaj qeverisjes e deputetëve që nuk kishin investuar asnjë qindark për mirëmbajtjen e rrugës automobilistike. As deputeti Luan Rama i lindur në Kurbnesh nuk kishte kontribuar aspak, ndërsa nërtesa gjigande e arkivit të shtetit me atë të rezervave shtetëror me dritare e dyer të shkyera, me dhjetra goje të hapura pa asnje dhamb. Kishin një pamje të llahtarshme, të futnin tmerin, dukeshin sikur po hanin kalimtarët.

Një pyetje e thjesht më lindi: A nuk mund të rindërtohesh e përshtatesh në hotel? A nuk mund të bahen depot e rezervave, një muze, historik edhe për minierën? A nuk mund…??? Por, fatkeqësisht llampat e fantazise u fikën. Jetojm në një botë vrastare. Kalojm arat e lena djerr, duke ndjekur përroin e Urakës ose grykën e Selitës. Hera herës dëgjojm zhurmën e ujit që kalon në gurishtet e rrumbullakosorura, me reflekset e çuditshme plotë valëzime të ndritshme nga rrezet e diellit, por, edhe freskinë ajër pastër të tijë.

Ndërsa shikojm lart kreshtave hije randa, duke u argëtuar e ndjerë kënaqësi me pamjet e majë maleve të Mullit, Didhjes, majës së Zezë, Kujgjatës shkambore me njollat margaritar të gjelbërta të disa shkurreve, barishteve etj. Edhe Valmorëm kreshnike te egër duke I shtuar madhështinë natyrore, kësaj lugine. Sejcila prej tyre zbret drejt ujëpaktit perrua të Urakës me një pjerrësi marra mendëse e shkëmbinj gëlqeror gunga gunga e thepa thepa të pambarueshëm. Por, mrekullia e natyrës nuk ka të mbaruar, ajo jo vetëm të josh me këto relieve të thyera frikshëm ose butë butë, por, të fut në galeritë e të panjohurave të saja. Në xhepat e këtyre shkëmbinjëve, në këto



reportazh

Vikamat e këtyre trevave po shpojn qiellin që bubullinë vetëtinë e megjithatë askush nuk i dëgjon, i mëkon me dashuri, përkujdesje. A kam të drejt me ofshamat e mia?



plasaritje, duken si lulishte të varura ballkoneve, drurët xhuxha, shkurret e llojeve që nga ahu, shkoza, frashëri, fshikarta. Dëllinja e kuqe dhe zezë, zogla etj.

Ndërsa bërshenin e gjejm buze përroit të Urakës, në ecje e sipër dhe e fotografojm, duke menduar edhe përdorimin e tyre si dru shumë i fort, por, edhe si shkurre zbukuruse përherë gjelbërt me halat shumë më pak therëse se të gjinisë së vetë të dëllinjave. Malsorët e vendbanimeve të thella të këtyre anëve jane çvendosur. Kuptohet aty ku kanë gjetur pak tokë e malin pranë kanë ndërtuar shtëpitë modeste. ''Lugina e Urakës,...është formuar me thyerje të fuqishme tektonike dhe në pjesën më të madhe ka formën e germës ''V,,. Shpatet e saja janë shumë të pjerrëta, kurse shtrati është i ngushtë(3-5 m.) dhe formohet drejt për së drejti në shkëmbinjt rrënjësor. (formacione gëlqerore. S.M).,, (Gjeogr. Fizike e Shqip. F.142 Tirane 1991).

Pikërisht kemi formimet e disa shpellave, e masiveve më shkembenj gelqërore ku spikat Guri Gjon, i cili bie në një rrëpirë afro 800 m, mbi Kurbnesh, ne jug me nën pllajen e bukur karstike të Valmorës, e përbri Gurit Gjon ndodhet Shpella e Fatmirave e cila është me randësi të madhe edhe arkeologjike. Kanioni Shut të Keq, Monument Natyre shpalos më së miri bukurit natyrore, me faqet shkëmbore të thepisura dhe të veshura me bimësi të llojeve të ndryshme. Kurbneshi shquhet për numrin e shpellave, ku mund të përmendim Shpella Kusia e Ndue Gjonit, Monumet Natyre; Shpella Mërkurthit (Doçit) në dalje të Merkurthit, përgjate rrugës për në Kumbull; Shpella e Borës gjëndet nën majën shkëmbore të Didhes shumë e thellë, plotë kthina, xhepa, madhështore e kureshtëndjellëse me borë të përjetshme (të dy shpellat e fundit të propozura për MNatyre nga Bashkia Mirditë).

Thyerejet tektonike në krahun e luginës së Urakës duke u dhanun atyre formën e rrëpirave. Gjithashtu formojn dy kanione të fuqishme me origjinë ''tektoniko - erozive,, dhe përbërjen gëlqerore të tyre. Arkitektura e relievit me coptimet e tyre, duke filluar nga Valmora e maja Dëllinjës. Në te djathtë të lumit Urak, deri në Merkurth me një sipërfaqe te 3450 ha pjesë e Kunor Valmorit i është bashkangjitur Parkut Kombëtar Lurë - Mali Dejës.

Humbim pa dashje në peisazhet arkitekturore shumë formëshe, ku është shkrirë e gjelbërta e bimësis barishtore, drunore e shkurrore. Përpiqemi të futemi në dukurit natyrore mijëra vjeçare të formimit të tyre, në epoka gjeologjike të formimit e në ekositemet bimore, për t'iu pergjigjur pyetjeve të zakonshme: Si e qysh janë formuar gjithë këto krijesa në unitet veprimi e jete, lindje e shuarje të pjesshme?

Këtu drejt përdrejt Shehut të Keq, në përroin e Urakës, kanë qenë planifikuar dy hidrocentrale, të cilat me protestën e gjithë krahinës së Mirditës u fshine nga projekti, duke shpëtuar këto risi turistike nga shëmtira e kafshimeve të oligarkeve qeveritar. Duke vrejtur me kujdes, prurjet e tanishme të Urakes dhe ballafaquar me të dhënat e literaturës, të cilat shkruajn: ''Uraka në nëntor sjell 6.3m³/sek. kurse në maj 7.6 m³/sek... ndërsa burimi i Urakës me nje prurje mesatare vjetore 5.3 m³/sek.,,(po aty. f,148). Vallë çfarë llogaritjesh janë bërë nga projektuesit për sasinë e ujit që do të lëvizin turbinat? Apo do të ndërtoheshin për të pastruar parat e drogës, hajdutëve me këmisha qeveritare? Vazhdojme rrugtimin, ku përpara na del fshati Merkurth me shtëpiat gërmadha, çati të shqyera, sikur të kishte kaluar Totila i gotëve me trupat shkatrrimtare. Ne hyrje të fshatit, Ja aty, te ato kumbulla, lajthi e arra etj, me gjurme të një kulle të rrënuar e ka patur shtëpinë Gjeneral Sandër Lleshi, që kryen funksionin e Ministrit të Brendshëm, - ndërhyn Gjergji. Vështroni aty në qoshe të livadhit, ish shkollën,- na tregon Marku,- e ndërtuar nga një shoqatë skoceze në vitn 1991. Tanima ajo është shembur dukee shëmtuar peisazhin sigurisht pa malsorin blektor, rritës e mik i natyrës. E njëjta panoram rrënqethëse, na shoqëron që nga Kurbneshi e deri te fshati i shkretuar i Selitës.

Në Qafën e Mërkurthit hapet para nesh një fushë, me një gjelbërim e luleshumtë që të mrekullon. Vërtet një dhurat fantasitike e piktoreske e natyrës. Nga këtu ndahet një rrugë atomobilistike që të çon për fshatin Kumbull e Kroi i Bardhe, tanima i njohur edhe nga vizitoret austriak të shekullit të XIX si uji me vlera shëruese për disa smundje. Por, siç shprehen mirditasit në dialktin e tyre ''udha asht për dreq, mos pyet ma,..,, Befasitë natyrore nuk mdarojn, pranë rrugës Qafë - Mërkurth - Kunor, në të majtë të saj, ndodhet Shpella e Mërkurthit, brenda e zbukuruar mrekullueshëm me shumë stalaktide e stalakmide, me shumë kate e nën kate, me thellësi shume të madhe, me mjaft interes, jo vetëm për turizmin malor por edhe për studime speleologjike e arkeologjike. Për nga përmasat mund të jetë me hapsirat më të mëdha në Shqipëri. Kuptohet e harruar nga studiuesit shqiptar dhe mbi të gjitha nga qeveritë e këtyre 30 vjeteve. E cila nuk na çudit aspak për braktisjen e natyrës e peisazheve mrekulluese e fitimprurëse për malsorët. Ku vetë, ky popull e brezat që do të vijnë do ta paguajn shumë shtrejt.

Kalojm anash fushës së Krej Lurës me shpatin verior veshur me pyje të rinj pishash, ahesh etj. jo uniforme. Krahu tjetër i xhveshur me ngjyrën gri të shkëmbinjëve gëlqeror, me bimësi të pakët kryesisht barëra. Ndërsa në mes saj një si ishull me bredha, pisha, ahe, lajthi etj. duke i dhanun bashkë me qylymin e luleve një bukuri mahnitëse, tërheqëse e shumë dashuruese. Forma e saj ''e perzgjatur me gjatesi 2,3 km. e gjërsi afro 1 km.,,(po aty f. 142)

Shtrojm pyetjen: Kur do të kemi shtëpia pushimi, prej druri për pushime dimrore e verore? Ne krahun e majt në afërsi të daljes nga fusha, ngrihet një kishë modeste me disa shkurre, drurë e pemë frutore përkundruall. Disa njerëz hynin e dilnin. Me tej, në qafë shikojm një baxho, tre djem të ri, pinin duhan të ulur në trupa. Ajo ishte një katshe. Përreth saj disa kazana me zjarrin posht, që tymosnin pak sa. Përgjatë udhëtimi në të dy anët e rrugës, kemi pisha të zeza trup holla buzë rrugës, ndërsa në faqet e pjerrta duke u ngjitur, shikohen pisha të rralla e shkurre të ndryshme. Fatkeqësisht sa më shumë të ngjitemi ato veç rrallohen duke u zëvendësuar me shtresën e gjelbërt të shkurrëzave, grathateli, boronica e barërave të ndryshme. Dikur këto vende skeletike, me shkëmbinj të zinj, shumë të pjerrta, kanë qenë të mbuluara me pishnaja të pafundme. Rruga automobilistike i ngjante një tuneli të gjelbërt. Tragjedia 30 vjeçare duket qartë me gjurmët e saja shkretuese, rjepa- rjepa në panoramat e pështira të këtyre shpatinave, sa të shikon syri. Ndërsa shpati tjetër I Kodrës së Rreneva është shkatrruar nga grryerje e rëshqitejt masive. Vetëm e vetëm se u ndërtua në Arrmall një hidrocentral. Si rrjedhoj për të çuar materialet e ndërtimit e maqinerit, u hap një rrugë automobilistike, përmes shpatit shumë të pjerrët, me traktor me rrusp, pa projekte, pa studime gjeologjike, pa mure mbajtëse, pa transportimin e gureve e dheut në vend grumbullim të përcaktuar nga projektuesi.

Masakrimi i pishnajeve nga gjërsia e skrapatave, hedhja e dheut në pjesën e poshtëme, shkaktuan këtë tragjedi mjedisore. Këto peisazhe të shpërfytyruara, jo vetëm që janë një shëmtir e pa përfytyrueshme, por, edhe i pakthyeshëm ish pylli uniform me pishnaja. Pylli me pisha në Zabelin e Nikës ishte trungishte e re me diametër mesatar shtatë centimetra e lartësi rreth tre metra, por, duke u ngjitur, fillonte zhdukja graduale e pishnajeve e zëvendësimin me barëra e shkurrëza. Ja si shkruan gazetari Velo Cfaku në librin ''Një jetë në mes dibranëve,, në vjeshtë 1983 ''Dhe menjëherë u nisëm për në drejtim të Lures së Vjetër. Në të djatht të rrugës, në një ngjitje të shkurtër, kthyem drejtimin mesë- përmes pishave gjigande 40 - 50 metroshe, të drejta si qiri enë mjaft të tilla të bëra kllapa për të mbledhur rrëshirën e tyre.,,

Ndërsa po i afrohemi të ashtuquajturës qendër të Lurës, mua papritmas më erdhi një ofsham e madhe, keqardhje, çudije, tragjedie mjedisore e njerëzore. Në ecje e siper dy kostar, një burrë rrreth të 35 vjetëve e një i ri, jo më shumë se 18 vjeç kositnin bar mbi rrugën automobilistike pranë një prroske pa ujë. Një lopë me një viç dhe një magjer po kullosnin pranë e pranë. Zbresim te klubi. Aty na priti me shumë kënaqsi e buzëqeshje tekniku i pyjeve Imer Mena. U ulëm në klubin brenda ku gumëzhinte nga zëra të njerëzve të moshave të ndryshme. Të shponte hundën era e rakisë dhe tymi i duhanit, të cilat të helmonin trupin e të vrisnin shpirtërisht. Dhe ja ofshama që më doli nga thellësit e shpirtit**: Ah moj Lura shqipëtare dikur perla e bukurive dhe e njerëzve bujar e të qeshur ku paske ramun!** Qënka shuar e kaluara gjallnore, ndërsa e ardhmja e bërë tym duhani e erë mbytese rakie. Njerëzqë të shikonin me dyshime, të vrejtur, syskuqur, shumica me nalla plastike Heshtje brënda, heshtje jasht në kuptimin e të qeshurave, bisedave gazmore, punës në ara, rrugë e pyje. Fatkeqësisht si kudo në peisazhe fshatrash shqiptare, ngrehina shtëpiash të çara, me mure gjysëm të shembura, çatitë dukeshin si tollumbat e lulit të vocër migjenian.

Nuk qe e mundur të shkonim te liqenet për 19 km. rruge e cila duheshin makina të larta, të fuqishme, sepse ajo e ka humbur funksionin e ketij emërtimi. Është kthyer në kanale e gropa të medha, praktikisht të pakalueshme. Trishtuese e revoltuese kjo gjëndje e tyre! Të vrarë shpirtërisht e moralisht nga një udhëtim pa kokë. Fatkeqësisht që t'i vihej ajo, duheshin 10.000 lekë të reja. Shoferi ynë inxhinieri Mark Zefi, i apsionuar pas natyrës në përgjithësi, lexoi dëshprimin tonë, theu heshtjen duke thanë:

- Po në Lan Lurë a mundtë shkojm?

Ndërkaq i hodhi një vështrim teknikut të pyjeve që sigurisht ishte vendali.

- Po atje mundemi, por me shumë kujdes duhet të ecni,- iu përgjegj Imeri, i pezmatuar në shpirt që nuk mundi të na ndihmonte për të arritur qëllimin final.

Një ngjitje tepër e vështir, ku edhe vetë gjërsinë e rrugës, po qe se mund t'i themi kështu, duhesh t'a merrnim me kthesa, për të mos takur shasin nën motorrin e saj mjaft të fuqishëm, bashkëvuajtës në këtë udhëtim të stërmundimshëm.

Ndalemi në një kthes pa hyrë në derën natyrale, ku të shihnim rrafshnaltën e Lanë Lurës. Hedh vështrimin përball. Një hapsirë shpatesh, luginash si kryet e qerosit pulla - pulla, ku mbisundonin sipërfaqet e barëzuara pa pisha ose dy tre të shpërndara, vertet si qimet në kryet e qerosit. Me keqardhje, me hidhërim që më gërvishte brenda shpirtit tim, me një tundim mendor e psiqik të pa përshkruem nuk mbajta dot dhimbjet e asaj katastrofe hiroshimjane te cilën në shumë shkrime mbi Lurën e kam emërtuar.

Në këto peisazhe të shëmtuara marrëzisht nga hakmarrja e sistemit politik, ligjor dhe të banorëve të Lurës e jashtë saj. Vërtet politika e dallkaukeve të qeverive pas viteve '90 dhe e banorëve se pari lurjanëve, pastaj mirditorëve, matjanëve, dibranëve, kanë kryer veprën teje kriminale kundër mjedisit pyjor lurjan?

Edhe peizazhi rrethues i Lan Lurës të linte shijen e hidhur të katastrofës ma të pamëshirshme mbi pyjet me bredh, ah, rrobull, etj. që në vitet 1980 rrethonte shpatet e kësaj rrafshnalte prej rreth 100 hektar e lartësi mbi nivelin e detit 1363 metra. Sigurisht mund të shkruajmë se për nga pozicioni gjeografik, për nga forma e relievit e botanikën e llojeve do ta kishin zili zvicranët, austriakët apo Italianët e krahinave veriore. Tanimë, ne inxhinierëve të pyjeve, nuk na ka mbetur gjë tjetër veçse t'u gëzohemi e ndjemë kënaqësi shpirtërore e profesionale me shkurrëzat e barërat një dhe shumëvjeçare që kanë mbuluar sipërfaqet e sheshta shpatet, luginat, rrëpirat përqark saj.

Ndërsa kundroja i mahnitur ketë pllaj të stërmadhe se çmë shkreptiu në mëndje: Po një pllakat, shtatore, lapidar kushtuar luftës nga më heroike të Lane Lurës nuk po e gjej? Dhe ja një fragment i shkëputur nga libri i studiuesit dibran Bajram Xhafës: ''Lufta e Dibrës 1920,, ku ndër të tjera shkruan: ''Më 28 Tetor 1921, ditën e premte, forcat serbe dhe mercenare bënë një mobilizim, u ngjitën në shtigjet dhe kreshtat malore të Lanë Lurës dhe u hodhën në një sulm të përgjithshëm. Kjo ishte dita e tretë e betejës më heroike: beteja në Lanë Lurë.,, Lanë Lura e zhveshur nga pyjet që vegjetonin përqark, e zhveshur nga heroizmat, e mohuar nga politikbërsit e 30 vjetëve, e braktisur nga vetë lurjanët. Eskili mund t'a kishte shkruar një tragjedi mbi atë. Sigurisht! Vikamat e këtyre trevave po shpojn qiellin që bubullinë vetëtinë e megjithatë askush nuk i dëgjon, i mëkon me dashuri, përkujdesje. A kam të drejt me ofshamat e mia?

Rruga e Arbërit nr. 161

shënime

Teksa Ai më tregonte "rrobat" qull të lagura, unë mendoja "rrobat" kallkan të ngrira. Të dy pranë sobës, në hapësirën kohore të një dekade, unë në fillim të viteve '50-të e ai në fillim të viteve '60-të, kur na u desh të ecnim rrugëve të pa shtruara drejt dijes...

Mbase ky rrëfim i sinqertë i një mjeku "qull në shi" lexohet dhe disi kuptohet nga brezi me "sy për arrati"

Me Dr. Selim Horeshkën në mallin për vendlindjen

Nga **ABDURAHIM ASHIKU**

DËSHMITAR I KOHËVE

Jemi ulur, si çdo ditë, me detin përballë në plazhit të Malit të Robit.

Në buzë bashkë me lëngun e kafesë vëmë lëngun e jetës.

Të tij dhe timen.

E më ngjan se nuk po e intervistoj unë, por ai.

Ai është prej Sohodolli e unë prej Brezhdani, fshatrat më të mëdhenj të Dibrës, fshatra, në ndarje kohësh (të dhëna1991), njeri me 500 shtëpi e 2274 banorë (Sohodoll i Madh dhe Sohodoll i Vogël), e tjetri me 662 shtëpi e 3538 banorë (Brezhdan e Zdojan). Kështu i kanë rrënjët moti...

Takohemi shpesh në bisedë. Na përzihen kujtimet aq sa na bëhen një, penjëz të një lëmshi që ndërthuren me njeri tjetrin e rrotullohen në furkën e kohëve.

E gërryej për të marrë diçka nga fëmijëria e tij. Jo si një "përrallë nga e kaluara" por si një dokument shpirtëror që del e merr dheun nga arkivi i jetës.

E pyes për Sohodollin e fëmijërisë së tij...

ÇDO DITË NGA SOHODOLLI NË PESHKOPI, TË LAGUR E TË MËRDHIRË, ME DËSHIRËN E MADHE PËR DIJE...

Të paktën prej kur isha tre vjeç e mbrapa, kujtoj shumë gjera. Në mënyrë të veçantë pasi fillova klasën e parë.

Mësuesi im i klasës së parë ka qenë Xhafer Merdini. Ishin klasa dyshe në atë kohë. Gjysma ishte klasë e tretë dhe gjysma ishte klasë e parë. E vështirë për mësuesin por edhe për ne...

E fillova në vitin 1961...

Pastaj në klasën e dytë me mësues Ismet Çoren...

Në klasën e tretë me Bexhet Cibakun...

Në klasën e katërt me Agim Erebarën...

Me këtë rast dua tu shpreh respektin e thellë dhe mirënjohjen time për atë që na dhanë me përkushtim e me shpirt të madh.

Sapo mbaruam shkollën fillore kaluam në tetëvjeçare që ishte në Kastriot, Brest. Ishte viti i parë që u kalua nga shtatëvjeçarja në tetëvjeçare.

Gjithmonë kemi pas shokë të mirë dhe mësues të mirë që nga fillorja derisa kemi mbaruar universitetin. Vlerësimi im për shokët dhe për mësuesit ka qenë maksimal sepse ashtu ishin në të vërtetë.

Mbasi mbaruam tetëvjeçaren ishte një grup i madh nxënësish nga Sohodolli që filluam gjimnazin. Para nesh kishte filluar një grup më i vogël me Xhelil Cibakun, Zihni Methasanin e shumë të tjerë që ishin tre vjet para nesh. Dhe pas këtyre ishte grupi ynë. Dhe mbas grupit tonë ishin edhe shumë e shumë të tjerë që kishin mbaruar tetëvjeçaren para nesh e që filluan shkollë nate.

Çdo ditë nga Sohodolli në Peshkopi. Në këmbë, dy orë rrugë vajtje e dy ardhje. Unë, Faris Cibaku, Bardhyl Cibaku, Sefë Cibaku...një grup shumë i madh.

Dhe kur hipnim ndonjë herë rrallë në ndonjë makinë ishte fat.


Pjesën më të madhe të ditëve, veçanërisht dimrit, kur shkonim në shkollë ishim të lagur ujë. Ora e parë na shkonte për tu tharë tek soba. Nuk më kujtohet që ndonjëri prej nesh të ketë pas çadër.

Përgjithësisht me kostume sportive dhe dimrit me ndonjë gjë tjetër shtesë por gjithnjë na binte në kohë të keqe të shkonim të lagur ose të mërdhitur.

Të gjithë ata që mbaruan shkollën e mesme në Peshkopi nga Sohodolli, të gjithë mbaruan universitetin me rezultate shumë të mira dhe punuan si kuadro në arsim, shëndetësi, bujqësi, ushtri etj.

Të mesmen e mbarova në vitin 1972. Po në vitin 1972 fillova universitetin në fakultetin e mjekësisë. Nuk kishim detyrim stazhi një vit, si u bë më vonë, ndaj shkuam direkt.

Një grupi prej 18 nxënësish nga gjimnazi jonë iu dha e drejta për mjekësi meqenëse



Në foto: Selim Horeshka (majtas) dhe Abdurahim Ashiku

kishte shumë nevoja, sidomos fshatrave. Nga këta 15 e mbaruam atë.

Përveç meje ishte Lulëzim Pilafi, Mustafa Ndreka, Dilaver Çorja, Ibrahim Kaziu, Nazmi Kaja, Naim Rama... Kishte edhe fëmijë të familjeve të oficerëve që nuk ishin dibranë si Resmi Balla që u bë gjinekolog në Elbasan, e shumë e shumë të tjerë.

Si fakultet e mbaruam në vitin 1977. Bëmë një vit stazh nëpër spitalet rajonale. Ne e bëmë në spitalin e Peshkopisë. Në vitin 1978 u diplomuam.

Fat ishte që në spitalin e Peshkopisë ku filluam stazhin gjetëm një kolektiv mjekësh shumë profesionistë duke filluar nga Rrahim Gjika, Donika Serani, Qemal Çadri, Janaq Tërpo, Irfan Jashari, Tahir Alku. Më pas Arif Hasani, Hysen Pasha, Sashenka Nazifi, Vangjel Kamburi, Sheza Balliu në neurologji, Hazis Ndregjoni në dermatologji, Xhavit Miftari dhe Tush Balliu në infektiv. Të gjithë, derisa unë jam larguar nga Peshkopia, një herë në dy javë i nënshtroheshim ngritjes tekniko profesionale ku referoheshin tema nga të gjithë sektorët e shëndetësisë. Referimi bëhej me të caktuar. Kësaj radhe e ka filani... Radhën tjetër filani... Zgjidhej një temë e cila të mos jetë referuar pesë vitet e fundit.

Emërues i përbashkët i të gjitha gjërave është puna dhe libri. Tani janë lehtësuar gjërat sepse është interneti dhe librin e gjen edhe në internet. Por ama libri i shkruar ngelet një bazë për shumë e shumë vite, gjithë jetën.

Në vitet nëntëdhjetë filloi bashkëpunimi edhe me spitalet e Maqedonisë, pas hapjes me botën, ku bëheshin konferenca mjekësore të përbashkëta. Kemi bërë në Dibër të Madhe, në Strugë, Shkup dhe në Peshkopi ku referoheshin tema nga më të ndryshmet. Kjo u shoqërua me çmallje mes njerëzve dhe lidhja e miqësive të reja.

LUZNIA UNIVERSITETI IM I DYTË...

Pasi mbarova fakultetin punova rreth dy vjet si mjek i përgjithshëm në zonën e Luznisë. Këtë e quaj shkollë të madhe të jetës, si gjë shumë të mirë për kohën ku jo vetëm u përshtatem me detyrën e mjekut të familjes por edhe me shumë e shumë gjëra që tani nuk praktikohen më që nga higjienizimi i banesave, mirërritja e fëmijëve të vegjël, trajtimi i gruas shtatzënë, fëmijës së porsalindur etj. që bëheshin nga mjeku i përgjithshëm.

Qendra shëndetësore e Luznisë quhej spital zonal ku si mjek në atë kohë isha vetëm unë. Ishin 4-5 mami - infermiere dhe çdo fshat kishte mami-infermiere. Kishim një ndihmës dentist Sakip Ashiku dhe një farmaciste nga Dohoshishti, Lume Kadriu, bijë në Brezhdan ke Tuket.

Atje, në ato shtëpi të Katundit të Ri, Hoteisht, Lishanit të Epërm dhe Lishanit të Poshtëm, Arapit të Epërm dhe Arapit të Poshtëm, mora leksionet e para të Universitetit të Dibrës...

REAMINATORI I PARË I DIBRËS

Pas Luznisë shkova për specializim për anestezi-reanimacion. U specializova dy vjet dhe më pas u ktheva në Peshkopi, më 3 janar 1983. Në Peshkopi nuk kishte pasur asnjëherë anestezist-reanimator kështu që edhe aparaturat për këtë sektor ishin afër zeros.

Mu deshtë që javën e parë të shkoj në ministri, të bisedoj me ministrin Ajli Alushani. Brenda javës tërhoqa aparaturat bazë. Dhe brenda vitit spitali i Peshkopisë nuk kishte asgjë mangët nga spitalet e tjerë. Kjo falë ndihmës së madhe të profesor Ajli Alushanit të cilin e kisha pasur pedagog, ndihmë e cila ishte maksimale.

Fillimisht popullata nuk e kishte fare idenë se ç'është anestezi-reanimacioni, por ama edhe mjekët, përfshirë sektorin kirurgjikal nuk kishin informacionin e duhur për degën e anestezisë. Deri atëherë anestezia kryhej nga infermierë me anestezinë tradicionale të asaj kohe "eter me pika". Brenda vitit siç ju thashë ndryshoi edhe teknika duke futur protoksidin e azotit dhe neurolept anestezinë dhe neurolept analgjezinë, anestezia intravenoze.

I SËMURI PËRGJEGJËSI E PËRBASHKËT

Vit pas viti gjërat ndryshuan. Tani i sëmuri është i përbashkët por detyrat e anestezistit dhe kirurgut janë të ndara. Edhe ana shkencore por edhe ana ligjore. Përgjegjësia para ligjit pak a shumë është e ndarë. Si detyrimi po ashtu edhe atributet për një të sëmurë në sallë derisa ai del në pavijon. Në reanimacion ato ditë që ka për të ndenjur është produkt i punës së anestezistit kryesisht për sa i përket sigurimit të organeve me rëndësi vitale si frymëmarrja, puna e zemrës si tensioni, frekuenca, çrregullimet e ndryshme kardiake, koshienca e të sëmurit. Kur del në pavijon anestezisti kthehet në konsulent të të sëmurit dhe kartelën e merr kirurgu.

LARG DIBRËS ME ZEMËR ATJE

Deri në vitin 1997 kam punuar pranë spitalit rajonal të Peshkopisë. Nga mesi i atij viti u punësova në spitalin universitar të ushtrisë apo siç quhej "Spitali ushtarak" në Tiranë. Më vonë mori emrin "Spitali i Traumës" duke qenë se këtu grupoheshin të gjitha traumat e republikës. Punova këtu deri në vitin 2018 kur erdhi koha për pension. Tani punoj në një spital privat.

Mua më ka shoqëruar gjithmonë fati se kam gjetur atje ku kam shkuar një staf profesionistësh. Edhe në spitalin ushtarak ku një pjesë e madhe ishin me gradat doktor e profesor dhe kishin përballuar sfida mjekësore nga më të ndryshmet.

Në vitin 1998, disa muaj pasi kisha filluar punën në Spitalin e Traumës, Ministria e Mbrojtjes në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes së Greqisë, në kuadrin e NATO-s, gjithë mjekët e spitalit ushtarak i kaloi në një specializim tremujor nëpër spitalet ushtarake të Athinës duke filluar nga spitali i marinës, ai i këmbësorisë dhe ai i aviacionit. Unë isha në spitalin e marinës ngjit me Ambasadën Shqiptare në atë kohë.

Atje u takova me ju. Pimë kafe në qendër të Athinës, në Omonia.

HASIJE HORESHKA, DUKA...

Profesioni jonë është një profesion i vështirë që kërkon fillimisht mbështetjen e familjes por edhe tolerancën e fëmijëve, sepse ne mund të ngrihemi e disa herë në mes të natës të shkojmë në spital në organizimin që kishim nëpër rrethe dhe po qe se do të mërzitet familja atëherë o duhet ta lesh punën e të marrësh një profesion tjetër ose familja do të jetë tolerante dhe e mirëkuptueshme për profesionin që ke. Kështu që një pjesë të meritës gjithnjë në profesione të vështira siç është ai i anestezistit i takon familjes. Pastaj kur fillojnë e ndërgjegjësohen edhe fëmijët edhe ata bëhen të ndërgjegjshëm që prindi ka një profesion të vështirë, një punë të vështirë dhe janë edhe më tolerantë në kërkesat për të dalë, për të bërë xhiro, për të shkuar diku. Këtë punë e kryen bashkëshortja ime, mamaja e tyre, Hasija.

Hasije Duka, nga Duket e Sopotit. Hasije Mehmet Duka.

Ajo ka mbaruar inxhinierinë elektrike. Edhe ajo kishte një profesion të vështirë për gratë. Ka punuar në ndërmarrjen elektrike deri në vitin 1997. Më pas në ndërmarrjet elektrike të Tiranës.

Edhe Hasijes i është deshtë të shkojë në çdo fshat të Dibrës për të projektuar ndryshimin e sistemit elektrik nga shtylla druri në shtylla betoni. Nga këto nuk kishte ndërrim numër për numër por bëheshin linja të reja komplet sipas një strategjie të re. Deri vonë të gjithë projektet e Dibrës i ka pas në shtëpi.

Fëmija i parë është Klodi, vajza e madhe, Klodiana. Ajo që nga klasa e parë deri në të dymbëdhjetën ka pasur vetëm një NËNTË. Fitoi të drejtën për mjekësi, stomatologji dhe ekonomi. Zgjodhi stomatologjinë. Tani punon e pavarur në klinikën e vet dentare. Ka tre fëmijë: Kledian, Dionën dhe Drinin. Duke qenë se ka marrë Skraparli për burrë çunit ia la emrin Drini. Dorjana punon ekonomiste në bankën Kredins. Dhe i treti është Arditi që ka mbaruar inxhinieri elektronike dhe punon si inxhinier elektronik.

NJERIU RRITET ME DËSHIRËN PËR TU LARGUAR NGA VENDLINDJA DHE PLAKET ME DËSHIRËN PËR TU KTHYER ATY.

Me Selimin takohemi çdo vit këtu, në plazhin e Malit të Robit, ku shtëpitë i kemi në të njëjtin bllok banimi, afër e afër, pimë kafe, çmallemi, udhëtojmë maleve të Dibrës, takojmë e gjejmë njerëz disa i kujtojmë e disa të tjerë i jetojmë dhe nostalgjia për Dibrën këndellet, sa vjen e rritet. Dhe na duket sikur po të na thonë ejani në këmbë në Dibër, shkojmë...

Thuhet një fjalë, vazhdon Selimi, se njeriu rritet me dëshirën për tu larguar nga vendlindja dhe plaket me dëshirën për tu kthyer prapë aty. Tani në shumë vende që kemi lëvizur, kemi ecur me këmbë, tani kur nuk shkojmë dot udhëtojmë me mend, i kujtojmë ato, kujtojmë në mënyrë të veçantë shokët, njerëzit që gjithmonë na kanë rrethuar me dashamirësinë më të madhe sepse edhe ne, unë e ti, domethënë kemi pas për bazë përveç korrektesës edhe tolerancën. Edhe kur ndonjë e ka pas pak me të keq ne kemi bërë sikur nuk kemi kuptuar. Atë që e ka pas me të mirë e kemi kuptuar dhe mirëkuptuar.

- E kemi lënë të ece vetë.
- Po, por e kemi lënë të ecë në hanë të vet.
- Faleminderit!
- Faleminderit ju! Është kënaqësi që takohemi, pimë kafe çdo ditë e udhëtojmë. Nesër do të kthehem në Tiranë. Gushtin tjetër këtu më ke...

Shqipëri-Athinë, shtator 2019

Nëse nuk e ke vizituar ende Dibrën,
nuk e ke parë ende Shqipërinë!

Visit Dibër

Turi i kanionit të Drinit të Zi

Pak informacion rreth Drinit të Zi

Drini i Zi është njëra degë e lumit Drin, i cili është lumi më i gjatë në Shqipëri. Ai buron nga liqeni i Ohrit dhe ka një gjatësi prej 149 km. Lumi rrjedh në veri nga Maqedonia, në drejtim të Dibrës në një zonë malore, pastaj pranë qytetit të Kukësit bashkohet me Drinin e Bardhë, duke formuar lumin e bashkuar Drini, që ka derdhje në Detin Adriatik.

Drini i Zi përshkon në gjithë gjatësinë e tij territorin e bashkisë Dibër, i gjithi në shtratin e tij natyral me një peizazh lumor të virgjër, në pjesën fushore me pyje shelgu dhe në pjesën shkëmbore me kanione dhe bukuri të tjera mahnitëse. Flora është shumë e pasur, me bimë nga më të larmishmet, dru, shkurre të shumëllojshme dhe myshqe, si dhe fauna lumore me një numër të madh peshqish si: krapi, trofta, ngjala etj.

Përshkrimi i turit turistik të Kanionit të Drinit të Zi në Gradec-Hotesh

Një nga destinacionet më të bukura dhe afër qytetit të Peshkopisë është Kanioni i Drinit në pjesën Gradec-Hotesh-Selane-Katund i Ri, në një gjatësi prej 6-9 km, që zgjat rreth 5-6 orë.

Në këtë udhëtim, ju keni rastin të shikoni bukurinë natyrore të kanionit të Drinit, me një peizazh të larmishëm, nëpër ngushtica shkëmbore, ku në disa pjesë formohen kanione të mrekullueshëm, pyje të ulëta të gjelbëruara dhe ku uji ka ngjyrën e errët, dhe e kupton arsyen se përse Drini quhet i Zi.

Në këtë pjesë është edhe kanioni i Gjurrës së Mazhicës, ku është grykëderdhja e këtij përroi, me një peizazh natyror shkëmbor dhe një ujëvarë madhështore në sezonin e vjeshës dhe pranverës.

Kjo grykë nga amatorët e natyrës është quajtur "kanioni i fluturave", pasi ka shumë flutura dhe llojshmëri të madhe drurësh frutorë të egër, që nga dardha e Hoteshit, ftoi, thana, manafera, etj. Gjatë këtij itinerari do të njiheni me legjenda, histori, shpella, kulla dhe vendbanime të hershme arkeologjike.

Itinerari turistik fillon në Peshkopi në dy mundësi lëvizje, njëra për në fshatin Pekë (20 minuta) dhe një për në fshatin Topojan (30 minuta), me makinë nëpër rrugë të asfaltuar.

Dita 1


Shijo dhe eksploro me ecje Kanionin e Drinit në Hotesh

8:30 Nisja nga Peshkopia

Itinerari 1: Shijoni bukuritë agro-turistike të fshatit Pekë, që njihet për punimet e baltës në histori dhe për plantacionet e mollëve dhe qershive. Pastaj kalon nga kodrinat e lagjes Gjure të pasura me dru frutorë autoktonë dhe pyje dushku, me faunë të egër që shfrytëzohet për amatorët e gjuetisë. Udhëtimi nga Peshkopia deri në fshat në rrugë të asfaltuar, 20 minuta. Nga rruga e asfaltuar deri te kanioni i Drinit udhëtimi në këmbë zgjat rreth 1 orë, deri tek urra e telit me dërrasë, buzë lumit Drin.

Shijo dhe eksploro me ecje Kanionin e Drinit në Gradec-Hotesh

KOHËZGJATJA: 1 ditore
GJATËSIA E SHTEGUT: 6 km - 9 km ecje në ditë
VËSHTIRËSIA: Niveli i lehtë dhe mesatar







Itinerari 2: Eksploro kanionin e Drinit nga fshati Topojan, ku me makinë nga Peshkopia arrin për 30 minuta përgjatë bregut të lumit Drin, kalon në fshatin Shpukth, ku mund të shijoni një peizazh fantastik të Maqellarës, të bregut të Drinit në fshatrat e Maqellarës deri në kanionin e Gradecit, dhe një pikë vrojtimi ku vështron gjithë pjesën e sipërme të Luginës së Drinit në fushën e Gjoricës dhe Dibrës së Madhe.

10:15 Vizito kanionin e Gradecit dhe të Gurës së Mazhicës

Udhëtimi deri te kanioni i Gradecit zgjat rreth 1 orë ecje në këmbë, ku kënaqesh me bukurinë e tij, duke kaluar Drinin nga një urë teli me dërrasa. Për rreth 2 orë mund të kalosh buzë lumit Drin, të shijosh kanionin e grykëderdhjes së Gurës së Mazhincës, pyjet frutore natyrale të Hoteshit. Pasionantët e peshkimit mund të peshkojnë dhe pastaj një drekë buzë lumit në Selane te Sed Murrja ose te Labinot Murrja ose njësi akomoduese të tjera që janë buzë Drinit.

12:15 Dreka

13:15 Shijo bukurinë e kanionit të Katundit të Ri

Pas pushimit të drekës, vizitë në kullën e Vesel Murrës dhe Elez Murrës, shpellën e Celes dhe përgjatë kanionit për 1.5 ose 2 orë arrihet tek ura e Katundit të Ri, ku mund të shijosh një kafe apo lëng frutash te restoranti i Halil Damzit. Mund të bëhen foto të bukura dhe me furgon/makinë në rrugë të asfaltuar kthimi për në Peshkopi.

15:00 Nisja për Peshkopi

Gjatë rrugës mund të shijohet peizazhi agro-turistik i fshatit Dohoshisht, ku mund të bëhen disa ndalesa për foto.

15:30 Akomodimi

Sugjerohen:

Guest House "Konaku"
0692053492 hsalkurti@gmail.com

Agro-turizëm "Dashe Zerja"
0699377337 fabianzerja@gmail.com

Guest House "Uka"
0673625835 udhetomegresin@gmail.com

Kampingu "Kapxhiu", Peshkopi
069-2258182 campingpeshkopi@gmail.com

Hotelet e qytetit:
Adresat i gjeni tek www.visitdiber.com

19:00 Darka

Rekomandohen larmi darkash si në restorante dhe darka familjare të përgatitura nga shtëpitë pritëse.

Ky projet u mbështet nga D2T "Dibra: Turizëm dhe traditë"









cyan magenta yelloë black

ODA DIBRANE

SHOQATA KULTURORE-ARTISTIKE "ODA DIBRANE"

Bashkia Dibër | Qarku Dibër | Komuna Dibër e Madhe

Me mbështetjen financiare të Ministrisë së Kulturës

ODA 25 DIBRANE

PESHKOPI
DIBËR E MADHE 3,4,5 TETOR 2019

Marrin pjesë grupe folklorike nga:
SHQIPËRIA, KOSOVA, MAQEDONIA, MALI I ZI

Sponsorë:

GJOKA KONSTRUKSION · AK ANDI KONSTRUKSION · LURA GROUP · BIG MARKET KEN · RTV · BOTIMET M&B



❑ Hotel "KORABI" ❑ Hotel "VERI" ❑ Hotel "PIAZZA" ❑ Klinika dentare "LAÇI" ❑ "VORFI"- Kancelari dhe shërbime kompjuterike



SHITET

1 200 m² katror sipërfaqe e përdorshme për biznes dhe banim.
300 m² lokal, bar kafe dhe restorant, i përshtatshëm për dasma, 100 m² kuzhina.
4 apartamente, me dy dhoma të mëdha gjumi dhe 2 të tjera me një dhomë.
Restoranti ka katër banjo moderne dhe një dhomë ndërrimi.
Lokali në katin e parë është 200 m² + magazinë, qilari është 30 m².
Bari - 30 m² brenda dhe 140 m² ambienti i jashtëm.

Për një vizitë në pronë, kontakto: *068 65 08 441* *ramizgjini@yahoo.com*





www.rrugaearberit.com

Na ndiqni *online*, falë ndihmës së z. Agim Deva, të cilin e falenderojmë për ndihmën dhe përkushtimin.

Informacioni për faqen online: **info@rrugaearberit.com**

Informacioni për versionin e printuar: **rrugaearberit@gmail.com**

Përdor KONTAKT PAGE për pyetje dhe sygjerime.

Shtyp butonin **"NDIHMO EDHE TI"** që gjendet në faqen e parë në versionin online për tu abonuar dhe kontribuar në botimin e gazetës, ose kontakto me redaksinë. Çdo kontribut bëhet publik.

Çdo lloje kontributi shkon në masën 100% në llogarinë e gazetës në Tiranë/Shqiperi në mënyrë të sigurtë përmes PayPal.

Ëebsite është një kontribut në shërbim të botimit të gazetës "Rruga e Arbërit", lobimit për ndërtimin e rrugës me të njëjtin emër, që do lidhë Tiranën me pjesën tjetër të Ballkanit në Lindje të Shqipërisë, si dhe zhvillimin e Dibrës dhe krahinave përreth.

Mund të na ndiqni edhe në Facebook duke kërkuar me emrin "Rruga e Arbërit" ose përmes lidhjes:

https://tinyurl.com/lcc3e2f

Foto Majtas tregon pamjen e parë të faqes zyrtare në Facebook të gazetës *Rruga e Arbërit*

NE jemi gazetë e lirë dhe pavarësia dhe liria jonë garantohet vetëm nga mbështetja e lexuesve...

BËJ PAJTIMIN TËND!

Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: **600 lekë.** Në Europë: **10 Euro.** Në SHBA dhe vende të tjera: **15 USD**.

Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Rruga e Arbërit nr. 161

Munir Shehu, e drejta e autorit dhe kënga "Bulqizakja

kulturë

Munir Shehu, ky humbës i madh

Nga **MIRDASH SHEHU**

Mbas botimit në disa gazeta të shkrimit për gjoja vjetërsinë e këngës "Bulqizakja" dhe mohimit të autorësisë të Munir Shehut, si dhe debateve pro e kundër që vazhduan edhe në rrjetet sociale, më duhet të ndërhyj edhe unë, Mirdashi, që, si djali i Munirit, sigurisht, për arsye të rrethanave, e njoh Munirin ashtu si pak kush e ka njohur.

Unë, sinqerisht uroj që kjo të jetë rasti i fundit, sepse nuk është as i pari, as me skandalozi kur është vjedhur, apo tentuar të vidhet krijimtaria e Munirit. Aq e shpeshte dhe sistematike ka qenë kjo, sa shpesh e ka çuar Munirin në depresion, në mendimin se përse vlejnë gjithë këto sakrifica, përse duhet të bësh më të mirën për vendin tënd, kur jo vetëm nuk të janë mirënjohës, por edhe të vjedhin pa ju dridhur qerpiku. Në momente të tilla, i hidhte tej letrat duke e ndërprerë punën. Më pas, ndërgjegja s'e linte dhe fillonte përsëri. Kështu, fillo e ndërprit erdhëm këtu ku jemi: Muniri iku nga kjo botë duke marrë me vete shumë vlera kulturës dhe historisë të Dibrës. Nëse ai do të ishte përkrahur, historia dhe folklori dibran do të ishin shumë më të sistemuar e, këtë nuk e them unë, por vetë ata që e penguan, duke pranuar në shenjë pendese përgjegjësinë e tyre.

NË KËRKIM TË ROMANIT TË HUMBUR

Shkrimet për historinë dhe foklorin e Dibrës, datojnë që kur ishte student në Normale të Elbasanit, të botuara disa edhe në revistën "Normalisti" në vitet 1928 – 1932, në moshë fare të re, rreth 20 vjeç, deri në 1945 kur do të arrestohet nga rregjimi, për të vazhduar në 1952 e në vazhdim, pas daljes nga burgu. Në Normale dhe pak vite më pas, afërsisht duhet të shkoje deri rreth viteve 1935- 36, pa pretenduar saktësi për datat, pasi nuk mund ta vërtetoj këtë, shkruan një roman. Ky roman i shkruar rreth këtyre viteve e bën Munirin ndër romancierët e parë shqiptarë. Ndoshta mund të ketë qenë edhe një "garë" me shokun e tij të bankës, Sterjo Spase, që aso kohe shkroi romanin "Pse".

Arrestohet në 1945 dhe shpallet nga gjykata komuniste "armik i popullit" me sekuestrim të pasurisë. Po çfarë mund ti sekuestrosh një intelektuali si ai, përveçse libra e fletore të mbushura me shënime e nota muzike? I morën pra, çfarë gjetën: shënime historike, këngë të vjetra të mbledhura në popull dhe... romanin. Unë ruaj dhjetra fletë origjinale, si dëshmi të ekzistencës së tij, të gjetura në burgun e Burrelit nga një nxënësja e Munirit në pedagogjiken e Peshkopisë, që njohu menjëherë shkrimin e mësuesit të saj. Ajo i solli fletët, shkoi përsëri të kërkojë kur mësoi të vërtetën, por nuk gjeti gjë. Pas njohjes time me prof. dr. Shefqet Hoxhën, nga Kukësi, mësova se ai e kishte lexuar atë roman. Besoj se është i vetmi. E kishte gjetur në magazinat e grumbullimit të Peshkopisë, ku mblidheshin materialet e sekuestruara "armiqve". Si i apasionuar pas librit që në rini, ai i kishte kërkuar dajës së tij, që ishte drejtor i grumbullimit në atë kohë, në Peshkopi, që ta lejonte t'u hidhte një sy librave të sekuestruar. Në këtë grumbull i tërhoqi menjëherë vemendjen një fletore me kapak të trashë e mbërthyer bukur me dorë. Ishte romani në dorëshkrim i Munirit. E mori e lexoi dhe e ktheu prapë në vend... Nuk arriti të botohej, ai humbi, jo për faj të



Munir Shehu. *(Foto nga arkivi i familjes)*

Bulqizakja e vërtetë është baresha që shkon me dhen. Vendi i saj janë livadhet, pyjet me dushqe (iku, u fut ndër dushqe) ku ajo i fshihet të dashurit dhe i dashuri e thërret*: oj bareshë*! Bulqizakja bareshë mban furkën me lesh (*tiri-tiret të lumtë dora...)* Ajo ka bukurinë e atyne maleve dhe pastërtinë e borës që sjell dimni i atyne anëve *(je e pastër moj porsi bora).* Ky është art, krijim.

Pa Munirin, Shqipëria, shqiptarët dhe Bulqiza do të ishin pa "Bulqizaken" dhe "Bulqizakja" do të kishte ngelur në arkën e mbuluar nga pluhuri i harresës dhe as "zbulimi" në 94' a 2004, nuk do të kishte vlerë.

DEBATI

"Bulqizakeja", me "fjalë e muzikë prej Munir Shehut"

"Bulqizakja" u kthye në një temë kryesore debati në median sociale dhe lokale, pas lajmit se kënga ishte 100 vjeçare dhe një studiues kishte arritur të "mblidhte tekstin origjinal" të saj.


Botuesi i librave të Munir Shehut reagoi përmes një statusi në Facebook, duke theksuar se "kënga "Bulqizakja" është një krijim me tekst e muzikë të Munir Shehut. Kush thotë të kundërtën po thotë një gënjeshtër. Në qoftë se është prej padijes, nuk ka asnjë problem, por në qoftë se autorët e studimit kanë pasur sadopak informacion, atëherë ata kanë spekuluar qëllimisht dhe arsyen e dinë veç ata".

Por ndërkohë, për këtë tekst kishte reaguar edhe kompozitori i njohur, Përparim Tomçini, i cili shkruante gjithashtu në një koment në rrjetet sociale se "kjo këngë është komplet produkt i autorit dibran Munir Shehu, me tekst edhe me muzikë'.

Gjithashtu, muzikanti Lahim Shehu, është i mendimit se "Bulqizakja" është "këngë qytetare e kompozuar, nga Munir Shehu, pavarësisht se nuk i përmendet emri, siç është e zakonshme te ne". Përmes një komunikimi në rrjetet sociale Lahimi shkruan se "unë jam prej asaj ane, por nuk e kam dëgjuar kurrë më parë se në vitin 1955 këngën e "Bulqizakes". Edhe vetë kënga tregon se është kompozim dhe jo folklor.

Pas këtyre reagimeve, "zbuluesi" i 100-vjetorit të këngës, Ramazan Kica, ka botuar në faqen e tij personale në Facebook një replikë me Bujar Karoshin, botuesin e librave të Munir Shehut. Në replikë ai pohon se nuk ishte në dijeni të autorësisë së Munir Shehut, por nga ana tjetër argumenton se këtë e ka pasur nga disa burime të tij dhe se ai nuk është marrë me autorësinë, por me shpjegimet gjuhësore.

Në vazhdim të këtij debati, redaksia po boton një reagim të djalit të Munirit, Mirdash Shehu, i cili bën një panoramë të "vjedhjes" së autorësisë dhe persekutimit të Munir Shehut. Me këtë rast ai sjell edhe dy dëshmi autentike ku provohet se "Bulqizakja" është me tekst dhe muzikë të Munir Shehut. Në njërin prej dokumenteve, të firmosur më 20 janar 1950 nga Hazis Ndreu, vërtetohet autorësia origjinale e shtatë teksteve, mes të cilave edhe "Bulqizakes".



Partiturë e këngës *"Bulqizakeja"*, me *"fjalë e muzikë prej Munir Shehut"*
Faksimile nga *arkivi i familjes së Munir Shehut.)*

Munirit. Ky ishte fati i romanit. Në një fat tjetër, për Munirin sot do të flitnim ndryshe. Do të flitnim si për një nga autorët e parë shqiptar në gjininë e romanit. Kjo eshtë një humbje e madhe, apo jo? Një humbje e madhe, e pallogaritshme.

HYMNI I TË BURGOSURVE POLITIKË

Ka shumë gjëra të tjera për të thënë për këtë periudhe, por po vazhdoj më tej duke u përpjekur sa më shkurt t'ju informoj për ato momente të jetës së tij, që lidhen me temën e shkrimit për të krijuar një njohje, një opinion për të, që mungon pikërisht për shkak të mosnjohjes, për shkak të mungesës së informacionit.

Arrestohet në 1945, lirohet nga burgu në 1952. Nuk po tregoj këtu se si e qysh ndodhi sepse duhet nje roman më vete. Lirohet, shumë i sëmurë, në prag të vdekjes. Ata që e liruan me sa duket kishin planifikuar vdekjen e tij, por ç'ti bësh zotit që kishte menduar ndryshe duke mos e futur edhe për mjaft kohë në listën e atyre që kishte planifikuar për t'a lënë këtë botë.

Nuk mund të le pa e thënë. Muniri është autori i këngës që u bë HYMNI i të burgosurve politike. Nga një poemë shumë e gjatë e tij, e shkruar në burg, që trajton thellë dhe me urrejtje komunizmin, Muniri zgjodhi disa strofa për këngën që gjithashtu i vuri edhe melodinë.

"Liri, fjal' e shenjt' të adhuroj!/ Liri, pa ty jetën s'mund t'a çoj!" Këta vargje nuk kanë nevojë për koment. Ato burojnë nga shpirti e si të tilla, ishin të sinqerta, e vërteta që të gjithë e ndjenin brenda vetes e, duke qenë e vërteta e të gjithëve, atë e mësuan të gjithë. Gojë më gojë, burg më burg, nga burgjet ku ishin, në burgjet ku shkonin, të burgosurit merrnin me vete edhe këngën. Ajo këndohej tashmë nga burgu i Spaçit, në Tiranë e Tepelenë, nga të gjithë të burgosurit në mbarë Shqipërinë, duke u dhënë atyre besim e shpresë në luftën e tyre për liri, duke sjellë gjithmonë në kujtesë se liria qëndron mbi të gjitha. Ajo i kaloi edhe muret e telat e burgjeve duke u kënduar në mbarë Shqipërinë. U bë hymni i lirisë të shqiptarëve. Është kënga që u këngua nga të pranishmit në themelimin e shoqatës të të burgosurve politikë. Mendoj se është një vlerë që nuk duhet lënë në harresë nga instituti i të përndjekurve. Persa i perket poems; ajo pati fatin e romanit, humbi. Shumë të burgosur e kishin mësuar poemën përmendësh. Në kërkim të saj, sapo mësoja që aksh person e di përmendësh poemën, vrapoja drejt tyre, por pa sukses. Kur mbërrija unë, ata nuk ishin më. Kështu që po mbetet kënga, që edhe kaq, flet mjaft.

Sapo del nga burgu, shtrohet për afro një vit në sanatoriumin e Shkodrës, që e rikthen përsëri në jetë. Vjen në Peshkopi, në 1953.

Si duket, gjendja katastrofike e e artit dhe kulturës, mungesa e kuadrove, e detyroi partinë që ta emërojë Munirin mësues në Pedagogjiken e Peshkopisë, si dhe përgjegjës të shtëpisë të kulturës në sektorin e muzikës. Kushti ishte që duhet të merrte përsipër të ngrinte në një nivel më të lartë jetën kulturoro-artistike të qytetit.

MUNRI SHEHU SHTROI RRUGËN E ZHVILLIMIT TË MUZIKA DIBRANE

Kompozitor, udhëheqës, organizator, me autoritet të plotë, brenda një kohe shumë të shkurtër, me një përkushtim të pakrahasueshëm, ngriti orkestrën, grupin e valleve dhe Dibra nisi një epokë të re, krijoi

traditë

fytyrën e vet edhe në fushën e artit e kulturës. Muniri i dha Dibrës, Hazis Ndreun, të cilin e mori dhe e rriti si këngëtar e valltar, i dha talentit të tij kulturë. Nën edukimin e Munirit u kultivua Hazisi, pranë mësuesit historian kuptoi ç'është historia, folklori dhe në shembullin e mësuesit, me pasionin e tij, u bë një vazhdues i denjë i kësaj rruge. Këngëtarët e mrekullueshëm Melita Shehu, Besim Çutra e të tjerë i dhanë tonin jetës artistike në Peshkopi. Muzika dibrane mori formë dhe modeli që la Muniri, do të influencojë dhe përcaktojë në një fare mase rrugën e muzikës dibrane, të ardhmen e saj. Për ata që kuptojnë, kjo është shumë.

Ishte një ndër personat e rëndësishëm në Institutin e folklorit. Me kontributin e tij, kultura popullore dibrane mori vendin e vet të merituar në këtë qendër të kulturës popullore kombëtare. Mendimet dhe fjala e tij për politikat e ruajtjes dhe zhvillimit të kulturës popullore shqiptare priteshin me interesim. Thirrrej në mbledhjet e tij dhe dëgjohej me respekt dhe kjo sigurisht, për meritë të tij. Si një mbledhës i shquar i folklorit, kam dëgjuar shpesh lart e poshtë, nga dashakeqë që duan me këmbëngulje të ulin meritat e tij, duke thënë se ishte partia që organizonte dhe sillte pleq për të biseduar, që në fakt ishte gjë shumë e mirë, më duhet t'u kujtoj atyre se, në 1930, kur mblidhte folklor Muniri nuk ishte krijuar partia….Në fakt mund të kenë pak të drejtë sepse Muniri ka vazhduar këtë punë edhe pasi u krijua partia, d.m.th., në 1941, '42, '43, '44, '45, etj.

Por, po vazhdoj.


Presidiumi i kuvendit popullor e dekoron me urdhërin e punës. Ky, besoj, është rast i veçantë. "Armiku" i dekoruar! Të gjithë e kemi të qartë se çfarë pune dhe emri duhet të krijojë një njeri si Muniri për të marrë një vlerësim të tillë. Mendoni ju se kishte dibran që mund t'a bënte një propozim të tillë për Munirin?

VITET '1960: ATY KU NISI LOJA ME "BULQIZAKEN"

Jemi në vitet 60. Këngët e tij morën dhenë. Ato u pëlqyen nga një masë e madhe njerëzish dhe u kënduan nga jugu në veri. Radio Tirana i transmetonte pa pikën e turpit me emërtimin "këngë masash", ose "popullore". Këtu e ka zanafillën edhe loja me "Bulqizaken". Ankesat e shkresat drejt ministrisë për të drejtën e autorit nuk sollën asnjë reagim.

Pikërisht, në këtë periudhë, do të vijë në Dibër një ekip i Radio Tiranës, për të inçizuar këngët e Munirit. I fyer nga qëndrimi i deritanishëm i Radios, por edhe duke mos besuar, me të drejtë në fjalën e premtimet e tyre, Muniri nuk pranon t'i inçizojë ato. I kërkon ekipit të Radios të kthehet mbrapsht, të transmetojë këngët me emrin e autorit, pra, me emrin e tij e, vetëm atëherë ata mund të vinin të inçizonin në Peshkopi. Kjo ishte e papranueshme për radion. Nuk mund kthehesin pa bërë asnje punë. Situata acarohet, por qëndrimi i Munirit ishte i palëkundur. Ai nuk do të ndryshojë as pas ndërhyrjes të sekretarit të parë të partisë të Peshkopisë, Jashar Menzelxhiu, që për hir të së vërtetës, Muniri e respektonte për përkrahjen dhe qëndrimin ndaj tij, por edhe për përkrahjen që i jepte për zhvillimin e kulturës dhe artit në Dibër. U vërtetua ajo që kam dëgjuar se ka thënë S. Alliu, kur shprehej se, "Muniri i ka të gjitha me ma shumë se unë, po ai i bie murit me kokë, unë nuk bi murit me kokë".

Kështu, Radio u kthye në Tiranë duarbosh. Në rast se inçizimi do të ishte kryer, nuk do të kishte hapësira për interpretim sot e as që do të diskutohej fare autorësia e këngës "Bulqizakja", e cila ishte, edhe ajo, ne listen e kengeve qe radio kishte planifikuar te incizonte.



Seksionit Arsim-Kulturës

K o p j e

Me këtë letër kam nderin t'ju paraqes atij Seksioni 16 copë melodi, bashkë me tekstet e tyne, nga të cilat 7 janë origjinale të kompozuesit prej nesh me tekste e muzika dhe nenë (9) të mbledhura në popull dhe të perpunuara ose të stilizuara prej nesh për t'u kënduar ne skenë ose për t'u-inçizuar. Të gjitha këto kenge janë shfrytezue nga Shtepija e kretushme e kulturës me rasse shfaqjesh të ndryshme. Gjithashtu po ju dergoj edhe dy mdite vellesa popullore, që janë perpunue prej nesh dhe janë shfrytezua me rasse të festivalit të Mësuesve dhe të studenteve në Tiranë gjate vitit 1956.

Këto pjese muzikore ia paraqes atij seksioni për të krye likuidimin perkatës si mbas numrezimeve dhe ne tarifes perkatese të ministrisë s'Arsimit.

Kenge origjinale

1.Astundare e'Astund t'Ki -per pagese vetem melodije;
2.Bulqizakeja - per pagesë tekst e melodi;
3.Atje n'Aeroplat prehet nji lule "
4.Mirditoreja - per pagese tekst e melodi;
5.Kenge e meredit te popullit mjeke veçi -tekst e melodi.
6.Fshati i Ri (muz.Vellsima)" - tekst e melodi;
7.Moj Dirar'e Mukur, moj Dirar'e me (muzike Vellsimi) - tekst e melodi.

Kenge te perpunuese ose te stilizuese

1.Cuec Astundare tekst e melodi.
2.Kenga e Aurbetit
3.Kuku mone ti çjuk po m'thue
4.Dy te mejrat
5.Moj e mira vetell helle
6.Ne bahçe me lule
7.Ç'po kendon nji zog e zi
8.Kenga e rrugës
9.O nor ook i ziu ook melodi,tekst dhe prolleg.

Peshkopi,me 20.-.-1959 Me vderise -
nesues i muzikes prane Shk.Pedagogjike
(Hy-ir Shehu)

Vertetuma

Vertetojm se nato pjese
jane shfrytzue nga Shtepijes
e kultures, me raste te
ndryshme.
Drejtori shtepisKult.
(Hazis Ndreu)
20-I-50

Një dokument i firmosur më 20 janar 1950 nga Hazis Ndreu, ku vërtetohet autorësia origjinale e shtatë teksteve, mes të cilave edhe "Bulqizakes".

Kjo ngjarje, i dha zemër xhelozisë të heshtur të armiqve të tij, që ishin të shumtë e të fuqishëm, por gjithmonë e kanë patur frikë, trembeshin prej tij, prandaj edhe e kanë sulmuar, vazhdimisht, kudo. Është e çuditshme se, edhe tani që ka 30 vjet që ka vdekur vazhdojnë të tremben, vazhdojnë t'a kenë frikë, vazhdojnë ta sulmojnë.

RIARRESTIMI

Upërgatit pra, goditja e rradhës. Pas një inskenimi të turpshëm, në vitin 1963, Muniri arrestohet përsëri.

Nëse në vitin 1945, u mbrojt vetë, me fjalën e tij (histori në vete kjo, shumë interesante), që e detyroi trupin gjykues të mos merrte ndaj tij një dënim maksimal, duke e dënuar me 10 vjet, shumë më pak nga planifikimi, kësaj rradhe, atë do ta mbrojë populli. Ditën e gjyqit, shumë të revoltuar nga arrestimi i profesorit, duke e kuptuar kurthin në të cilin e kishin future atë, nxënësit e pedagogjikes, bojkotuan mësimin, hapën dyert e shkollës dhe marshuan të gjithë drejt sallës ku zhvillohej gjyqi.Turma u bë akoma më e madhe kur nxënësve, ju bashkuan edhe qytetarët e Peshkopisë. Ky organizim i paprecedent, spontan, e vuri gjykatën para presionit populloor, e cila duke mos patur zgjidhje tjeter, perballe thirrjeve te demostruesve: Duam liri! Lironi profesorin! në kundërshtim me urdhërin, e liroi Munirin në sallë. Shpërthimi entusiast i turmës, pas shpalljes i pafajshëm të Munirit, ishte i paimagjinueshëm. Ajo do të vërshojë në sallën e gjyqit, do t'a nxjerrë Munirin prej andej hopa dhe ashtu duke e mbajtur në krahë do t'a dërgojë deri në Pedagogjike, ku i kërkon të vazhdojë mësimin, por tashmë është e qartë, ai nuk e ka të mundur të japë më mësim aty.

NË BURREL, ATY KU KRIJOI ORKESTRËN ME INSTRUMENTISTË POPULLORË

Largohet drejt Burrelit me gjithë familje. Largohet zemërthyer nga Dibra, dashuria e tij e pavdekshme deri në fund të jetës, me gjithë të këqiat e mosmirënjohjen që i dhuroi.

1964. Burreli. Nuk kam folur, nuk kam dashur, por ja që shpesh padrejtësitë të mërzisin, të nevrikosin dhe ti papritmas shpërthen duke mos duruar më dhe dëshiron t'i thuash menjëherë, të gjitha. Të shtyn edhe mendimi që nëse hesht, krijohet ideja e kundërt për të vërtetën: "Ja, heshti, e shikon që kemi të drejtë"?

Nuk do të flas për jetën në Burrel, e cila në sipërfaqe kaloi shumë më qetë se në Peshkopi, por brenda ziente njëlloj si atje. Një ngjarje të rëndë e cila lidhet me temën e këtij shkrimi do ta përmend.

Muniri ishte një ideator, krijues i vërtetë. Kishte menduar që Dibra të kishte orkestrën e saj me instrumentet popullore të krahinës. Një orkestër e tillë, e vecantë, e paparë ndonjëherë në trojet shqiptare, pra edhe jashtë kufijve të Shqipërisë, do ta lartësonte shumë Dibrën dhe artin dibran. Askush nuk mund t'a bënte atë përveç Munirit, sic edhe nuk u bë. E pati fat Mati. E bëri Muniri në Mat.

Tashmë orkestra me instrumente popullore e Matit është një orkestër e afirmuar edhe përtej kufijve të Shqipërisë, dhe ka krijuar personalitetin e vet të padiskutueshëm. Jetëgjatësia e saj, konfirmon vlerën e saj.

Muniri zgjodhi 35-40 vetë, instrumentistë popullorë të talentuar të mbledhur nga të gjitha trevat e Matit, me numrin më të madh të mundshëm të instrumenteve muzikore popullore të krahinës. Orkestër me 35-40 instrumentistë popullorë pa shkollë! Ata ishin individualitete, mund të luanin bukur për hesap të tyre, por kurrë në një nivel orkestre. Kjo, jo vetëm për arsyen se pjesa dërrmuese e tyre kishte një nivel të ulët arsimor, por edhe për faktin e thjeshtë se duke mos e njohur muzikën, notat, si mund t'u mësohej melodia, ndërhyrjet, bashkëpunimi i domosdoshëm orkestral? Ata as që e kishin idenë e orkestrës. Krijimi i saj ishte si t'i hysh detit në këmbë, por Munir i hyri dhe doli në anën tjetër. Ai e kishte në shpirt e në mendje, e ndjente prej kohësh në imagjinatën e tij tingëllimin fenomenal të kësaj orkestre, tingujt që do të dilnin nga bashkimi i çiftelive me dimensione të ndryshme me lauritë, fyejt, dajrja e lodra dhe tani vetëm duhej të priste kohën për ta prekur këtë magji. Theksoj, se ishte një proces shumë i vështirë, për mua personalisht një çmenduri, të cilën nuk mund t'a realizoje vetëm një i çmendur si Muniri me një pasion dhe dashuri aq të madhe për artin e popullit, por, për të mos ju larguar temës, le të vazhdojmë më tej. Erdhi dita e kurorëzimit. Çudia, bukuria, kënaqësia e, shumë lloj ndjenjash u gërshetuan bashkë tek autori, por edhe në të gjithë auditorin, kur ajo doli për herë të parë në skenën e festivalit të Gjirokastrës. Populli, udhëheqja e profesionistët duartrokitën pa pushim. Fituese e festivalit e në të gjithë të tjerët më pas. Gjithë këto, i thashë për të patur një informim, për të gjykuar për atë që do të them tani. Dhe vijmë në viti 1973.

KONCERT PËRBALLË ENVER HOXHËS: AKTI I DYTË PUBLIK I VJEDHJES SË AUTORËSISË

Siç nuk përbënte më surprisë, orkestra e Matit u zgjodh për të marrë pjesë në koncertin me numra të zgjedhur që zhvillohej në teatrin e Operas për nder të ditëlindjes së Enverit.

Gjatë provave, me të gjitha grupet e tjera që ishin zgjedhur, organizatorët e koncertit i kërkojnë Munirit që t'a shkurtojë pjesën. Meqenëse kjo ishte një orkestër veriore, me fyej e çifteli, dajre e daulle, ata kishin frikë se mos mërzitej Enveri, që, si jugor, ndoshta nuk e pëlqen çiftelinë e, nëse ndodhte kjo, përfundimin e kishin të qartë të gjithë. Për t'u siguruar, kërkuan te shkurtohej.

- Zhëng-zhëng-zhëng, 10 minuta me çifteli, shkurtoje pak, Munir"! – I thanë. Kjo ishte si një rrufe në qiell të hapur për Munirin. Patjetër që Muniri nuk mund të kundërshtonte dhe u përgjigj : - Po! Do t'a shkurtoj!

Dy ishin zgjedhjet dhe zgjidhjet që kishte Muniri:

I pari, shkurtimi i pjesës. Të bënte atë që kërkonte komisioni organizator. Por ç'do të thoshte shkurtim i pjesës e sidomos një ditë para koncertit? Nëse pjesa shkurtohej, dështimi ishte i sigurtë. Orkestrantët mund të luanin, por vetëm ashtu siç ua kishte gdhendur në kokë Muniri. Pra, nëse pjesa shkurtohej, orkestra do të bëhej lëmsh. Dështimi ishte i sigurtë dhe këtu, besoj se të gjithë jemi në një mendje se, i pari që do të arrestohej për sabotim të koncertit për Enverin, do të ishte "armiku i popullit", Muniri. Ishte shumë e lehtë për t'u gjetur sabotuesi. Po ju a le juve, lexuesve, të vendosni masën e dënimit.

E dyta. Arsyetimi i Munirit ishte ky: Kur organizatorët të pyesnin nëse u shkurtua pjesa apo jo, atyre do t'u thoshte, po, por në fakt nuk do t'a shkurtonte. Orkestra do t'a ekzekutonte pjesën si gjithmonë, ashtu siç e dinte. Për këtë do të dënohej me thyerje të notës në sjellje, por jo si sabotator. Sigurisht që dënimi me notë në sjellje ishte më i lehtë. Sido që të ishte të linte gjallë. Kështu bëri. Ai u kërkoi instrumentistëve të jenë sa më korrektë dhe të kujdesshëm gjatë interpretimit.

Gjatë koncertit erdhi rradha të performojë edhe orkestra e Matit. Në llozhën e Teatrit të Operas dhe Baletit, Enveri dhe byroja politike e në sallë të ftuarit ndiqnin, performancën e saj. Ndërsa në skenë orkestra vazhdonte lojën e saj para Enverit, në kuinta, mbrapa skenës, zhvillohej një lojë tjetër, shumë e egër. Organizatorët e koncertit, që e kuptuan se pjesa po luhej e

(Vijon në faqen 16)

Rruga e Arbërit nr. 161
kulturë

Or bari/oj bareshë, mbeti në Bulqizë prej këngës, por ajo nuk është një thirrje që nuk i takon vetëm Bulqizës. Po të biesh për pak sekonda në meditim, duke mbyllur sytë, nuk do ta kuptosh se nga vjen jehona e kësaj thirrjeje. O bari e o bareshë, do të duket se vjen në veshët e tu nga shumë drejtime, që nga bjeshkët e Bulqizës, nga Grama e Korabit, e tutje nga bjeshkët e Kukësit e Kelmendit, ngado. Nga ku nuk vjen ajo thirrje, kudo ku ka barinj e baresha shqiptare që kullosin bagëtinë mund t'a dëgjosh atë thirrje.

Munir Shehu, ky humbës i madh

(Vijon nga faqja 14)

plotë e pa shkurtuar, se Muniri pra, i kishte gënjyer duke mos ndryshuar asgjë, i ishin vërsulur duke e sharë e pështyrë, duke e ofenduar e ,duke u dridhur , me vështrimin drejt llozhës, prisnin reagimin e Enverit. Ndodhi çudia. Pa pritur përfundimin, Enveri çohet në këmbë i entusiazmuar duke duartrokitur. Gjithë salla çohet në këmbë dhe duartroket. Kjo ndodhte para, ndërsa prapa, ata që po e shanin dhe pështynin, papritmas filluan ta përqafojnë e t'a puthin Munirin. Në fakt, po lëpinin pështymat e tyre në faqet e Munirit. Të gjithë gëzonin, e festonin me përjashtim të Munirit, i cili plaset i dërrmuar në një karrike duke mos patur fuqi të reagojë pas asaj traume që kaloi. Por nuk mbaron këtu.

Mbas koncertit, ishte tradita, që të gjitha grupet artistike pjesmarrëse, mblidheshin në pallatin e brigadave për të festuar ditëlindjen e udhëheqësit bashkë me të. Enveri kishte kërkuar që aty t'i sillnin edhe krijuesin e kësaj orkestre dhe të kësaj muzike që ai e kishte cilësuar si "sinfoni". Pak kohë pasi kishte filluar mbrëmja në pallatin e brigadave, Enveri, nën efektin e mbresave që i kishte lënë orkestra e Matit, çohet dhe duke u takuar me pjesmarrësit e tjerë, pyet për zbatimin e porosisë së tij, ata që e shoqeronin:

- Po ai i Matit? Ku është ai i Matit?

- Ja, shoku Enver, ky është!

Në vend të Munirit, Enverit ju sevir një tjetër si autor. Sigurimi i shtetit i kishte rregulluar shpejt e shpejt punët.

- Ajo, - vazhdon Enveri, duke folur për melodinë, - nuk është një melodi me çifteli. Ajo është "sinfoni" e artë e popullit matjan! Ti e ke kompozuar atë?

- Po, shoku Enver.

- Ku e ke mbaruar konservatorin ti?

- Jo, shoku Enver, nuk kam shkollë, jam bari!

Enveri stepet nga përgjigja dhe largohet menjëherë duke thënë:

- Ja ç'bën populli!

Kjo është pak a shumë biseda që më është thënë, pasi unë nuk kam qenë aty, por e dëgjuar nga dhjetra të pranishëm, dëshmitarë të gjallë edhe sot. Nuk e di nëse kuptuat gjë. Sigurisht lojë e sigurimit të shtetit. Nuk di se mund të jetë ndryshe. Çfarë ndodhi? Për të shmangur Munirin, u përgatit një instrumentist, fyelltar, bari, sigurims, apo shërbëtor i sigurimit, pak rëndësi ka. Atij ju ngarkua detyra të merrte ai autorësinë përpara Enverit, urdhër të cilin ai e zbatoi, pavarësisht bllofit që shkaktoi pyetja se ku e kishte mbaruar konservatorin.

Ajo melodi e ndërtuar në formën e një suite, nuk mund të ishte punë barinjsh e lopçarësh, por punë profesionistësh, njohësish të thellë të folklorit. E drejta e autorit? Si gjithmonë edhe në këtë rast. Humbi. Shkoi tek romani, poema, etj.Të gjithë mund të bëhen autorë me përjashtim të autorit. Të gjithë mund të bëhen autorë me punën e Munirit, me përjashtim të tij. Ai jo! Ai nuk mund të jetë autor i veprës së tij.

Orkestra e Matit, i ka marrë të gjitha vlerësimet e mundshme si, "Nderi Kombit" , "Mjeshtri Madh", shumë e shumë vlerësime të tjera. Po ashtu edhe bariu, nuk ka lënë titull pa marrë, dyshoj se edhe nga dy herë. Edhe po s'mendoi vetë, mendon sigurimi i shtetit për shërbëtorin e tij. Shumë instrumentistë janë vlerësuar, vetëm ai vërteti jo! Edhe sot, 30 vjet pas vdekjes, jo! Dhe ju talleni me mua dhe nuk me besoni kur unë ju them se ende e kanë frikë...

"BULQIZAKJA", KRIJIM AUTORIAL ME TEKST E MUZIKË

Fillimisht dua t'i falenderoj ata që u morën me autorësinë e kësaj kënge, sepse po të mos ishte ky rast, ndoshta nuk do të kisha shkruar kurrë. Kemi heshtur. Kemi heshtur sa nga modestia, nga vështirësia për të folur për vete, aq edhe nga mendimi se nuk e ka gjetur kush të drejtën ndonjëherë në këtë vend, kështu që është e kotë të flasësh. Jam përpjekur t'a mbroj babain tim, duke e bërë të njohur një pjesë të punës së tij, atë që ka mbetur, nëpërmjet botimit, duke dashur që njerëzit t'a njohin Munirin nëpërmjet punës së tij, jo nëpërmjet fjalëve, por shoh se kjo nuk mjafton. Atëherë, po flasim!

Duke u futur në temë, kam mendimin se çështja e folklorit është një punë sa e bukur aq edhe e vështirë. Shumë njerëz janë marrë me të, por pak, shumë pak ia kanë dalë të jenë të sukseshëm. Sipas meje, kjo punë kërkon formim të plotë, në shumë fusha, përveç të tjerash edhe në fushën e muzikës. Mbledhës të shumtë edhe me emër kanë grumbulluar shumë këngë në popull. Një pjesë e tyre duke mos e njohur muzikën kanë mbledhur vetëm tekstet e këngëve. Padyshim që kjo është nje punë e gjysmake dhe e cunguar. Po vallë si mund të quhet këngë një tekst pa melodi? Ku janë notat e këngës? Artisti popullor vdes e bashkë me të edhe melodia. Po vallet? Ato s'kanë tekst. Si mblidhen ato, nëse nuk di notat e muzikës? Po lëvizjet e valltarëve?

I madhi, i papërsëritshmi, Ramadan Sokoli, një nga njohësit më të mëdhej të kulturës popullore shqiptare, ishte i tillë për faktin se, zotëronte një kulture të gjerë, që i jepte mundësinë t'a analizonte gjënë në kompleks; edhe në tekst, edhe në muzikë edhe në lëvizje, por edhe nga disa burime. Një i tillë ishte edhe Munir Shehu, pavarësisht se jo në dimensionin e tij nga përmasat, por në të njëjtin dimension nga mënyra e konceptimit. Kishte mandolinën me vete kudo që shkonte, nga Bulqiza e në kufi me Kukësin, se mund të takonte ndonjë të moçëm që s'mund ta gjente më e, mirë i mori tekstin, po melodinë ku ta gjente? Kërkonte deri në hollësi detajet në gjithçka. Në valle p.sh., kërkonte që në çdo lëvizje të valltarit të ruhej karakteri i valles, i zonës nga vinte, por edhe i grupimit, që i përkiste ajo. Kështu pra, ai mblodhi sa mundi, motive këngësh e vallesh të cilat, ato që paraqitnin një folklor të vërtetë, pasi i sistemoi i paraqiti në institutin e folklorit ku ruhen edhe sot në fondin e tij.

Motive të ndryshme, të bukura, por të pa plota, një pjesë i përpunoi, duke i vënë në skenë si përpunime, ndërsa të tjera i përdori për këngët e tij duke u munduar që asgjë të mos shkojë dëm, për të evidentuar sa të ishte e mundur më shumë larminë e pafund të temave të folklorit dibran. Ai është burimi i këngëve të Munirit. Të gjithë aty mbështeten. Edhe Tonin Rrota, edhe Përparim Tomcini aty janë mbështetur, por duhet të jesh budalla t'u mohosh atyre autorësinë duke thënë se ato janë popullore e nesër, pas disa vitesh, të dalë ndonjë folklorist e të thotë se ka zbuluar një këngë popullore! Mbi motive popullore shkroi Pushkini, Shileri etj., të gjithë të mëdhenjtë, por vepra mban emrin e tyre. Mbi motive popullore kompozoi Mozarti, Glinka, Çajkovski, Listi, por nuk thotë askush se vallet hungareze të Listit, nuk janë kompozim i tij. Kështu pra, motivi i "Bulqizakes", i bie të jetë zbuluar më herët, shumë më herët prej Munirit e jam plotësisht i bindur që ai e ka zbuluar pa biçikleta.

Nëse në 2004 takon një 94 vjeçar,ç'mund të thuhet për Munirin që 94 vjet para 2004, takonte 94 e 100 vjeçarë? Prandaj besoj, se në Bulqizë Muniri mori motivin, mori ngacmimin mbi të cilin ndërtoi "Bulqizaken". Shoh tek disa folës shfaqjen e një nacionalizmi pa kuptim, që shprehen se "pse duhet të shkojë "Bulqizakja" në Peshkopi, a në Dibër të Madhe, duke aluduar se autori nuk është bulqizak". Në këtë rast unë mbetem pa fjalë dhe sigurisht që hesht. Vetëm mendjet e sëmura, mund të arsyetojnë kështu. "Bulqizakja" është aty, është kudo e ku mund të shkojë ajo?

Naim Frashëri i Dibrës, Munir Shehu, i këndon Bulqizës kështu në tekstin e tij të "Bulqizakes": *Kam shetitun-o mal për mal e ven për ven/ Nji kto male nji kto lugina m'kan lan-o pa men"*. Këto vargje shprehin në mënyrën më të bukur poetike, gjithë dashurinë e tij për bukuritë bjeshkëve, të maleve e luginave të Bulqizës, për vajzat e djemtë e saj. Krahasojini pak me vargjet e Naimit kur këndon: "*O malet e Shqipërisë, e ju o lisat e gjatë.../ q'u kam ndërmend ditë e natë..."* A nuk e shfaqin dashurinë gati njëlloj? Muniri thotë se këto bukuri "*më kanë lanë pa men",* Naimi se*, "i ka ndërmend ditë e natë"*. Bulqiza vjen e plotë kur e njohim edhe dimnin e egër e pranverën e bukur të saj*: "dimni, dimni..., pranvera jetën mor t'a shton/ bulqizakja ngjitet malit dhe këndon"*. Theksimi dy herë i fjalës "*dimni, dimni"* të krijon menjëherë idenë se sa i fortë është ai ndër ato anë dhe sa e bukur pranvera që t'a shton jetën. Këto janë vargjet e Munirit dhe të askujt tjetër, që e bënë të famshme "Bulqizaken".

Vargjet: "*kam shetitun n'mal e kodër ven për ven/ a ma pe or djal tufën me dhen",* janë vargjet e Munirit të përshtatura nga ansambli për duet në mënyrën më të pakuptimtë, më të keqe të mundshme. Duke u ndryshuar kuptimin vargjeve, në fakt i është hequr shpirti, i është hequr këngës zemra, atdhedashuria, duke e thjeshtuar atë vetëm në një idil dashurie. Ana tjetër është se ato nuk kanë as kuptim, për arsyen e thjeshtë se, nëse të ka humbur bagëtia dilet *tuj kërku* e jo *tuj shetit*. Nuk kërkohet *tuj shetit*.

Ndër rreshta të tjerë Muniri vazhdon: "*Nji dit deshta un i mjeri me u afru,/iku shpejt, e u fut ndër dushqe e m'la idhnu.."*

Diku tjetër: "*Tiri- tiret të lumtë dora,/je e pastër moj porsi bora"*.

Kjo është vetë bulqizakja. Bulqizakja e vërtetë është baresha që shkon me dhen. Vendi i saj janë livadhet, pyjet me dushqe (*iku, u fut ndër dushqe*) ku ajo i fshihet të dashurit dhe i dashuri e thërret: oj bareshë! Bulqizakja bareshë mban furkën me lesh (*tiri-tiret* të lumtë *dora*...) Ajo ka bukurinë e atyne maleve dhe pastërtinë e borës që sjell dimni i atyne anëve (*je e pastër moj porsi bora)*. Ky është art, krijim. Unë seriozisht nuk e kuptoj ç'duan, cfarë kërkojnë? Kësaj i thonë të kërkosh gjurmët duke patur ujkun.

Bulqizakja bareshë, nuk është një vajzë në rrugë, pa furke në dore, pa bagëti, që sheh një çiklist, pa dele e pa dhen dhe menjëherë i thërret çiklistit: or bari! Jo që nuk të mbush mendjen, por as nuk të emocionon, për të mos thënë që t'a shpif. Dashuria lind në situata të ndryshme, dashuria me biçikletë mund të ketë ndodhur, por nuk është dashuria e bareshës. Sipas mendimit tim, nuk ka lidhje fare me këngën e as me motivin e saj.

Histori mund të bëjë kush të dojë dhe si të dojë, unë nuk merrem me të. Une thjesht mbroj krijimtarinë e tim eti. Për fat baba e ka gjalin xhallë!

Or bari/oj bareshë, mbeti në Bulqizë prej këngës, por ajo nuk është një thirrje që nuk i takon vetëm Bulqizës. Po të biesh për pak sekonda në meditim, duke mbyllur sytë, nuk do ta kuptosh se nga vjen jehona e kësaj thirrjeje. *O bari* e *o bareshë*, do të duket se vjen në veshët e tu nga shumë drejtime, që nga bjeshkët e Bulqizës, nga Grama e Korabit, e tutje nga bjeshkët e Kukësit e Kelmendit, ngado. Nga ku nuk vjen ajo thirrje, kudo ku ka barinj e baresha shqiptare që kullosin bagëtinë mund t'a dëgjosh atë thirrje.

Vargjet "*dashunin që kam për të/ nuk e ndrroj për kta di se",* sapo i lexova më sollën ndërmend këngën e Pjetër Gacit, "*Meraku i shkretë"* ku janë të njëjtat vargje, veçse me një gjuhë tjetër: "*dashurin që kam për ty/ nuk e ndrroj me kta dy sy",* po nejse nuk po zgjatem.

Sa i përket të paturit të disa teksteve, nuk do të thotë aspak se kjo nuk është një "këngë katedre", absolutisht. Një pjesë, duke përshtatur tekstin, në pamundësi të origjinalit, një pjesë tjetër për qefin e vet, kanë ndryshur fjalët, bile edhe notat, por kjo është puna e tyre, ç'lidhje ka.

Muniri ishte shumë i shqetësuar edhe nga mënyra se si e këndoi ansambli. Ai ishte i pakënaqur, dhe i mërzitur. Nuk e zinte vendi. Nuk mund të jeni në dijeni të këtij shqetësimi. Ky shqetësim kishte të bënte me atë se nga intepretimi, por jo vetëm, ngaqë dy këngëtarët ishin shkodranë, kënga kishte humbur karakterin dibran, nuk ishte më bulqizakja e Bulqizës, nuk dallohej kadenca dibrane. Nuk besoj se është shqetësuar kush tjetër për këtë. Po kush do të shqetësohej përveç autorit? Rujna zot se mos del ndonji e na e qet autorin shkodran, se ka ba Shkodra kangë për Bulqizën!

Perfundimisht, pa Munirin, Shqipëria, shqiptarët dhe Bulqiza do të ishin pa "Bulqizaken" dhe "Bulqizakja" do të kishte ngelur në arkën e mbuluar nga pluhuri i harresës dhe as "zbulimi" në 94' a 2004, nuk do të kishte vlerë. Nuk vlen, se kujt i duhet? Se ja, mendo, a do të merrte kush guximin të festonte 100 vjetorin e "Bulqizakes" po të mos ishte kënga e Munirit? Po këtë që u zbulua kush do t'a bënte këngë? Munir ka vdekur!

Bujar Karoshi, publikoi një fletë pentagrami me nota dhe tekst të shkruar nga dora e Munir Shehut, të cilin ia dhashë unë. Nuk mund të thotë askush, me cinizëm, ose jo, se ajo fletë s'ka vlerë. Është dokument, sepse është shkruar në vitin 1958, me shkrimin pra, të autorit. Po ju servir edhe një shkresë tjetër që për mua e mbyll problemin. Është shkresa e firmosur edhe nga drejtori i institucionit, për pagesën e krijimtarisë të Munirit. Shikojeni vetë. Aty është edhe "Bulqizakja".

Jepini Çezarit, atë që i takon Çesarit. Aq sa vlen materialisht kromi i Bulqizës, aq vlen shpirtërisht, "Bulqizakja" e Munirit. Ajo është miniera e floririt shpirtëror të Bulqizës.

Mirënjohja, thuhet shpesh, është një nga ndjenjat më të bukura që ka krijuar raca njerëzore dhe anasjelltas. Jepeni atë, të paktën atë. Vetëm ju nderon.

Jeta Munirit, si fati e solli, ishte një jetë të cilën ai nuk e meritonte. Për gjithë sa humbi, duke marrë titullin e librit të Kadaresë: *Eskili ky humbës i madh*, vetëm duke ndryshuar emrin unë kam quajtur babin tim, *Munirin, një humbës* të *madh*.

MIRDASH SHEHU / *Shtator 2019*

cyan magenta yelloë black

portret



Edmond Zhulali

karriera artistike nisi me një kitarë

Ndoshta më shumë se sa për talentin, ai fëmijë u fiksua në atë kohë për "veshin" e muzikës që kishte. I mbante mend të gjitha melodité që luante, edhe pse nuk kishte bërë kurs. E për më tepër nuk bëhej fjalë për nota muzikore, në atë kohë. Madje edhe këtë kitarë e përdorte vëllai i tij i madh, Kadriu. Kur ai ikte në punë, vogëlushi hipte mbi stol, e zbriste nga muri, e vendoste në dysheme dhe ashtu siç ishte shtrirë, filloi të disiplinonte tingujt, deri sa t'i përngjasonte me ndonjë motiv që kishte dëgjuar në radio.

Nga **AGRON SEJAMINI**

Shikoni këtë fëmijë që nuk mban dot kitarën... Hyn në skenë dhe pushton një sallë me qetësi dhe habi... Ulet në karrike dhe i sjellin një kitarë më të madhe se sa është vetë. Aq sa nuk e mban dot si të tjerët. Publiku çohet më këmbë dhe shpërthen në duartrokitje, paçka se akoma, nuk është dëgjuar asnjë tingull nga gishtat e tij... Më pas, dëgjohen melodi të interpretuara saktë nga vogëlushi gjashtëvjeçar, me emrin Edmond Zhulali. Ndoshta më shumë se sa për talentin, ai fëmijë u fiksua në atë kohë për "veshin" e muzikës që kishte. I mbante mend të gjitha melodité që luante, edhe pse nuk kishte bërë kurs. E për më tepër nuk bëhej fjalë për nota muzikore, në atë kohë. Madje edhe këtë kitarë e përdorte vëllai i tij i madh, Kadriu. Kur ai ikte në punë, vogëlushi hipte mbi stol, e zbriste nga muri, e vendoste në dysheme dhe ashtu siç ishte shtrirë, filloi të disiplinonte tingujt, deri sa t'i përngjasonte me ndonjë motiv që kishte dëgjuar në radio. Aq sa "zbuti" edhe të vëllanë, duke fituar të drejtën që ta përdorte atë vegël muzikore, sa herë të dëshironte. Më pas doli në skenë, në një nga koncertet e fëmijëve të Peshkopisë.

Jehona e madhe në atë qytet lindor, u hoqi ndrojtjen pjesëtarëve të familjes që ta çonin të interpretonte edhe në një aktivitet artistik në Tiranë. Akoma edhe më shumë sukses aty. Pas shfaqjes, u lodh së luturi drejtori i Liceut të Tiranës. E si mund të bindej nëna e tij, për të lënë një fëmijë gjashtë vjeçar, vetëm në konvikt. U kthyen në Peshkopi, pa mundur të kuptonin nëse e kishin fituar apo humbur fatin. Vonë, pas shumë vitesh, kur përfundoi shkollën tetëvjeçare, ndjenë se kishin humbur. Rregullat e kohës nuk e favorizonin Mondin që të fitonte bursë, pasi atë e kishin përfituar disa herë vëllezërit e tij më të rritur. Ndaj, mundësia e vetme ishte që ai të konkurronte për muzikë. Shkoi në Shkodër dhe doli i pari. Për trompë, studioi ato katër vjet. Diçka më shumë kërkonte të mësonte gjatë studimeve në Institutin e Lartë. Ndaj konkurroi edhe për kompozicion. Të dyja degët i fitoi, por e dyta, ishte privilegj për studentët me mbiemër dhe jo ata me talent. Gjithsesi, në të njëjtën kohë, ai studionte dhe përvetësonte vetë edhe etapat e kompozicionit. Për këtë, i është mirënjohës edhe të nderuarit Gjon Simoni... U rikthye në qytetin e lindjes më i përgatitur dhe më i aftë se kurrë. Duke patur në krah edhe këngëtarët e shquar Arif Vladi dhe Liri Rasha, Edmond Zhulali do bëhej gjithnjë e më i njohur, në gjithë Shqipërinë...

Në udhën e gjatë dhe shumë të suksesshme, që ai ka përshkruar në vijim, kujtojmë se ka qenë drejtor artistik për disa vite në Radio Tirana, drejtor artistik i Festivaleve 45 dhe 46 në RTSH, ndërsa tani punon në studion e tij, nga ku ka përgatitur rreth 30 albume muzikore. Gjeografia e bashkëpunimit me këngëtarët përfshin të gjitha trojet shqiptare. Me ta, në studion e tij të pajisur me teknologji të kohës, ka realizuar kompozime, orkestrime dhe regjistrime. Mjafton të përmendim emrat e Irini Qirjakos, Eli Farës, Hysni Zelës, Petrit Lulos, Arif Vladit, Liri Rashës, Fatmira Breçanit, Dava Gjergjit, Vera Laçit, Ilir Shaqirit, Sabri Fejzullahut, Leonora Jakupit etj, etj., dhe nënkupton se sa në lartësi ka shkuar mjeshtëria dhe profesionalizmi i Edmond Zhulalit. Po aq të suksesshme janë edhe realizimet me këngëtarët e muzikës së lehtë, si: Kastriot Tusha, Aleksandër Gjoka, Manjola Nallbani, Myfarete Laze, Elsa Lila, Aurela Gaçe, Bleona Qereti, Ledina Çelo, Rovena Dilo, Anjeza Shahini, Mariza Ikonomi, etj.

Por vendin e nderit në krijimtarinë e vet ia lë asaj me temë nga Kosova. Duke njohur shumë mirë muzikën e trevave të Veriut ai ka kompozuar mbi 100 këngë për luftën e Kosovës. Ende emocionohet dhe loton kur kujton 81 koncertet e dhëna në 21 shtetet e Europës, ku ai ka qenë udhëheqës artistik e muzikor. Më shumë se sa këngë, ato mbeten në fondin e artë të pasurisë kombëtare, si kushtrim atdhetarie dhe lirie...

Jo pak interesante është historia e familjes Zhulali. Edhe pse me prindër të lindur në Gjirokastër, ata njihen si dibranë. Nga viti 1946-1991 ka jetuar kjo familje në këtë trevë. Themi trevë, pasi në Peshkopi mbërritën pas dhjetë vjetësh. Fillimisht, dy mësuesit e ardhur nga Gjirokastra u caktuan të jepnin mësim në Gurrë të Madhe të Burrelit. Ende nuk i kishin mbushur 25 vjeç, kur nisi përballja me vështirësitë, që u bënë udhëtarë të jetës së tyre. Me ta, edhe dy prindërit, njëri prej të cilëve ndërroi jetë në këtë fshat. Një familje e thjeshtë dhe e respektuar nga të gjithë banorët, jo vetëm si përçues të dijes dhe kulturës, por edhe për thjeshtësinë.



Pas disa vitesh të stabilizimit në qytetin e Peshkopisë, familja humb të zotin e shtëpisë. Tani shtatë fëmijë, i madhi 24 dhe i vogli 6 vjeç rriteshin nën dashurinë dhe merakun e nënës së tyre, Dritës. Hallet dhe nevoja ekonomike burrëruan para kohe dy djemtë më të rritur në moshë, Kadriun dhe Safetin. Më pas kjo peshë, kaloi e gjitha te i dyti, sepse i pari iku në Tiranë. Me atë mbarësi që kishin ata fëmijë, një nënë do dëshironte të kishte jo shtatë, por shtatëmbëdhjetë...

Të gjithë ishin model në shkollë, lagje dhe në qytet. Fotografitë e Zhulalëve kishin zaptuar tabelat e nderit. Kështu, në tetëvjeçare, në shkollat e mesme dhe në të larta. Të shtatë kanë mbaruar universitetet. E nëse shprehet dyshim për këtë fakt, gati kemi tjetrin... Të tetëmbëdhjetë fëmijët e tyre, kanë mbaruar të gjithë shkollën e lartë... Ja pse janë kaq të dëgjuar dhe të respektuar Zhulalët! Me këtë fis, "e papritura" më e madhe ndodhi në fillim të lëvizjes demokratike. Para këtij momenti ata ishin njerëz me autoritet dhe pushtet në atë qytet. Safeti, mësues matematike në gjimnaz, Zymbylja, shefe e kulturës së rrethit, Mondi, shef i muzikës në estradën profesioniste të qytetit, Përparimi, përgjegjës i sektorit elektrik të rrethit... E kishte të fjetur mendjen partia, se të paktën këtu, nuk mund të këputej aq lehtë filli. Por ndodhi e kundërta.

Ndër të parët, në krye të atij uragani që zaptoi Dibrën, ishte biri i kësaj familje, Safet Zhulali. Nuk kishte dibran që të vinte në dyshim, pastërtinë, ndershmërinë, zgjuarsinë dhe largpamësinë e këtij matematicieni. Dhe vërtet, asnjë nuk u zhgënjye në llogaritë e veta, kush vendosi të ecë pas tij. Aq më tepër që ata nuk e quanin veten të persekutuar në atë regjim. Kjo i bëri edhe më të besueshëm në atë garanci absolute që jepnin për sistemin e ri demokratik. Sheshet e Peshkopisë dhe të mbarë Dibrës ishin të vegjël, në ato ditë që mes tyre kishin Sali Berishën dhe Azem Hajdarin. Mes tyre, i paepur Safet Zhulali...

Shpjegohet dhe mirëkuptohet rreshtimi i tyre aktiv dhe i palëkundur në të djathtën shqiptare. Vërtet ishin kuadro në administratën e atij sistemi, por ama dhe çdo ditë, ndjenin padrejtësinë dhe paaftësinë e njerëzve që kishin mbi krye. Edhe interesi i partisë dhe i pushtetit popullor tek ata nuk lidhej aq me besimin, se sa me shfrytëzimin e aftësive të tyre profesionale që ata i shpalosnin në frontin ku shërbenin. Ishin të tjerë ata që bënin militantin.

Karakteri i Zhulalëve ishte kristal. Mbaruar shkollën të gjithë, me rezultate të shkëlqyera, ata ndjeheshin zot në profesionet e tyre. Edukuar dhe rritur nga prindër të shkolluar dhe kulturuar, e patën më të lehtë të bënin pjesë të karakterit të tyre, ndershmërinë, pastërtinë dhe krenarinë. Ndaj, ata janë po aq të vlerësuar dhe të respektuar edhe në këto vite të demokracisë!

HERA E PARË DHE E FUNDIT QË VEPROI SIPAS POROSIVE TË PARTISË...

Në vitin 1989, një nga flautistet e orkestrës së estradës profesioniste të Peshkopisë, mori lejën e lindjes. Në vend të saj, erdhi një vajzë 18 vjeçare që sapo kishte mbaruar për flaut. E ndërsa të tjerëve u ra në sy kjo simpatike, dirigjentit i pikoi në zemër... Në atë kohë Mondi ishte 28 vjeç. Mjaftuan ato pak muaj që mes tij dhe Lilianës, të lindte ajo dashuri që nuk do shuhej kurrë. Një ndjesi e fuqishme, magjike, që nuk e la të mendohej gjatë për të shpallur fejesën...

Ishte e para dhe e fundit herë që Edmond Zhulali besonte te partia, e cila këshillonte që shoqen e jetës duhej ta zgjidhje në frontin e punës, në zbore ose aksione. Pas nëntë muajsh, në orkestër u rikthye flautistja që kishte marrë lejën e lindjes. Liliana iku nga ajo punë provizore, por hyri përjetësisht në zemrën e muzikantit të talentuar. Aq sa më pas edhe partinë nuk e deshte sa atë... Këtë e dëshmoi edhe turneu i Austrisë. Ishte bërë traditë që me vendet mike, Shqipëria organizonte Javën Kulturore, e cila përfshinte veprimtari kulturoro-artistike, si koncerte, ekspozita etj. Në Vjenë ishte caktuar të shkonte edhe ansambli folklorik "Dibra" i Peshkopisë. Natyrisht, pjesë e tij ishte edhe shefi i muzikës së estradës së atij qyteti, Edmond Zhulali. Por jashtë shtetit kishte ca lloj të tjerë shefash..

Në një nga ato ditë, Mondit i jep këshilla të çuditshme një "specialist", që nuk e kishte idenë nga muzika. Mërzitet aq shumë për atë imponim të padëshiruar, sa për një moment vendos që të largohet jo vetëm nga veprimtaria, por edhe nga... Shqipëria. Ndërkohë që nga këta njerëz iu pështiros gjithçka, rigjeti qetësinë vetëm kur solli ndërmend Lilianën dhe familjen...

ÇATIA, ÇATIA, POR... TË MOS HARROHET EDHE THEMELIA!

Ndjehet krenar dhe i është mirënjohës për gjithë jetën Safetit. Më shumë se vëlla, e ka ndjerë prind, pasi kur humbi të atin ishte vetëm gjashtë vjeç. Nën kujdesin e tij, u rrit, u edukua, u shkollua dhe u burrërua Mondi. I ka ndenjur pranë gati në çdo hap që ka hedhur në jetë. Jo pak i kënaqur, ka qenë edhe Safeti prej ecurisë së vëllait të vogël...

Lumturohej dhe entuziazmohej nga muzika e Mondit. Veçanërisht nga krijimtaria për Kosovën. Disa shumë herë shkonte në studion e tij, për të dëgjuar ato kushtrime atdhetarie dhe lirie. Ndryshe ishin vizitat për te zyra e Safetit. Jo se ishin të pakta dhe të kufizuara, por çdo i afërt apo mik nuk harronte këshillën e tij: "Hajdeni kur të doni dhe për çfarë të doni. Vetëm jo për punë biznesi !". Mondi kujton dhjetëra raste kur Safeti u është ndodhur pranë njerëzve të thjeshtë dhe nevojtarë. Ishte shumë i dashur, i thjeshtë. Vuajtjet e kishin bërë njeri të arsyeshëm dhe të qetë. Karriera e tij në politikë e miqësoi akoma edhe më shumë me duhanin. Pinte dy-tri paketa në ditë. Cigarja e ndihmonte në qartësinë dhe pjekurinë e fjalës. Ai fliste pak, por saktë! Jo vetëm pjesëtarëve të familjes, por kujtdo i imponohej me kulturën dhe peshën e mendimit.

- Nuk mbaj mend të ketë sharë një herë në debatet politike apo në jetën e përditëshme familjare. Nëse do më pyesnin për një të metë të Safetit, do thosha se ishte më i ndershëm dhe i më i drejtë se sa duhej,- shprehet Mondi.

Edhe pse ai ka vite që është larguar nga kjo jetë, kujtimi dhe respekti është i vazhdueshëm te të afërmit dhe gjithë shoqëria. Kujtojmë gjithashtu, se dy qytete, ai i Peshkopisë dhe i Libohovës e kanë shpallur "Qytetar Nderi". Veç kontributit të jashtëzakonshëm që ka dhënë Safeti për lëvizjen demokratike në qarkun e Dibrës, po aq e vyer është karriera e tij politike në qeverinë demokratike. Duke qenë për vite me radhë ministër i Mbrojtjes, iu dha shansi që të ishte në ballë të reformave ushtarake. Ishte porta nga ku do hynim në Europë.

Integrimi dhe pranimi në NATO, ishte motivi kryesor. Mondi kujton atë intensitet angazhimi dhe obligimi të vëllait të vet. Janë dhjetëra takime prezantuese dhe vlerësuese nga dikasteret homologe të ushtrive të të gjitha vendeve të Perëndimit. Për vetë kohën dhe nevojën, jetike kanë qenë kontaktet dhe bashkëpunimi me Pentagonin. Tri herë është pritur në SHBA, duke i organizuar ceremoni të plotë, me 21 të shtëna topi...



Naim PLaku, ai burrë i imët, ai krijues i njohur, ai njeri fisnik dhe edukator modest, por i diferencuar, kishte "fituar imunitetin" për të mos pritur vlerësime administrative e publike të këtyre përmasave.

Naim Plaku, bashkëpunëtor i urtë e krijues i spikatur

Nga ESAT RUKA

Me krijuesit, produktin e të cilëve e ndesh në skenë, shpesh njihemi me emrin e tyre nëpërmjet krijimtarisë më parë se fizikisht. Kështu ka ndodhur midis meje dhe z. Naim Plaku. Nëpërmjet ëmbëlsisë së vargut, figurave të zgjedhura, leksikut të përdorur apo fabulës së ndërtuar të krijonte përfytyrimin se ke të bësh me një njeri trupmadh e energjik, e herë herë delikat e të brishtë. Padyshim jehona e krijimtarisë së tij poetike e vënë në gojën e interpretuesve dhe zërave cilësorë të Peshkopisë si Arif Vladi, Qerim Sula, Sajhe Poleshi, Liri Rasha, Vera Laçi etj do nxitëte interesimin e çdo krijuesi serioz . Kjo ndoshta edhe për shkak të tipareve të përafërta në krijimtarinë shpirtërore në disa zhanrre artistike si treva fqinje.

Skena e Kalasë së Gjirokastrës ishte parada më prestigjioze e anonimatit artistik, ku derdhej mozaiku dhe ashti më i fosforizuar i krijimtarisë popullore. Shumë kontribute krijuese "shkrihen" breda kritereve të atij Festivali. Sigurisht do të shkonte "haka tek i zoti", tek populli, por individualitetet krijuese i "hante" anonimati kolektiv. Kështu ka ndodhur ka shekuj, ka mote...

Epika historike do të shungullonte në krijimet e Naimit si një vullkan, sepse të parët e tij kishin derdhur shumë gjak e lot në shumë luftra me turqit, austriakët, sllavët etj.

Vargjet:

Moj Kosovë me ksulë të bardhë,
Shtati yt me dyzet plagë,
Shtati yt është bajrak i gjallë
Sa mirë po i rrin hasmit përballë...,

muzikuar nga kompozitori Përparim Tomçini dhe kënduar nga Arif Vladi, i çonin peshë zemrat e shqiptarëve duke mbajtur të ndezur shpirtin e lirisë e të drejtave kombëtare përballë represionit serb dhe qëllimeve shfarosëse ndaj kosovarëve.

Kënga "Na këndojnë pushkët nëpër kulla" është ndër krijimet më të bukura, e paraqitur në FFK Gjirokastër 1983. Ai hit shumë shpejt depërtoi në shpirtin e dëgjuesit, si një portretizim heroik i dibranit. Një krijim perfekt, ku shkrihen në mënyrën më origjinale të gjithë elementët përbërës që e bëjnë të dashurohet një këngë: muzika, teksti, interpretimi dhe shoqërimi muzikor.

...Dridhen malet, jo nuk tunden kullat
N'log t'mejdanit maten burrat,
Se lëshojmë pllambën pa i ndërrue kësulat
...Kadal hasëm se këtu ka burra
Na këndojnë pushkët nëpër kulla
Ta shtrojmë vendin pllambë e plumba...

Kjo këngë sintetizon qëndrimin e gjeneratave shqiptare në mbrojtje të lirisë dhe dinjitetit, një solidaritet breznishë që ushqen dinjitetshëm të drejtën për të trashëguar vlerat e të parëve në trojet stërgjyshore. Padyshim që përballë një teksti të tillë, "që të ngjeth mishtë", shkruar me mjeshtëri e talent, e realizuar estetikisht edhe nga kompozitori e këngëtari, do të ngjiteshin natyrshëm në obeliskun e një legjende që do të jetojë gjatë.


Po kaq me ëndje janë ndjekur edhe lirikat bukura të luginës së Drinit, këngët e kurbetit, apo të dashurisë, mbasi mjeshtri i vargjeve ishte mëkuar me larminë dhe begatinë e madhe të krijimtarisë anonime dhe kishte hyrë natyrshëm në "lëkurën" e traditës popullore, sa bëheshin menjëherë pronë e dëgjuesit dhe krenari e nahijes së tij.

"Këndojnë dy bilbila", ishte bashkëpunimi im artistik me poetin Naim Plaku. Duetin e kam kënduar me këngëtaren e mirënjohur Iris Bega dhe grupin vokal i Ansamblit të Këngëve e Valleve Popullore, me figura të bukura personifikime e similituda të pasurisë së natyrës shqiptare:

Djali: "mollë o moll me bojë,
mollë, mollë bojë alli"...
Dil moj dil në derë, se më dogji malli,

*Vajza: P*ëllumb, pëllumb i bardhë,
pëllumb, pëllumb i shkrue
ku po don me dalë, pse don me m'trazue,
....

Në këngë dialogohet thjeshtë e bindshëm pa moralizime, por me ndjenja të brendëshme



deri në krijimin e një atmosfere njerëzore:

këndojnë dy bilbila, këndojnë e s'pushojnë
derdhen në lindina, qeshin e gëzojnë
Çelin trëndafilat-o hapen si zambak
dy bilbila mali, këndojnë për marak...

Naimi, në autorësinë e teksteve të këngëve, kishte rolin e primatit në Peshkopi duke u dalluar në bashkëpunime me krijues të muzikës si Përparim Tomçini, Edmond Zhulali, Xhelil Imeri, Xhevat Fana etj.

Por duhet thënë që, si çdo krijues tjetër, Naim Plaku nuk mund t'i shpëtonte orientimit të kritereve të politizuara të sistemit diktatorial. Padyshim s'mund të ishte ndryshe. Patetizmi apo fryma e pseudorealitetit do të spërkasnin ideologjikisht tituj apo vargje të këngëve të tij. Nuk janë të pakta rastet, sidomos në letërsi dhe në arte, kur shkruan dora e krijuesit dhe jo shpirti e kthjelltësia e mendjes së tij. Ky ka qenë fati i krijuesve në epokën e "realizmit socialist".

Përse të mos e themi që Naim Plaku ishte patriot **!?**

A nuk është fryma racionale e nacionalitetit të tij që i buronte gjenetikisht për t'u orientuar drejt vlerave të historisë e traditës së nahijes së vet? Angazhimi i një krijuesi ndaj subjekteve historike, mendoj se nuk është vetëm çështje arsimimi. Ky inspirim është në radhë të parë një borxh ndaj origjinës së tij, qëndrimit të të parëve në marrëdhënie me traditat, historinë, kombin dhe gjuhën e normat zakonore, filozofinë etj. Dhe s'ka se si Naim Plaku të mos ishte i tillë, kur pikërisht për këto tipare e kontribute ai tkurrej e anashkalohej si një element dyshues. Prandaj edhe krijuesve, jo rrallë i ndodh ai pështjellim artikulimi në publik, ku ish persekutorët e djeshëm flasin për 'të si të mos kishte ndodhur asgjë me kufizimet, dyshimet apo shpërfilljet ndaj tij. Por për këto çështje ndoshta flasin kolegët e tij dibranë.

"I kujtoj vitet e fëmijërisë afër dajës poet, teksa krijonte në verandën prej çimentoje, ku me orë të tëra punonte duke shpenzuar dhjetra fleta të bardha për të "gjetur" fjalët apo shprehjet e duhura që të miratoheshin nga "specialistët" drejtues të festivalit" tregon Afrim Çenga.

Kishte 117 fleta të shkruara mbi tavolinë dhe vazhdonte të shkrunate e të prishte. E pyes:"pse e ke shkruar tekstin e këngës të përsëritur disa herë njëlloj"? Jo më thotë nuk janë njëlloj, kanë disa ndryshime të vogla, por duhet t'i kemë në disa variante që t'u pëlqejnë drejtuesve, sepse ato bëjnë verejtje dhe po nuk u pëlqeu e heqin fare krijimin?", më thoshte. Mbi një fletë tymoste disa orë pa lëvizuar vendit - thotë ing. Afrimi, teksa i mbushen sytë me lot për dajën. Por Afrimi nuk nguroi të thoshte se, "daja Naim, në fillimet e pluralizmit na porositi: "Në rast se doni, aktivizohuni nëpër subjekte politike, por jo shumë larg nesh..." Ai donte të thoshte se: "i kujtoni diferencimet që kemi provuar e vuajtur duke qenë nipa të "Gjeneralit me shajak", trimit Elez Isufi. Këtu nipi Afrim ndoshta

Naim Plaku nuk ishte thjeshtë një talent krijues në fushën e poezisë së këngës. Ai ishte një gjurmues e mbledhës i vlerave të folklorit, një përpunues e klasifikues i tyre dhe një botues e promovues i kualifikuar e serioz. Me botimet e tij studimore ai ka pasuruar opusin e etnologjisë kombëtare si dhe ka prezantuar me dinjitet vlerat e trashëgimisë së zonës së tij. Dashuria për këto vlera të vendorigjinës, Sllovës e kishin frymëzuar edhe si qytetar e si intelektual.

ndjente njëfarë borxhi ndaj këshillës së dajës dhe u kujtonte se nipave te "gjeneralit" nuk u takonte të rreshtoheshin me persekutorët e dajave.

Talenti dhe puna e Naim Plakut, si e çdo artisti e krijuesi, tejkalon kufizimet ideore e pengesat qofshin këto edhe të qëllimta edhe për shkakun madhor e fatlum se *Zoti i Madh ka dhuruar tek këto qenie njerëzore cilësi e veçori për të ushqyer e fisnikëruar shpirtin e mendjen të tjerëve, për të adhuruar të bukurën e të dobishmen, për të lartësuar dijen e për të ndriçuar historinë e kulturën.*

* * *

Me konsolidimin dhe dimensionimin e normave Statutore, QKVF, për periudhën 2006 – 2014, u ishte drejtuar me sukses promovimit të disa institucioneve, zhanreve e formacioneve artistike apo individëve, që ishin futur me dinjitet në fondin kombëtar të artit e kulturës.

Në maj 2009 i erdhi radha 60 Vjetorit të Ansamblit "Kuvendi" në Zall Dardhë të Peshkopisë. Si njohës i imët i veprimtarive kulturore, por edhe si krijues shumë original, Naim Plaku, u caktua për të hartuar libretin e veprimtarisë, që më vonë u përdor për filmin dokumentar të atij Përvjetori. Kështu poeti, gjurmuesi i folklorit dhe botuesi i tyre çmohej më shumë se një bashkpunëtorë i yni i zakonshëm. Kërkesën e bërë nga ana jonë për organizimin e një veprimtarie kushtuar kontributit të Tij krijues nga ky institucion shtetëror profesionist Naimi e pret me gëzim dhe me besim të plotë. Ai kishte integritet dhe ishte racional në konsideratat për institucionet.

Gjatë jetës krijuesit, me përvojën e tyre kanë arkivuar në memorien kolektive vlera që kanë ndriçuar, kanë argëtuar apo kanë promovuar ide, histori e bëma nëpër gjenerata. Njohja e krijimtarisë, respekti ndaj personaliteteve dhe artit, përbëjnë kolonat e politikave kulturore të shtetit. Zbërthimi dhe trajtimi i këtyre politikave kulturore është detyra themelore e organizmave drejtues e specialistëve, duke respektuar origjinalitetin e koherencën në përshtatje me rrethanat specifike.

Periudha e tranzicionit politiko-ekonomik dhe denatyrimi i origjinalitetit të vlerave tronditi thellë psiqikën krijuese të artistëve. Deformimi dhe eliminimi i shumë emrave të mëdhenj e kishin thërmuar ashtin e origjinalitetit tradicional duke i vënë krijuesit e ndërgjegjshëm përpara një sugjestioni intelektual. Kërkohej, rishikuar dhe rindërtuar sipas një mendësie të re. Emrat e mirënjohur mund dhe duhet t'i rezistonin "tregut" artistik. Ky "treg", "lulëzoi" masivisht vrullshëm duke breshëruar këngët, vallet, rapsoditë, humorin e deri te veshjet popullore. Pra duhej veshur një "kostum" i ri krijues. Dhe kjo do të kërkonte kohë, guxim, vendosmëri, por edhe profesionalizëm e koherencë.

I ceka këto të vërteta në këtë punim, pasi janë specifike për një arsimtar si Ai, që ka punuar mbi 40 vite në shkolla me të rinj dhe të reja, në sektorin më të infektuar politikisht. Ajo ideologji u përpoq me program të çrrënjosë e të shtrembërojë historinë e traditat, të luftojë e të survejojë çdo vatër e prag të shëndoshë, të varfërojë e të shkatërrojë çdo kostitucion njerëzor tradicional, të mënjanojë e anatemojë superstrukturën krijuese intelektuale vetëm e vetëm se predikonin vlera e ide që nuk përkëdhelnin ideologjinë komuniste. Frika e terrori kërcënonin hapur e në çdo moment. Puna dhe misioni i një krijuesi letrar a mësuesi s'mund të përmendte Fishtën. Atij i kërkohej të argumentonte e të mbronte para nxënësve vrasjen nga komunizmi të një bashkëkrahinasi, të mos mund të përmend në familje emrin e dajës etj.

Plotësimi i këndit të emulacionit socialist me shifra të rreme, kur thahej buza e një kooperativisti për një gotë dhallë, kur diskretitohej një fshatar se agjëronte ramazan, apo gjobitej e i rrezikohej tesera e anëtarit të Frontit se nuk nxirrte gruan rregullisht në punët e kooperativës. Këto fakte rrënqethëse e shumë të tjera, përbënin objektin kryesor të punës së një intelektuali në fshat i cili duhej t'i reflektonte në përditshmërinë e kumtit të tij krijues e profesional.

Është e vërtetë se filozofia popullore në odat e asaj nahije është e vjetër dhe interesante. Por shumë subjekte të alegorisë dibrane kanë protagonizmin e pasluftës së Dytë botrore. Kundërshtia dhe mëllefi ndaj përdhosjes së traditës kërkonte të gjente mënyra për t'u ndërtuar e për t'u shprehur.

Ciceroni nënvizon se: *"Të mos dish çfarë ngarjesh kanë kaluar para nesh, është sikur të duam të mbetemi përgjithmonë fëmijë"*. Asnjëherë mendoj se nuk mund të quhen të tejkaluara reagimet ndaj atyre situatave vrastare, sidomos kur është fjala për të bërë bilance krijuesish. Në se është konfirmuar deviza se *"njeriu është produkt edhe i rrethanave shoqërore"*, atëherë analistët e promovuesit e sotëm duhet të buçasin se *heshtja ndaj kriuesit është vrastare për punën e tij*.

Duke i çmuar cilësitë e krijuesit dhe duke i njohur cilësimet e tij si i defaktorizuar, ndjenim një detyrim të dyfishtë të ofronim një trajtim më njerëzor e profesional.


U fillua menjëherë për platformizimin e realizimit të një veprimtarie të plotë promovuese me krijimet, opinionet dhe rrezatimin e punës dhe jetës së Naim Plakut. Padyshim bashkëpunimi ynë me Shoqatën e Intelektualëve të Dibrës në festimin e 70 Vjetorit të lindjes së tij dhe ndarja e detyrave në mënyrë komplementare ishte faktor me rëndësi dhe me ndikim. Artistët dibranë, simpatizantët e artit dhe krijimtarisë së tij, Qendra Kulturore e Peshkopisë, kolegët dhe donatorët demostruan një solidaritet dhe vlerësim profesional e njerëzor.

Por, nostalgjia për politikën mjerisht dominon edhe kur jemi në shtratin e vlerësimit të figurave të artit. Ja fakti: Nuk e dinim të gjithë që në këtë 70 Vjetor do të marrë pjesë edhe z. A. Ahmeti- lider i të majtëve shqiptarë në Maqedoni. Drejtues të Shoqatës së Intelektualëve u shfaqën më të prokupuar për pritjen e "miqëve" të politikës, aq sa u mbeti pa siguruar edhe media për të regjistruar aktivitetin që mbahej në sallën e TKOB. Kjo, si pakuptuar, dëshmoi një çvendosje të protagonizmit të mbrëmjes së asaj nate.

Por unë tjetërkund dua të fokusohem.

Ai burrë i imët, ai krijues i njohur, ai njeri fisnik dhe edukator modest, por i diferencuar, kishte "fituar imunitetin" për të mos pritur vlerësime administrative e publike të këtyre përmasave. E si mund të mos i pështilleshin në grykë shumë "shpërthime" të furishme emocionesh të ndrydhura apo të mbështjellura si në një anxhajk duhani.

Komuna e Dibrës në Maqedoninë e Veriut shpall "Qytetarë Nderi" tre studiuesit shqiptarë Tofik Jegeni, Molnar Kolaneci dhe Saimir Shatku



Nderimi për ata që pamundësuan devijimin e Radikës

Nga **HALIL RAMA**



Në kohën kur shkroi romanin me titullin sinjifikativ "Të gjithë lumenjtë rrjedhin", shkrimtari i mirënjohur Teodor Laço as që e kishte çuar ndërmend tentativën e ndokujt për të ndryshuar dhunshëm rrjedhën e lumit Radika. Por para pesë vitesh, ashtu si edhe pjesa më elitare e shoqërisë shqiptare, Laço iu bashkua protestës së banorëve të dy Dibrave dhe të shoqatave mjedisore kundër devijimit të Radikës në lumin Vardar. Dhe më kryesorja, ky personalitet i letrave dhe politikës shqiptare, e shprehu vlerësimin e tij pasi kishte lexuar veprën "Dibra e Madhe dhe Radika" të cilin tri bashkëautorët: Tofik Jegeni, Molnar Kolaneci dhe Saimir Shatku e promovuan në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë dhe me shoqatën "Bashkësia Dibrane" në dhjetor të 2016.

Tre vjet më vonë, pikërisht për ekspertizën shkencore dhe rolin e tyre në kundërshtimin e projektit për devijimin e lumit Radika, Komuna e Dibrës në Maqedoninë e Veriut i shpalli "Qytetarë Nderi" tre studiuesit shqiptarë.

Tofik Jegeni, Molnar Kolaneci dhe Saimir Shatku, si edhe personalitete të tjera të elitës intelektuale shqiptare, gjatë gjithë vitit 2014 iniciuan dhe drejtuan protesta masive në Tiranë, në Dibër të Madhe, por edhe në Peshkopi, për të mos pranuar projektin e qeverisë maqedonase për të ndryshuar rrjedhën e lumit Radika, pasi kjo ndërhyrje do të ishte me pasoja katastrofike për ekosistemin dhe burimet ujore të zonës.

Pikërisht për këtë kontribut Komuna e Dibrës së madhe nderoi këta personalitete të shkencës dhe jurisprudencës shqiptare që iu kundërvunqëë me kurajo qytetare si askush tjetër segmenteve të errëta matanë e brenda kufirit tonë shtetëror, duke mundësuar mosdevijimin e lumit Radika.

Kreu i Komunës Dibër e Madhe, Dr.Hekran Duka thotë se Titulli "Qytetarë Nderi" i Dibrës së Madhe (për tri personalitetet: Jegeni, Kolaneci e Shatku të dekoruar edhe me titullin "Mjeshtër i Madh" nga Presidenti i Republikës) konsiston në vlerësimin e kontributit të tyre si zëdhënës të shqetësimit kombëtar, sepse devijimi i lumit Radika do të sillte dëme të pallogaritshme për territorin dhe jetën e më shumë se 20 mijë banorëve të Dibrës së Madhe. Në veprën e tyre ata argumentuan këto pasoja si dhe qëndrimin e shkencës shqiptare në mbrojtje të burimeve hidrike, kundër pretendimeve të qarqeve të caktuara shovene maqedonase, duke mos lejuar që të preken ujra lumenjsh që në shtratin natyror e kanë kalimin ose derdhjen në territorin shqiptar.

Nën trysninë e peshës së revoltës qytetare, por dhe të zërave kritikë brenda legjislativit shqiptar, ata vlerësuan që më në fund erdhi edhe reagimi i kreut të ekzekutivit shqiptar, si garanci se nuk do të lejohet që të prekej interesi i Shqipërisë. Gjithsesi, nëse asokohe për eksponentë të caktuar edhe nga mazhoranca shqiptare, lumi Radika ishte "shumë zhurmë për asgjë", revolta qytetare për këtë çështje, në krye të së cilës ishin tri personalitetet e nderuara nga Komuna e Dibrës së Madhe, si edhe profesorët e akademikët e nderuar Artan Fuga e Bujar Kapexhiu, bëri që me rezistencën e tyre paqësore të shmangej kjo katastrofë që do të sillte dëme të mëdha në ekosistem, do të dëmtonte rëndë ekonominë e shqiptarëve të krahinës historike të Dibrës dhe do të dobësonte edhe burimet energjetike të Shqipërisë.

Ndërkohë Tofik Jegeni, Molnar Kolaneci dhe Saimir Shatku, si edhe personalitete të tjera të elitës intelektuale shqiptare argumentuan bindshëm se në asnjë këndvështrim, një akt i tillë nuk ishte në dobi as të Shqipërisë, e as të shqiptarëve në trojet tona kombëtare.

Përballë heshtjes së qeverisë maqedonase të asaj kohëe cila nuk jepte informacion lidhur me çështjen dhe po ashtu as kompania energjetike ELEM (gjithashtu, edhe zyrtarët lokalë nuk kishin informacione mbi projektin), Këshilli i Komunës në Dibër të Madhe, në një mbledhje të saj (Gusht 2013) mori në analizë problemin dhe vendosi të marrë përgjegjësi lidhur me atë që po ndodhte. Duke parë se projekti nuk sillte të mira për Dibrën, pushteti vendor vendosi ti shfrytëzojë të gjitha mekanizmat ligjorë në mënyrë që qeveria maqedonase të heqë dorë nga grabitja e paligjshme e ujërave të Radikës.

Autoritetet maqedonase para katër vitesh bënë një projekt për devijimin e 1.4 metrave kub ujë nga lumi Radika për ngritjen e një hidrocentrali në Fushën e Lukovës në Mavrovë. Por opinioni publik, përveç shqetësimeve për dëmtimin e natyrës e kuptoi këtë si një plan për devijimin e Radikës drejt rrjedhës së Vardarit që ky të bëhej i lundrueshëm, si pjesë e një ideje të vjetër jugosllave për devijimin e një pjese të Danubit e Moravës në Serbi dhe bashkimin me Vardarin për dalje në Detin Egje.Por projekti i qeverisë maqedonase në vitin 2014 u refuzua nga Banka Evropiane për Zhvillim dhe Rindërtim, pas studimit mbi pasojat ndaj biodiversitetit, florës e faunës në parkun kombëtar të Mavrovës dhe në zonën më të gjerë. Qeveria qendrore në Shkup nuk e kishte pëlqimin e pushtetit vendor të Dibrës lidhur me projektin, ndërsa protesta qenë mbajtur në Dibër e Tiranë.

Shumë shpejt u mblodhën rreth 7 mijë firma të propoganduara nga disa media në Shkup dhe Tiranë. Po ashtu, protesta janë zhvilluar në mjedise publike, shkolla etj. Ndërsa dibranët e Amerikës organizuan një protestë përpara OKB dhe kërkuan ndihmën e organizatës për të mbrojtur ujërat e Radikës.

Dhe ashtu si rrjedha natyrore e lumenjve, si fryrjet e shtretërve nga prurjet e reshjeve që rrisin intensitetin e vërshimeve, edhe protestat qytetare morën këto dimensione, duke mos lejuar devijimin e Radikës. Pesë vite pas atyre protestave, Komuna e Dibrës në Maqedoninë e Veriut i shpalli " Qytetarë Nderi" tre studiues shqiptarë për rolin e tyre në kundërshtimin e projektit për devijimin e lumit Radika. Kjo për faktin se projekti i qeverisë maqedonase të para disa viteve mund të shkaktonte dëme të paparashikueshme, sipas studiuesve, jo vetëm ndaj biodiversitetit të Mavrovës dhe Dibrës së Madhe, por binte ndesh edhe me konventat ndërkombëtare për ujërat.

Studiuesit Tofik Jegeni, Molnar Kolaneci dhe Saimir Shatku ndihmuan përmes ekspertizës së tyre në vetëdijësimin e opinionit publik e sidomos të banorëve të Dibrës në Maqedoninë e Veriut për rrezikun nga plani i para pak viteve për devijimin e lumit Radika.

M.Sc. Tofik Jegeni, si Inxhinier hidrolog, ka punuar në Institutin Hidrometeorologjik nga viti1956 deri në 1996-n, ku ka fituar titullin master i shkencave. Tani punon si ekspert i pavarur për çeshtjet hidrologjike në projekte të ndryshme të ndërtimeve infrastrukturore. Anëtar i Akademisë Shqiptaro-Amerikane të Shkencave (AAAS) me qendër në New York, SHBA.

Prof. Dr. Molnar Kolaneci ka studiuar për fizikë dhe është specializuar në fushën e hidrologjisë. Nga viti 1972 deri sa ndërroi jetë para një muaj ka punuar në Institutin Hidrometeorologjik, i cili sot mban emrin Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit. Punon edhe si ekspert i pavarur për çeshtjet hidrologjike në projekte të ndryshme ndërtimi dhe infrastrukturore.

PhD. Saimir Shatku ka kryer studimet në jurisprudencë dhe është i specializuar në të drejtën ndërkombëtare dhe europiane në Itali, Francë, Angli. Ai është lektor i të drejtave të njeriut dhe i së drejtës komunitare. Anëtar i Akademisë Shqiptaro-Amerikane të Shkencave (AAAS) me qendër në New York, SHBA që nga viti 2014. Aktualisht është noter publik.

Këshilli i Komunës së Dibrës, në shenjë mirënjohjeje për angazhimin e tyre njëzëri e miratoi vendimin për dhënien e titullit "Qytetar Nderi" tre studiuesve, tituj që iu dhanë gjatë një ceremonie mbresëlënëse në qytetin e Dibrës së Madhe, në praninë e dhjetra personaliteteve të këtij qyteti si edhe nga Peshkopia e Tirana.



E në anxhajkun e rrugëtarit: eshka, duhani, unuri, gjethet e cigarishtja shtrëngonin njëra - tjetrën, ngrohnin e ftohnin njëra-tjetrën?. Ky rrugëtari ynë – poet, anxhajkin nuk e kishte me djeg kashtën e ndokujt apo me tymos ara e bashtina të fshatit. Ai e kishte me ngrohë e flladit frymëzimin në përjetësimin e historisë dhe kulturës së kombit të vet. E kishte për të shëruar plagët e shpirtit të helmuar nga ideologjia meskine që kishte shoqëruar për 50 vite diferencimin e ajkës së shqiptarizmës edhe në familjen e tij. Tek poeti, vetë motivet luftonin brenda kumtit, krijues se kush duhet të dilte më parë: duhani, masati, unuri, cigarishtja, apo...

Naim Plaku kishte "vrarë" gjumin për të përzgjedhur temën, protagonistin, fjalën, ngjarjen, fabulën, e figura të tjera. Ai kurrë nuk e kishte menduar e besuar se një ditë adhuruesit e artit të tij kishin akumuluar dashurinë dhe respektin për ***fjalëmirin e shpirtbukurin e tyre Naim*** dhe prisnin rastin fatlum të shprehnin mirënjohjen ndaj Tij. Pra, krijuesi nuk preferon të hyjë "*siç hyn elefanti në një dyqan me qelqurina*". Por me elegancën e njeriut të thjeshtë e të butë, me mençurinë e talentin e krijuesit fiton meritën të futet në zemrat e dëgjuesit dhe të mbetet ne historinë e vlerave të trashëgimisë kulturore kombëtare.

Teksa pinte ndonjëherë kafe dhe një gotë raki me ne organizatorët e veprimtarive kombëtare, Naimi e ndjente angështinë për deformimet e denatyrimet artistike, por me modesti kalonte në lavdërime e fjalë miradie për institucionin tonë. QKVF, vlerësonte ai, po bën një punë mjaft serioze e profesionale me pasion e përkushtim. Madje, ju ja kthyet skenës edhe një herë vlerat e krijimtarisë anonime me mjaft densitet e dimension profesional....

Naim Plaku nuk ishte thjeshtë një talent krijues në fushën e poezisë së këngës. Ai ishte një gjurmues e mbledhës i vlerave të folklorit, një përpunues e klasifikues i tyre dhe një botues e promovues i kualifikuar e serioz.

Me botimet e tij studimore ai ka pasuruar opusin e etnologjisë kombëtare si dhe ka prezantuar me dinjitet vlerat e trashëgimisë së zonës së tij. Dashuria për këto vlera të vendorigjinës, Sllovës e kishin frymëzuar edhe si qytetar e si intelektual. Naimi nuk i përdorte alegorinë dhe fjalën e mençur të trevës së vet për të stigmatizuar, apo fshikulluar fenomene a individë, por për të plotësuar metaforën apo fabulën në tekstet e këngëve të adresuara.


Në fillim vitet '50 të shek. XX, im atë ishte kthyer nga Dibra me thesin pa misër për fëmijët. Sot, unë dhe fëmijët e mi, me falenderimin e artistit dhe mirënjohjen e kolegut dhe të mikut, në bibliotekën tonë kemi botime të krijuesit, folkloristit, seleksionuesit, klasifikuesit dhe botuesit Naim Plaku, me dedikimet e tij plot dashuri e thjeshtësi, siç ishte ai.

Në repertorin e këngëve të mija duetin lirik "Këndojnë dy bilbila" e ruaj të shenjtë e të çmuar për vete, për artdashësit e sidomos për të paharruarin Naim Plaku.

Kulla Hakik Hysës në Qà të Zalldardhës, baza e parë e Luftës Nacionalçlirimtare në Dibër

Me rastin e 75-vjetorit të çlirimit, një portret i Hakik Hysës, shtëpia e të cilit është e para që është shpallur si bazë e LANÇ, me vendim të ish-Komitetit Ekzekutiv të Dibrës.

Nga **ILMI DERVISHI**



Kullat e Hakik Hyses në Qa të Dardhës, shpallur "Bazë e Luftës Nacional-çlirimtare" me vendim nr.22, datë 11.03.1968 të Komitetit Ekzekutv të Rrethit Dibër.

Në prag të 75-vjetorit të çlirimit të Shqipërisë, është një rast i mirë të përkujtojmë jo vetëm të rënët, por dhe ata të cilët ishin bashkëluftëtarë me ta, krah tyre, në shërbim të Atdheut për largimin e pushtuesit nga vendi ynë.


Lufta Antifashiste Nacional-çlirimtare ka heronjtë e vetë, por të tillë ishin dhe ata që besuan tek ajo, që bashkëpunuan me partizanët me çdo lloj forme, morën armët për liri dolën malit për çlirimin e Shqipërisë.

Njëri prej tyre është Hakik Musa Hysa, lindur në fshatin Qà, të Zallëdardhës të Dibër. Ai ishte një personalitet, burrë fisnik, shquhej për bujarinë në krahinën e tij dhe më gjerë dhe do t'i bashkëngjitej LANÇ në vitin 1944. Partizanët u pritën dhe qëndruan në kullën e tij për tre netë fal bujarisë, zemrës së madhe dhe të qenit atdhetar të Hakik Hysës. Ata gjetën te shtëpia e tij dhe të afërm të Hakikut mbështetje duke nisur nga të ushqyerit, veshmbashje, mjekimin e plagëve etj. Kati i tretë i kullës u kthyer në spital ku mjekoheshin të plagosurit e luftës. Kjo kullë ndodhet mbi kodër me muret të rrethuara si kala, pranë kalasë së Zhugrit.

Ky fakt konfirmohet dhe nga shkrimtari ynë i madh, kolosi i letrave shqipe, Dritëror Agolli në vepra Letrare nr.9, faqe 23-32. Ai shkruan:

"... Ngjitemi lart e më lart dhe arrijmë në fshatin Lashkizë, që shtrihet në të dy anët e një përroi. Bashkëudhëtari im është nga Lashkiza. Ai me tregoi me gisht një shtëpi: – "Or ti shoq se nuk ta di as emrin, nji ajo shtëpi është e Hakik Hysës, tash ai ka vdek. Njëherë ishte një dimër e një borë e madhe. 60 partizanë kanë kaluar këndej e kanë dashtë me u takue me Këshillin e fshatit.

Atëherë ka dal në prag Hakik Hysa dhe iu ka thënë: "Ç'ka ju duhet bre burra Këshilli!.



Hakik Musa Hysa (1879 -1959)

Ejani brenda se është tuj iu marr frymën bora. "Or burrë, por ne jena shumë, ku ke me na shti"- I patën thënë ata. Por me zemrën e madhe prej malësori fisnik, Hakik Hysa i futi brenda. Iu ndezi një zjarr të madh e iu tha grave me vu një kazan me kaçamak. Nuk është mjaftuar me aq, por Hakik Hysa iu kërkoi partizanëve që ishin pa këpucë dhe opinga të grisura që tu falte ca opinga. Habia e tyre ishte se ku do t'i gjente. Por përgjigja e Hakik Hysës ishte: "Ne jemi 35 vet në shtëpi dhe kena boll opinga". E kështu Hakiku mori nga të shtëpisë, por dhe prej të afërmeve dhe iu pajisi të gjithë partizanët me opinga.

Ky kontakt i Hakik Hysës me partizanët bëri që ai të besonte në çlirimin e Shqipërisë dhe do të nxitonte të ishte pjesë e LANÇ duke u angazuar veten dhe familjarët; djemt Ganiu me bashkeshorten Sulbien, Shabani, Isufi, Mersimi Aqifi; rejat Mihane, Fatime, Dija e Safija.

Gani Hakik Hysa ka qenë pjesëmarrës në Brigadën e IV Sulmuese edhe në betejën e përgjakshme të 14 -15 nëntorit për çlirimin e Tiranës.

Hakiu fal moshës së thyer, do të angazhonte direkt në betejën e luftës djalin, Gani Hysën në brigadën e 4-të sulmuese që u themelua në Voskopojë të Korçës, ku ishte pjesë e luftimeve në jug të vendit.

Gani Hysa mori pjesë dhe në çlirimin e Tiranës në betejat e përgjakshme të 14-15 nëntorit ku njëri nga bashkëfshatarët dhe bashkëluftëtarët e tij Maliq Topuzi "Dëshmor i Atdheut", ka dhënë jetë në krahët e tij. Madje dhe Ganiu është plagosur në këtë betejë. Ganiu kryente dhe rolin e dentistit në brigadën e 4-të sulmuese.

Pas çlirimit të Shqipërisë, Gani Hakik Hysa do të angazhohej në krijimin e institucioneve të para demokratike pas luftës. Ai do të zgjidhej kryetar i Këshillit të fshatit ku kishte miratimin dhe respektin e bashkëfshatarëve të tij. Gani Hysa bëri çmos që jo vetëm



Gani Hakik Hysa, partizan në Brigadë e IV Sulmuese (Foto e vitit 1944 - Nga arkivi i familjes).

fëmijët e tij të arsimoheshin ku sot të gjithë kanë kryer studimet universitare, por ai sa ka mundur ka ndihmuar dhe bashkëfshatarët e tij që të ndiqnin po të njëjtën rrugë. Ganiu besonte se vetëm dija do të sillte ndërtimin e Shqipërisë.

Gani Hysa për merita të veçanta për Çlirimin e Tiranës pas lufte është dekoruar me "Medaljen e Çlirimit", dhe "Medaljen e Trimërisë".

Nga Komisioni Qendror i Statusit të Veteranit më 24.04.1996, e firmosur nga Kryetari i Komisionit Alfred Mosiut, Gani Hysës i është njohur "Statusi i Veteranit të Luftës kundër pushtuesve nazifashisë të popullit shqiptar."

Më 23 gusht 2019, Organizata e Veteranëve të LANÇ të Popullit Shqiptar, Komiteti i Veteranëve të LANÇ Dibër me kryetar Alush Stojkun ka dhënë "Mesazh Mirënjohje" Sh.Gani Hysa me motivacionin: "Për kontributin e çmuar që keni dhënë në Luftën Antifashiste Nacional Çlirimtare për çlirimin e vendit nga pushtuesit nazifashistë dhe bashkëpunëtorët e tyre". Vepra juaj në dobi të atdheut do të mbetet e paharruar përgjithmonë nga populli shqiptar dhe brezat e ardhshëm".

Për kontributin e dhënë për çlirimin e Shqipërisë, shtëpia e Hakik Hysës më vendim nr.22 të Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor rrethi Dibër me datë 11.03. 1968 do të shpallje baza e Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare (LANÇ). Me këtë vendim, kjo shtëpi është e para në Dibër që i është dhënë ky status.

Komiteti i Veteranëve Dibër në bashkëpunim me Muzeun Historik Dibër, për vlerat historike, ka vendosur që shtëpinë e Hakik Hysës ta ketë si maket në muze, që brezat të njihen me historinë e Dibrës.




Gani Hakik Hysa me bashkëshorten, Sulbien.

traditë

FJALË E FRAZEOLOGJIZMA TË RRALLA

Marrë nga libri "Toponimia e Çidhnës" i autorëve
Haki Përnezha dhe Rruzhdi Bitri,
Botimet M&B, Tiranë, 2016.



FJALË TË RRALLA

G

► ***gërga:*** I pamundur për të lëvizur: *ka mbet gërga te shtëpia*.

► ***gargere:*** Në vështirësi, gjendje e vështirë. Me sa duket nga it. *carcere, burg*.

► ***gatrraç:*** Një njeri i ngathtë, që vonohet në kryerjen e një pune. Njeri i ngatërruar.

► ***garavaj':*** Zhurmë, potere: Ç'është kjo zhurmë e *garavajë* / *Bahet dasëm n'këtë shtëpajë* (pop.).

► ***g*ërvaj':** Thuhet për trupin e ndonjë kafshe të coftë e të mbetur diku. Jo rrallë dëgjohet edhe në formën *stërvajë, stërvinë, zdërvinë*, nga sll. *strvina, pleh*.

► ***gush:*** U prek, është gati në të qarë. *U gush e u gush e ia nisi të qajë*. Nga e njëjta rrënjë e burim sipas foljes *ngushëlloj, ngushëllohem*.

► ***gec:*** Folje, njësoj me fjalën *ngec* tek Çabej. Në të folmen vendëse përdoret edhe me kuptimin nuk thithet (për duhanin), nuk të ngec shija e tij në grykë: *ky duhan qënka i but se nuk gecka hiç*.

► ***gel':*** Mbetet në hall të madh. *Kam ra ngelë me filanin, kam ngelë, nuk lëviz asgjë në punën me të*.

► ***grraç:*** Një njeri me trup të madh, i vjetër dhe i gërmuar.

► ***gare:*** Vrapo-vrapo, fjalë inkurajuese: *ngarend, ngarend*. Çabej sjell formën rend, ndërsa në tjetër vend, formën ngarend.

► ***ga:*** Ika me vrap. *Sa dëgjuam lehjen e qenve, gamë me vrap. Gau e gau ferrave dhe u shtri*. E njëjtë me fjalën *ga-u* është edhe forma çá-u. Çau fushave e iku. Nga folja *ngas, ngarend*.

► ***gërmue:*** *Iu gërmush, iu kërcënue*. I njëllojtë me *gërmushem* te Çabej· *Hala fjala pa mbarue/ Me pushke n'dorë i gërmue*.

► ***gilikoc:*** Gudulis, kruaj në vende të ndjeshme (fëmijën), në shputat e këmbëve, në ije, për ta bërë të qeshë. Njësoj me *gicilo*te Çabej.

► ***grëpsajn':*** *Gromësimë-a, gromësinë*. Njësoj me *gogesinë* te Çabej, dhe *gromësinë* në FGJSSH.

► ***graço:*** Përdoret me kuptimin *rritet, zhvillohet*: *kam mbjellë kopshtin, po s'ka graçue prej të ftohtit*.

► ***gref'm:*** Njësoj me *grah* te Çabej, vështirësi në frymëmarrje, *grahmë, grehmë*. Njësoj si në shqipen e sotme: *grahma e fundme - fryma e fundme*.

► ***grrajk:*** Një rrymë ajri që fryn në periudhën e verës. Çabej e ka në formën *grryk·*. *Grik's Drinit, veriu grrajku* / *Në Zbinec po vlon katajku* (pop historike).

► ***gep:*** Fiksoj një objekt diku. Folja *gep* herë-herë mund të jetë e njevlershme me foljen *kap*. Rrobaqepësit, para se të qepin copat, i *gepin* me gjilpërë. E kam *gep* në mur. E kundërta e këtij veprim është *shkep*. *Mbeta gjithë ditën gep* e *shkep*.

► ***grezhën:*** Mbetjet nga vilet e rrushit, pasi u hiqen kokrrat. Përdoret dhe në shumës në formën *grézhnit* e rrushit. Çabej, sjell formën *rruva*. Kjo e fundit ndoshta e një burimi me *rrufangë*.

Gj

► ***gjëlle:*** Goll/e-ja, një gropë në dru, zgavër.

► ***gjëllemadh***: I pangopur, me gjolle të madhe, fig. për bark.

► ***gjec':*** Gacë, gjacë, gjec (shumës i singularizuar). I vuri një gjecë në llullë. Ai plak rrin për nji gjecë n'llullë e nji copë bukë n'mullë.

► ***gjigj':*** Një kunj druri (i mprehur në njërën anë) dhe që shërben për të zhveshur misrin.

H


► ***hina***: Shumës i çuditshëm i foljes hyj, urdhërore, hyna, ecna para: Hina para, tha plaku. Hyj, më e qartë në frazeol.: i hini me shkelma - e zuri me shkelma.

► ***hashari***: Gëzim i madh, zhurmë e madhe nga gëzimi. Mos u hasharo shumë.

► ***hapkarrajk*** : Thuhet për dikë që mbetet keq, në mes dy udhëve, s'di nga t'ia mbajë. Mbetur ashtu si avlëmendi - veku, vegja e bllokuar hapkarrik, hapkarrajk.

TREGIM ALEGORIK

Në kërkim të fatit



Buka e magjes së popullit
Tregime alegorike
Xhafer Martini
Botimet M&B, 2019
ISBN 978-9928-256-59-1
Faqe 160
Çmimi: 700 lekë

Librin mund ta gjeni te Botime M&B, Rr. "Isa Boletini", Nd.2, H.12, Nj.Admin.nr9.
Tel. 069 20 68 603 (Viber). Tel. 068 65 08 441 (WhatsApp). E-mail: mbbotime@gmail.com
Ose përmes rrjetit të Librarive #Adrion, #Bukinisti dhe agjencive të shpërndarjes së librit në Tiranë.

Dy vëllezër jetonin të ndarë. I vogli punonte shumë, kurse i madhi jetonte "ku rrafsha, mos u vrafsha".

Pasurinë e bëri rrush e kumbulla për një kohë të shkurtër. Tokën e la djerrë. Mori gruan dhe fëmijët, ia çoi në derë vëllait të vogël, dhe i tha:

- Do të bëj një rrugë. Derisa të kthehem, mbaji ti.

- Po ku do të shkosh?

- Do të kërkoj fatin.

- Ç`fat, more! Fatin e ke te puna , por ti nuk punon.

Po ai nuk dëgjonte nga ai vesh.

Kaloi krahinë më krahinë duke kërkuar fatin. Kurrkund nuk e gjeti. Një ditë, ndërsa kishte marrë kotsëkoti një udhë malore, takoi një plak të vjetër, të cilin e pyeti:

- Or plak, mos di ku është fati im? Jam njeri pa fat dhe kam dalë ta kërkoj.

- Mos iu ndaj kësaj udhe, që të çon në Pyll të Zi. Aty ndodhet Fatthënësi. Ai ta tregon me siguri.

Burri falënderoi plakun dhe mori udhën për në Pyllin e Zi. Nuk kaloi shumë kohë dhe në udhë takoi një ujk. Ky ishte kockë e lëkurë.

- Ku po shkon? - e pyeti ujku njeriun.

Njeriu i tregoi ku shkonte.

- Pyet edhe për fatin tim, - i tha ujku, - se edhe unë pa fat jam. Shiko si jam bërë kockë e lëkurë. Ha çfarë të dua, por nuk shëndoshem…

- Do të pyes, - premtoi burri dhe u nis për rrugë.

Pak më tej ishte një rrap i madh, degëgjerë që kishte filluar të thahej. Ky, kur mori vesh se ku shkonte njeriu, iu lut:

- Pyet edhe për fatin tim, se ja, rrënjët i kam në ujë e në tokë të mirë dhe po thahem.

- Do të pyes, - i dha fjalën edhe rrapit.

Mbas një ore u kthye dhe i tha rrapit:

- Ti ke te rrënjët një kazan të madh me flori. Kush e nxjerr kazanin, të shpëton nga e keqja, ndryshe do të thahesh fare…

- Po ç`pret!? Nxire ti kazanin, për vete bëhesh i pasur, unë gjelbëroj si më parë. Një udhë e dy punë, i thonë kësaj. Nuk ka ku vete më mirë.

- Jo, jo. Unë kërkoj fatin tim. E kam rrugës teposhtë…

- Nuk ka fat më të madh se sa të marrësh një kazan me flori, - i tha rrapi. Kështu mendonte edhe ujku që e dëgjoi bisedën e tyre.

Po kujt t`i thoshte! Njeriu ishte i vendosur në të vetën. I erdhi radha ujkut për të marrë vesh ku e kishte fatin. Burri i tha:

- Ti duhet të hash një njeri budalla. Sado të hash kafshë të egra si sorkadhe e të tjera, nuk do të shëndoshesh.

- Më budalla se ti, që nuk nxore kazanin me flori, nuk kam ku të gjej, - i tha ujku dhe iu hodh në grykë e ia shqeu gurmazin.

Rruga e Arbërit nr. 161

kujtesë

Më datë 09.09.2019 ndërroi jetë njëri nga personalitetet më të shquara të kulturës fetare islame në mbarë Dibrën dhe më gjerë, sheh Mehmeti i Limjanit.

Sheh Mehmeti i Limjanit

Ditën e hënë, datë 09.09.2019, ndërroi jetë në Tiranë, njëri nga personalitetet më të shquara të kulturës fetare islame në mbarë Dibrën dhe më gjerë, sheh Mehmeti i Limjanit. Mehmeti, i biri i Sheh Ismailit, lindi në Limjan Dibër, në vitin 1936. Edhe i ati, sheh Ismaili, njëri nga personalitetet më të shquara të kulturës islame për brezin e vet, ishte i mirënjohur në mbarë Dibrën jo vetëm si teolog, por edhe si filozof popullor, nga më të spikaturit në Dibër.

Fisi i shehlerëve të Limjanit në Dibër rrjedh nga Mehmet Dede, njëri prej misionarëve të parë për të përhapur Fenë Islame në Shqipëri, i ardhur nga Bagdadi, dhe në vitin 1724, me dekretin e nënshkruar nga Sulltan Bajazidi II, i emëruar imam në Limjan të Dibrës. Sipas historikut të fisit Shehu, të hartuar prej Sheh Ismailit, rezulton që Mehmeti ynë, që ndërroi jetë këto ditë është i 15-ti brez i Mehmet Dede-s që përmendëm më sipër. Shehlerët e Limjanit me teqen e tyre, nga më kryesoret e shtatë teqeve të Dibrës, kanë shërbyer si qendër e përhapjes së Islamit në mbarë Dibrën, prej 15 brezash, duke nxjerrë shumë kuadro drejtues të Islamit që kanë shërbyer si imamë në shumë fshatra të Dibrës së Poshtme, kryesisht në zonën e Çidhnës dhe të Muhurrit etj. Secili brez ka pas të shquarit e vet, por nga më të shquarit e tyre gjatë këtyre tre-katërqind vjetëve pas Mehmetit të parë të vitit 1724, përmendim këtu Sheh Isufin dhe Sheh Musën, të dy përveç kryesues të Teqes, kanë qenë edhe imamë në Grykë-Nokë të Çidhnës, të cilët me veprat e tyre kanë lënë gjurmë të pashlyera, dhe pas tyre, sipas brezave, përmenden Sheh Ismaili dhe Sheh Mehmeti, të cilit i kushtojmë këto radhë.


Theksojmë se jo vetëm Teqja e Limjanit, por të shtatë teqet e Dibrës së Poshtme kanë përgatitur dhe kanë mbuluar me imamë gjithë trevën e Dibrës. Kontributi i tyre në përhapjen e parimeve islame në Dibër ka qenë vendimtar.

Në aspektin e edukimit islam të paqëtimit, sidomos lidhur me pajtimin e gjaqeve dhe me pushimin e ngatërresave të intrigave e thashemeve ndërmjet individëve dhe përçarjes ndërmjet fiseve të ndryshme dhe të parandalimit të pasojave të tyre; roli i teqeve të Dibrës ka qenë shumë herë më i madh se sa i shtetit laik, jo vetëm në vitet e Perandorisë Osmane dhe të pavarësisë, por edhe në periudhën e sundimit të sistemit komunist, deri në vitet 1967, kur ushtrimi i fesë u ndalua me ligj nga diktatura komuniste. E thënë ndryshe roli i tyre në edukimin e popullit lidhur me paqëtimin dhe harmoninë në mjedisin e popullit ka qenë në masën e një shteti islam brenda shtetit laik.

Mehmet Ismail Shehu, si pinjoll i këtij fisi të shquar në fushën e kulturës islame, edukimin e parë islam e mori në familjen dhe fisin e tij; po kështu edhe arsimin fillor shtetëror (laik) e mori po në vendlindje gjatë viteve 1946-1950.

Pas përfundimit të studimeve teologjike njëherësh edhe laike, të mesme, në Medresen e Përgjithshme të Tiranës (1951-1957), Mehmeti u emërua imam (prijës fetar) në Zimur të Dibrës me dekret të Komunitetit Musliman të Shqipërisë. Ai ishte emërimi zyrtar i tij, por reputacioni që fitoi Mehmeti në popull me kulturën dhe njohuritë e tij fetare dhe shkencore dhe me cilësitë që rrezatoi në sjelljet dhe në komunikimin me masat dhe me kolegët e tij, imamët e tjerë të zonës, në bisedat e tij për përhapjen e Islamit, ai fitoi një reputacion të tillë në shoqëri, sa që konsiderohej jo si një imam fshati, por një kryeimam, më sakt, një lider i kulturës fetare në gjithë zonën dhe në mbarë Dibrën.

Pas vitit 1967 kur ushtrimi i besimit dhe i riteve fetare u ndalua nga shteti me ligj dhe më pas edhe me kushtetutë, Mehmeti punoi, së pari, llogaritar në kooperativën bujqësore të Bashkuar të Kastriotit, dhe më pas, kur kreu me korrespondecë edhe studimet e larta ekonomike u emërua shef Llogarie po aty, si



edhe në ndërmarrje të tjera shtetërore, deri sa doli në pension. Me autoritetin që krijoi në shoqëri me punën, kulturën dhe sjelljet e tij në shoqëri, të gjithë kolegët e tij nëpunës të shtetit, e konsideronin si një intelektual të mirëfilltë, ndaj asnjë ziliqar e intrigant, sado ateistë që mund të ishin, nuk guxonin t'i bënin ndonjë provokim duke e quajtur me nënçmim si ish-hoxhë etj., pasi nuk mund të mateshin me të as në debatet shkencore e jo më për çështje teologjike.

Pas vitit 1990, kur zhvillimet politike demokratike postkomuniste lejuan ushtrimin e riteve të besimit fetar, Mehmeti, krahas punës shtetërore në ndërmarrje ku punonte si ekonomist, iu rikthye qysh në momentet e para punës për përhapjen e kulturës fetare islame dhe edukimit të masave me njohuritë fetare islame, së pari, si imam në Zimur dhe më gjerë.

Nga viti 1992 e më pas dha kontributin e vet si mësues i Kur'anit Kerim dhe i lëndëve të tjera fetare në Medresen e Peshkopisë, për aq kohë sa funksionoi ajo, deri në 1995, kur e mbylli KMSH dhe qeveria. Mehmeti ka qenë anëtari më aktiv i Komisionit të Pajtimit të Gjaqeve në Dibër, i krijuar në vitin 1997. Autoriteti i tij ishte i padiskutueshëm në masat e gjera të Dibrës.

Askush nga populli nuk e vinte në diskutim fjalën dhe sugjerimin e Mehmetit. Kontributi i Mehmetit zë vend të veçantë në pajtimin e rreth 30 gjaqeve dhe në parandalimin e pushimin e rreth 100 rasteve ngatërresash e konfliktesh të ndryshme në rrethin e Dibrës. Mehmeti, si predikues i Islamit dhe njeri i paqes, dhe i harmonisë ndërmjet njerëzve, e ka treguar vetveten me vepra, me shembullin e vet personal, duke qëndruar larg intrigave e thashethemeve, për të mos u dhënë shkak gojëve të liga për të thurur intriga kundër Islamit etj.

Në këtë aspekt, sa për konkretizim theksojmë këtu se në vitet 1996-1997, kur Komuniteti Musliman bëri disa ndryshime organizative në Myftinitë e Dibrës dhe e emëroi Mehmetin imam në xhaminë e qytetit të Peshkopisë, Mehmeti e refuzoi emërimin e tij në atë detyrë vetëm me qëllimin e mirë për të mos shkaktuar pakënaqësi tek ish-imamin i mëparshëm. Jo vetëm kaq, por për të mos shkaktuar konflikte të tjera, për rreth dy vjet, dhe rrogën që KMSH ia dërgonte Myftinisë së Dibrës në emër të Mehmetit, ai nuk e ka marrë atë, por ai ka lënë ish-imamit të mëparshëm për aq kohë, deri kur KMSH e riktheu atë në detyrë me vendim të posaçëm.

Shehlerët e Limjanit me teqen e tyre, nga më kryesoret e shtatë teqeve të Dibrës, kanë shërbyer si qendër e përhapjes së Islamit në mbarë Dibrën, prej 15 brezash, duke nxjerrë shumë kuadro drejtues të Islamit që kanë shërbyer si imamë në shumë fshatra të Dibrës së Poshtme, kryesisht në zonën e Çidhnës dhe të Muhurrit etj.

Nga viti 1992 e më pas dha kontributin e vet si mësues i Kur'anit Kerim dhe i lëndëve të tjera fetare në Medresen e Peshkopisë, për aq kohë sa funksionoi ajo, deri në 1995, kur e mbylli KMSH dhe qeveria. Mehmeti ka qenë anëtari më aktiv i Komisionit të Pajtimit të Gjaqeve në Dibër, i krijuar në vitin 1997. Autoriteti i tij ishte i padiskutueshëm në masat e gjera të Dibrës.

Në vitin 1998 Mehmeti u vendos familjarisht me banim në Tiranë, pranë të birit, Nexhbedinit, i cili pas mbarimit të specializimeve dhe studimeve pasuniversitare në Strukturat e NATOS në Gjermani etj, Nexhbedini i graduar me gradën ushtarake "Kolonel", ishte emëruar në funksione të larta shtetërore në ushtrinë kombëtare shqiptare si Komandant i Akademisë Ushtarake dhe më pas, shef i Kuadrit në Ministrinë e Mbrojtjes.

Aktualisht prej dy vjetësh Nexhbedini është emëruar nga Qeveria dhe kryen detyrën e Prefektit të Qarkut të Dibrës.

Pas ardhjes me banim në Tiranë Mehmeti ka punuar si ekonomist për disa vjet rresht, në shoqatën islame "Ringjallja", e cila ndihmonte jetimët e Shqipërisë. Kryesia e KMSH dhe Myftinia e Tiranës e emëroi Mehmetin në detyrën e imamit në "Xhaminë e Xhurës", në qytetin e Tiranës, por për arsye shëndetësore dhe moshe ai nuk e vazhdoi gjatë atë detyrë në atë xhami, por në detyrën e prijësit fetar, të imamit të popullit, ai de fakto ka qenë në krye të detyrës në kryerjen e ceremonive fetare islame në shërbim të gjithë popullit, veçanërisht të gjithë dibranëve të Dibrës dhe të Durrësit, deri një vit më parë, kur ai ishte i pamundur fizikisht.

Për vlerat dhe kontributin e tij në aspektin fetar dhe shoqëror, një jetëshkrim për Mehmet Shehun, përfshihet edhe në librin me titull "Personalitete të Kulturës Fetare dhe Atdhetare në Tiranë", i autorit medresist Xhemal Balla, viti 2014 fq.90-91, botim i Komunitetit Musliman të Shqipërisë.

Ne, shokët e tij medresistë, e kemi pas Mehmetin vëllain tonë më të madh. Prandaj, i lutemi Zotit të Madhëruar që ta bëjë Mehmetin një nga banorët e Xhenetit!

I përjetshëm qoftë kujtimi i tij!

Ali Hoxha, ish - Kryetar i Këshillit të Përgjithshëm të Komunitetit Musliman të Shqipërisë (në mandatin e viteve 2003-2004);
Ahmet Çaushi, ish-Kryetar i Këshillit të Përgjithshëm të KMSH (në mandatin e viteve 2004-2007);
Ismail Dizdari, ish-Drejtor i Medreses së Durrësit.
Ing.Mehdi Cani, ish-drejtor i Investimeve në Kryesinë e Komunitetit Musliman të Shqipërisë.

Tiranë, shtator 2019

homazh

Homazh për shkencëtarin
që shmnagu devijimin e lumit Radika

Faleminderit Zaide Çela

Një zile e zgjatur telefoni që tringëllinte me insistim në mëngjesin e të dielës së datës 8 shtator, me kapi në befasi . Një telefonatë në atë orë të hershme, sigurisht që bëhet për ngjarje jo të zakonshme dhe mendja të shkon gjithmonë për keq. Nga ana tjetër e telefonit më fliste me trishtim Nexhmie Cami , një kolege e imja e punës në shëndetësi në Dibër e në Tiranë. Më bënte me dije se Zaide Çela nga Gjorica e Bulqizës kishte ndërruar jetë e provova vetëm dhe me shokë, me Mersimin (Rama), me Leninin (Vladi), me Nduen (Kola), me Bardhokun (Rajta), me Besnikun (Sade), por dhe me Festimin (Pishtari), me Elezin (Xheka), me Xhetan Tashen e Dan Jellen, me Hasan e Irfan Çelen, me miqtë e familjes Hamdiun (Leka) dhe Sherifin e dhjetëra të tjerë. Për të gjitha këto dhe kujdesin që tregove ndaj nesh duke na pritur e përcjellë si një motër e vërtetë po të them publikisht, faleminderit Zaide Çela.



dhe varrosej atë ditë. Më tha se e kishte lënë me fjalë për disa që duhet të lajmëroheshin dhe se isha edhe unë midis tyre. Pas ngushëllimeve të rastit, pa një e pa dy, u bëra gati dhe u nisa për në Gjoricë.

Plot burra e gra, nga fshati e rrethinat, nga Gryka e Vogël dhe ajo e Madhe, nga Maqellara e Luznia, nga Dibra e Tirana, bile edhe mjaft emigrantë ishin mbledhur për t'i dhënë lamtumirën e fundit një zonje fisnike që lindi në Luzni të Dibrës, jetoi në Gjoricë dhe i mbylli sytë e u nda nga jeta jashtë vendit, në Modena të Italisë. Amanetet e saj shumë njerëzore më bëjnë ta vlerësoj me veneracion, ashtu si dikur kur ishte midis nesh. Bashkëshorte e ish partizanit të Luftës Nacionalçlirimtare Zenel Çela, ajo erdhi në atë fshat me mençurinë e një vajze nga Luznia dhe u shndërrua në një zonjë e respektuar, e ditur e bujare që traditat e veta i gërshetoi me ato të familjes ku erdhi . E respektuan dhe e vlerësuan të gjithë. Ai popull që di të njohë e të vlerësojë vlerat njerëzore, e zgjodhi nënkryetare të kooperativës bujqësore ku punoi për shumë vjet për krah të mirënjohurit Ramiz Osmani e u përpoqën të bënin më të mirën. Ishte e zgjedhur në forumet e gruas në rreth, ishte anëtare e pleniumit, po ashtu në rreth dhe fjala e saj dëgjohej e respektohej . Me bashkëshortin e saj model, Zenel Çelën, krijuan një familje për tu marrë shembull. Aso kohe, në fillim të viteve 70-të, bëja stazh dhe punoja në prodhim në Gjoricë. Shpejt arsimtari i mirënjohur, Zeneli, që kishte qenë miku i babait tim, u bë gjithashtu edhe miku im. Shpesh, do të zinte rrugën aty anës së fushës së Sportit ku kalohej për në Shupenzë dhe do të shkonim në shtëpinë e tij. Unë nuk isha mangët për motra, pasi kisha disa, por shpejt Zaide Çela do të bëhej motra ime më e mirë. Të dyve bashkë me Zenelin ju kishte lezet fjala, ju kishte lezet buka, kafja dhe miqësia që të ofronin. Ajo derë e hapur për këdo, por sidomos për kuadro të ardhur dhe që kishin nevojë për mbështetje duhet të ketë qenë më e mira ndër të mirat dyer bujare që na pritën e na respektuan në atë kohë. Bukën e duarve të saj

Zaidja u nda nga jeta jashtë vendit nën kujdesin e familjareve të saj të devotshëm midis të cilëve mbajti peshën kryesore nipi Kujtim Bexhet Markja. Në këto raste në Dibër thonë: "Pastë faqen e bardhë" ai që u kujdes si djalë e si nip për jetën dhe amanetet e saj. Zaidja kërkoi që trupi i saj të sillej në Gjoricë, kjo dhe të gjithë amanetet e tjera të saj u plotësuan me besnikëri. Sot ajo prehet atje në "fushë të thatë" në Gjoricë, përkrah bashkëshortit të saj që e deshi , besnike dhe shoqe e mirë në këtë e në atë jetë. Trupin tënd nuk e treste dheu i huaj dhe kërkove të prehesh në vendin tënd. Mesazhi që na le është po ashtu shumë njerëzor. Edhe për këtë faleminderit Zaide Çela!

Siç është zakon dhe tradita jonë në Dibër e kërkon, u mblodhën miq e shokë nga të katër anët . E kanë shprehje të tyre këtë kosovarët kur thonë se "ra ky mort e u pamë". Konaqet plot, lokali ky shtrohej dreka e darka plot. Bisedat në këto raste vijnë për atë që është sebepi, por jo vetëm për atë. Biseduam për Zaiden e Zenelin, por edhe për fisin Çela në Gjoricë e atë Dardha (Hysa) në Hotesh të Luznisë, për hallet tona, për emigracionin, për rrugën e Arbrit. Kujtuam edhe kohe të shkuara pasi edhe ato pjesë e jetës sonë janë. Biseduam shtruar me dajën Nezir Loca nga Katundi i Ri, u takuam me Hasan Çelën, Xhetan Tashën, Hazis Osmanin, Irfan Çelën, me Elez Murrën, Shaqir Murrën, Shyqyri Ballën, Avni Osmanin e dhjetëra të tjerë. Na mblodhe si dikur në sofrën tënde bujare miq e shokë nga të katër anët. Edhe për këtë faleminderit Zaide Çela. Shembulli në jetë ishte frymëzues e inspirues, prandaj kujtimi dhe shembulli jot i mirë rron e do të rrojë, prandaj vendosa të të them faleminderit dhe se të jam shumë mirënjohës ty personalisht, familjes e fisit tënd, popullit të Gjoricës e të Grykës së Vogël që edhe pse kanë kaluar 35 vjet nga largimi im prej atje, nuk më ndani nga të afërmit tuaj. Prandaj mesazhi yt është njerëzor dhe hyjnor e më obligon të them: Faleminderit! U prehsh në paqe Zaide!

Nazmi Koçi

Tiranë, Shtator 2019

Prof. dr. **Molnar Kolaneci -** Akademiku që ndërroi jetë në Akademinë e Shkencave

Nga Halil RAMA



Një ikje jo e zakontë ajo e Prof. Dr. Molnar Kolanecit. Ai u nda nga jeta në vigjilje të Konferencës Shkencore "110 Vjet Kongresi i Dibrës – Ngjarje Historike për Kombin Shqiptar", që u mbajt para pak ditësh nga Shoqata Bashkësia Dibrane në Tiranë, në sallën e Konferencave të Akademisë së Shkencave. U shua krejt papritur, ndërsa ishte i ftuar të asistonte në këtë event historik. Iku mes emocionesh, duke patur në krah mikun dhe bashkëpunëtorin e tij shkencor z.Tofik Jegeni, ndonëse ju dha ndihma e menjëhershme parësore, mjekësore nga Kryetari i Komunës së Dibrës së Madhe, Dr. Hekuran Duka dhe me mbështetjen humane të menjëhershme të mjekut të njohur Prof. dr. Petrit Barës.

Kësisoj, ndërprerja e funksionit normal qelizor të trupit të akademikut të mirënjohur në një ditë historike, e veshi atë me pavdekësi. Para dy vjetësh, më 2017 ai u dekorua nga Presidenti i Republikës me titullin "Mjeshtër i Madh" pas mbrojtjes me teza shkencore dhe argumenta hidroteknik dhe juridik, të mosdevijimit të Lumit Radika.

Vetëm para disa ditësh, me vendim unanim të Këshillit të Komunës Dibër e Madhe, Republika e Maqedonisë së Veriut, shpallet "Qytetar Nderi" për mbrojtjen shkencore të Lumit Radika.

EKSPERTI ME KONTRIBUT TË VEÇANTË NË PROJEKTE TË RËNDËSISHME

Eksperti i mirënjohur Molnar Kolaneci që gjithkund e në çdo kohë rrezatonte dhe përçonte mirësi, mençuri dhe intelektualizëm të veçantë, ka lindur në Tiranë më 22.06.1948. Studimet e shkollës së mesme i ka mbaruar në vitin 1965 në gjimnazin "Petro Nini Luarasi". Në periudhën 1966 deri në 1971 kryen studimet e larta në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës dega Fizike (5-vjeçare).

Në vitin 1972 fillon punë në Institutin Hidrometeorologjik të Akademisë së Shkencave. Objekti i aktivitetit kryesor ka qenë studimi i ujërave të Shqipërisë. Mbas një kualifikimi dy-tre vjeçar në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit dhe në Institut ka kryer dhe dy specializime jashtë vendit në France dhe Zvicër. Në Zvicër kryen një specializim pasuniversitar prej një viti në fund të të cilit fiton gradën shkencore "Master i Shkencave" (1980). Në vitin 1983 bëhet "Doktor i Shkencave", gjithmonë pranë Institutit Hidrometeorologjik dhe në vitin 2004 fiton gradën "Profesor Doktor". Gjatë kësaj periudhe ka marrë pjesë në studime të ndryshme të objekteve ujore (lumenj, liqene dhe dete). Ndërkohë është bashkautor i monografisë "Hidrologjia e Shqipërisë" dhe shumë studimeve me karakter aplikativ. Gjithashtu, si njohës i gjuhëve anglisht, frëngjisht, italisht dhe rusisht. ka marrë pjesë në projekte të ndryshme ndërkombëtare, si në rajonin e Ballkanit dhe më gjerë si edhe në mjaft simpoziume e konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare. Së fundi ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në projektet për ndërtimin e rrugëve në vend si edhe për ndërtimin e hidrocentraleve të vegjël.

LIDHJA E MOLIT ME KOMUNITETIN DIBRAN E ATË AKADEMIK

Të thuash i pari të vërtetën "duhet fisnikëri dhe guxim". I tillë ishte Moli.

Molinari u lidh mjaft me qytetin e Dibrës së Madhe, e sidomos kur gugule u bë situata mbi ujërat e Radikës, ku pala Maqedonase pa marrëveshje donte të aneksonte rreth 4.7 m/3 ujë në sek.

Kjo situatë vuri në lëvizje komunitetin dibran në Tiranë, në Dibër të Madhe e Peshkopi, ku përmes shoqatës "Bashkësia Dibrane" të Tiranës, u organizuan disa herë protesta në qendër e rrethe, kundër kësaj shkeljeje antiligjore dhe të padakortësuar me ekspertë.

Moli, ankohej shpesh pasi ishte anëtar i komisionit ndërkufitar për ujërat me pjesën Maqedonase dhe Greke dhe kishte rreth 4 vite që ky komision me ekspertë nuk mblidhej. Radika e vuri në lëvizje mbi situatën, por ai kërkonte të dhëna statistikore, të cilat më në fund i gjeti në Insitutin Sinpotik Meterologjik të Serbisë. Kjo situatë e gëzoj pamasë për të mbledhur fakte të tjera mbi Radikën.

Radikën e rifituan si kauz, pasi u bë sebep studimi i tre ekspertëve dhe mosdakortësia e Bankës Botërore për të investuar, që marrja e ujerave të mos vazhdone më. U formua një grup pune i cili pati takime me Kreun e Bashkisë Dibër e Madhe, Dr. Argëtim Fida, më pas me të ndjerin Ruzhdi Lata dhe me Kryetarin aktual Dr. Hekuran Duka si dhe me Kryetarin e Këshillit Komunal z. Bashkim Mashkulli. U takuan disa herë duke folur me harta në duar mbi ujrat e Radikës dhe rrezikun e shterrimit të tyre në vazhdimësi.

Tofik Jegeni, Molnar Kolaneci dhe kolegu i tyre, juristi Saimir Shatku – Mjeshtër i Madh, bënë një studim shkencor me këndvështrim shkencor dhe juridik, mbi aneksimin e ujërave. Moli u lidh mjaft me këtë situatë. Pastaj të tre bashkëautorët hartuan dhe botuan librin me titull: "Dibra e Madhe dhe Radika" të cilin e promovuan në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë në dhjetor të 2016 dhe me shoqatën "Bashkësia Dibrane". Nga i gjithë komuniteti dibran në Tiranë e Dibër të Madhe, Moli konsiderohej si shok, si vëlla e mik. Sidomos nga bashkëpunëtorët e tij, profesorë, akademikë e pedagogë me të cilët kaluan sëbashku vite pune shumë të vështira por dhe të mira. Sepse qenë një gjeneratë që patën fatin e atij heroit të lashtësisë, i cili vdes porsa arrin i pari maratonën. Dhe në të vërtetë ai ja arriti i pari....Kryetari i Bashkisë Dibrës së Madhe Dr. Hekuran Duka dhe Prof. Dr. Petrit Bara i dhanë ndihën e parë mjekësore, por fati qe i shkruar që ti të mos jetë më fizikisht me ne. Zemra e shkencëtarit të mirënjohur pushoi së rrahuri ditën e konferencës historike shkencore për kontributin e personaliteteve dibrane në shtetformimin e kombit shqiptar, në gjurmët e të cilëve eci edhe Ai për vite e dekada. Ai iku duke lënë një trashëgimi të vyer shkencore për studiuesit e sotëm dhe për brezat e ardhshëm. Pikërisht edhe për këtë fakt, për pjesëmarrësit në këtë event të rëndësishëm, si edhe për gjithë komunitetin dibran e atë akademik ai mbetet si legjendë e gjallë e shkencave hidroteknike e meteorologjik. Si i tillë, Prof. Dr. Molnar Kolanecit u përcoll për në botën e përtejme me të gjitha nderimet që i meritonte.

Big market

DI ÇFARË ZGJEDH!

Big market Peshkopi

OFERTAT JANE TE VLEFSHME

3 - 15 TETOR TETOR

FESTOJME SE BASHKU 25 VJETORIN E ODES DIBRANE

SUPER OFERTA

50 Ofertat më të mira!

VAJ
BIG MARKET 1L
169 LEKE

1+1 FALAS!
SHAMPO
HEAD & SHOULDERD + OLD SPICE
SUPER OFERTE
399 LEKE

BISKOTA
BALOCCO
700 GR
SUPER OFERTE
179 LEKE

1+1 FALAS!
DETERGJENT RROBASH
MEGA MAX 10 KG + MEGAMAX 3 KG
SUPER OFERTE
999 LEKE

PIJE ENERGJIKE
RED BULL
SUPER OFERTE
145 LEKE

BIRRE
AMSTEL
500 ML
SUPER OFERTE
99 LEKE

KAFE
OSCAR
SUPER OFERTE
85 LEKE

DJATH LOPE
RAPSODIA
1KG
SUPER OFERTE
299 LEKE

VERE
BODRUMI I VJETER
VRANAC/RIESLING
3L
SUPER OFERTE
499 LEKE

CORN FLAKES
375 GR
SUPER OFERTE
139 LEKE

MAKARONA
BARETTI
SUPER OFERTE
65 LEKE

SUPER OFERTË
BLINI NJË PRODUKT

Bëhuni pjesë e SHORTEUT për të fituar!

4 LAVATRICE beko

6 KUPONA 3000 LEKË

Shorteu hidhet në datë 14.11.2019

Big Market | www.bigmarket.al | Shërbimi ndaj Klientit: bigmarketofficial1@gmail.com

cyan magenta yelloë black